



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

***DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT
PUBLIK DHE BASHKËRENDIMIT TË NDIHMËS SË
HUAJ
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
01.01.2020 – 31.12.2020
(Auditim i Përputhshmërisë)***

Tiranë, Shtator 2021

Nr.	Përmbajtje	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3-23
1.	<i>Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....</i>	<i>3</i>
2.	<i>Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....</i>	<i>3-9</i>
3.	<i>Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....</i>	<i>9-23</i>
II.	HYRJA.....	24-25
1.	<i>Objektivat dhe qëllimi.....</i>	<i>24</i>
2.	<i>Identifikimi i çështjes.....</i>	<i>24</i>
3.	<i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i>	<i>24-25</i>
4.	<i>Përgjegjësitë e audituesve.....</i>	<i>25</i>
5.	<i>Kriteret e vlerësimit.....</i>	<i>25</i>
6.	<i>Standardet e auditimit.....</i>	<i>25</i>
7.	<i>Dokumentimi i auditimit.....</i>	<i>25</i>
8.	<i>Metodat e auditimit.....</i>	<i>25</i>
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	25-90
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	25-26
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	26-90
2.1	Vlerësimi i kuadrit rregullator në fuqi lidhur me borxhin publik. Struktura e Drejtorisë së Borxhit dhe përshtatshmëria e saj në funksion të arritjes së menaxhimit të kujdesshëm të borxhit. Sistemet e kontrollit të brendshëm dhe përshtatshmëria e tyre.....	26-37
2.2	Auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e treguesve të borxhit publik. Analiza e qëndrueshmërisë së treguesve dhe vlerësimi i përmbushjes së objektivave të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 dhe strategjive afatshkurtra dhe afatmesme lidhur me këtë tregues fiskal. - Treguesit e Borxhit të Brendshëm - Treguesit e Borxhit të Jashtëm - Shërbimi i borxhit - Garancitë dhe nënhuatë.....	37-40
2.3	Paraqitja e treguesve të borxhit në tabelën fiskale dhe Raportin e Zbatimit të Buxhetit për vitin 2020. Testimi i përshtatshmërisë së raportimit të treguesve të borxhit publik	40-80
2.4	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme dhe probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.....	80-90
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	90-99

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i Shkurtër i Raportit të Auditimit.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 512/1prot, datë 14.05.2021, me afat auditimi nga data 17.05.2021 deri në datën 30.07.2021, për periudhën nga 01.01.2020 deri më 31.12.2020.

Drejtoria e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj e ushtron veprimtarinë në drejtim të regjistrimit të transaksioneve të borxhit publik, realizimin e huamamrjes në tregun e brendshëm dhe të jashtëm, kryerjen e pagesave të principalit dhe shpenzimeve të maturuara të interesit si dhe raportimin e tyre në treguesit e konsoliduar fiskalë. Gjithashtu drejtoria mban kontakte me kreditorët, kryen analiza dhe harton strategjinë afatmesme të menaxhimit të borxhit publik, komunikon me subjektet përfituese të marrëveshje të nënhuasë apo garancive shtetërore dhe angazhohet në arkëtimin e të drejtave që burojnë nga detyrimet e akumuluar nga këto subjekte.

Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë aktivitetin e huamarrjes dhe monitorimin e treguesve të borxhit. Qëllimi lidhet me vlerësimin nëse aktivitetet e autorizimit, mbikqyrjes dhe informacionet e raportuara në lidhje me borxhin publik janë në çdo aspekt material në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur aktet e konstatimit të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të auditimit brenda afatit të periudhës së auditimit datë 30.07.2021.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi u konstatua se përgjatë muajve prill – maj 2020, u miratua emetimi i dy garancive shtetërore në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, përkatësisht:</p> <p>-Me VKM Nr.277 datë 06.04.2020 u miratua garancia shtetërore të huasë me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e Këshillit të Ministrave, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar.</p> <p>Garancia e parë shtetërore u emetua në vlerën 11,000,000 mijë lekë, në favor të 12 bankave të nivelit të dytë.</p> <p>-Me VKM Nr.387 datë 13.05.2020 u</p>	40-80	E lartë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marr masa të menjëhershme për rishikimin e kuadrit ligjor në vijim të vlerësimit të problematikave të konstatuara nga ky auditim me qëllim shmangien e riskut për detyrimet e tjera të mundshme në të ardhmen.

<p>miratua garancia shtetërore e huasë, me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së tregtarëve ose shoqërive tregtare për të mundësuar financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar.</p> <p>Garancia e dytë shtetërore u emetua në vlerën 15,000,000 mijë lekë, në favor të 12 bankave të nivelit të dytë.</p> <p>Në të dyja VKM-t u përcaktuan gjithashtu kushtet e kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”.</p> <p>Nga auditimi mbi përputhshmërinë e tyre me Ligjin Nr. 9665 datë 18.12.2006 <i>“Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”</i> i ndryshuar, <u>u konstatuan problematika dhe mospërputhje që kanë rritur riskun e ekspozimit të shtetit shqiptar kundrejt detyrimeve.</u></p> <p>Marrëveshjet me Bankat për të dy garancitë sovrane të miratuara me VKM janë jo në përputhje si me Ligjin e Huamarrjes ashtu edhe me përcaktimet në nenet në brendësi të vetë marrëveshjes. Sqarojmë si në vijim:</p> <p>1. Pika 2, Neni 2, i aneksit të marrëveshjes miratuar me VKM Nr.370 datë 06.05.2020 citon se: Ministria e Financave dhe Ekonomisë krahas garantimit të principalit, merr përsipër të rimbursojë/paguajë interesat e Huave që do të trajtohen në këtë Marrëveshje Garancie.</p> <p>Ky përcaktim nuk gjen parashikim në Ligjin Nr. 9665 datë 18.12.2006 <i>“Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”</i> i ndryshuar, Neni 3 <i>“Kuptimi i garancisë shtetërore të huasë”</i> i cili citon se “Garancia shtetërore e huasë është</p>			
--	--	--	--

<p>marrëveshja e lidhur me shkrim, e cila përmban rregulla për të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet dhe mënyrat, sipas të cilave shteti është përgjegjës për detyrimet financiare të një huamarrësi, kur ai nuk arrin t'i paguajë ato në kohën dhe masën e duhur” dhe neni 34 “<i>Natyra e garancisë shtetërore</i>” i cili citon se “Garancia shtetërore e huasë nuk përbën detyrim të drejtëpërdrejtë për shtetin, por përfaqëson një detyrim të mundshëm. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtëpërdrejtë kur përfituesi i drejtëpërdrejtë nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë”.</p> <p>Për sa më sipër rimbursimi i Interesave të Huasë nga buxheti shtetit, përcaktuar me VKM nuk gjen mbështetje dhe parashikim në Ligjin e Huamarrjes shtetërore, pa plotësuar kushtin që përfituesi i drejtëpërdrejtë “të mos arrijë të paguajë”.</p> <p><u>Interesat e paguara nga Buxheti i Shtetit jo në përputhje me Ligjin Nr. 9665 datë 18.12.2006 i ndryshuar, deri në datën 31.12.2020 rezultojnë në vlerën prej 47,948 mijë lekë.</u></p> <p>2. Neni 2 “Garancia” e Marrëveshjes së Garancisë Sovrane 1, pika 3 dhe Neni 2 “Garancia “Marrëveshja e garancisë Sovrane 2 ”, pika 4 citon “Në asnjë rast, MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penalteteve që mund të burojnë nga Huatë që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve.</p> <p>Këto përcaktime, në të dyja Garancitë Sovrane, janë jo në përputhje me Ligjin e Huamarrjes, Neni 34 “Natyra e garancisë shtetërore” i cili citon se</p>			
--	--	--	--

<p>“Garancia shtetërore e huasë nuk përbën detyrim të drejtëpërdrejtë për shtetin, por përfaqëson një detyrim të mundshëm. <u>Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtëpërdrejtë kur përfituesi i drejtëpërdrejtë nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë.</u></p> <p>Sipas këtij përcaktimi Ligji i Huamarrjes parashikon mospagimin e interesave ose penaliteteve të cilat në fakt janë pjesë të detyrimit, në rast se përfituesi i drejtëpërdrejtë nuk arrin të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë.</p> <p>3. Neni 2 “Garancia” Marrëveshja e Garancisë së parë, pika 3 e cila citon se <i>“MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve” është jo në përputhje me Nenin 6 “Procedurat për kryerjen e pagesave të garancisë” së po kësaj marrëveshje pika 1</i> e cila citon <i>“Kur huamarrësi nuk ka mundur të kryej pagesën e detyrimeve në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë....huadhënësi rezervon të drejtën për t’i dërguar MFE-s kërkesën me shkrim për pagesën e detyrimeve dhe pikën 2</i> e cila citon se <i>“...Kërkesa për pagesë që Huadhënësi do t’i drejtojë MFE-s duhet të përmbajë:</i></p> <p><i>a) Një përshkrim të detajuar të shumës që kërkohet, duke përcaktuar në mënyrë analitike, principalin, interesat e akumuluar, penalitetet, si dhe cdo shpenzim tjetër të kryer në zbatim të marrëveshjes së huasë që është në ngarkim të Huamarrësit,</i></p>			
--	--	--	--

<p><i>pavarësisht faktit që garancia mbulon vetëm detyrimin e principalit të Huasë.</i></p> <p>Për sa më sipër Neni 2 dhe Neni 6 i marrëveshjes së Garancisë Sovrane 1 janë jo në përputhje me njëra tjetrën.</p> <p>4. Pika 2 e Nenit 2 të VKM Nr.370 datë 06.05.2020, për disa ndryshime në VKM Nr.277 datë 06.04.2020 e cila citon se “<i>MFE krahas garantimit të principalit merr përsipër të rimbursojë Interesat e Huave që do të trajtohen nën këtë marrëveshje Garancie...është jo në përputhje me pikën 3 të Nenit 2</i> e cila citon se “<i>MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë...</i>”.</p> <p>5. Neni 2 “Garancia” Marrëveshja e Garancisë Sovrane 2, pika 4 e cila citon se “<i>MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve</i>” është jo në përputhje me Nenin 6 “Procedurat për kryerjen e pagesave të garancisë” së po kësaj marrëveshje pika 1 e cila citon “<i>Kur huamarrësi nuk ka mundur të kryej pagesën e detyrimeve në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë....huadhënësi rezervon të drejtën për t’i dërguar MFE-s kërkesën me shkrim për pagesën e detyrimeve</i>” dhe pikën 2 e cila citon se “...Kërkesa për pagesë që Huadhënësi do t’i drejtojë MFE-s duhet të përmbajë:</p> <p>a) <i>Një përshkrim të detajuar të shumës që kërkohet, duke përcaktuar në mënyrë analitike, principalin, interesat e akumuluar, penalitetet, si dhe cdo shpenzim tjetër të kryer në zbatim të marrëveshjes së huasë që është në ngarkim të Huamarrësit, pavarësisht faktit që MFE garanton vetëm principalin në masën 60%.</i></p>			
---	--	--	--

<p>Për sa më sipër Neni 2 dhe Neni 6 i marrëveshjes së Garancisë Sovrane 2 janë jo në përputhje me njëra tjetrën.</p> <p>6. Nenet 36, 37, 38, 40 të Ligjit Nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar përcaktojnë kompetenca të plota të MFE për shqyrtimin, vlerësimin dhe dhënien e garancisë shtetërore të huasë si në vijim:</p> <p>Neni 36 “Shqyrtimi dhe analiza e garancisë”: “...kur dokumentacioni mbështetës i kërkesës për garanci është i plotë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, është i detyruar që Brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, të shpallë vendimin për dhënien e garancisë”.</p> <p>Neni 37 “Vlerësimi i riskut”: “...analiza ekonomike-financare sipas nenit 36, përfshin një përcaktim të riskut që merr përsipër shteti, në rast se jepet garancia. Ministri i Financave mund të kërkojë asistencën e Bankës së Shqipërisë për të përcaktuar dhe vlerësuar riskun”.</p> <p>Neni 38 “Dhënia e garancisë shtetërore të huasë”: “...Ministri i Financave dhe Ekonomisë miraton dhënien e garancisë shtetërore të huasë pasi shqyrton dokumentet e mëposhtme:</p> <p>a) <i>Projekt-marrëveshjen e huasë ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit;</i></p> <p>b) <i>Projektmarrëveshjen e garancisë ndërmjet institucionit huadhënës dhe shtetit;</i></p> <p>c) <i>Marrëveshjen e mirëkuptimit, të nënshkruar nga huamarrësi.</i></p> <p>Neni 40 “Mbikëqyrja nga Ministria e Financave”...Ministria e Financave kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marr garanci shtetërore të Huasë...”</p> <p>Ndërkohë Neni 3 i marrëveshjeve të garancive Sovrane 1 dhe 2 “Kriteret e</p>			
--	--	--	--

<p>kualifikimit të Huamarrësve”, pika 1 e cila citon se “Huadhënësi do të jap hua të garantuar vetëm huamarrësve që plotësojnë kriteret si në vijim...” ka një përcaktim të ndryshëm nga Nenet 36-37 të Ligjit Nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar në lidhje me përgjegjësitë lidhur me vendimmarrjen mbi garancitë shtetërore të huasë, pasi ky Nen ia kalon kompetencën Bankave të nivelit të dytë, duke rritur riskun e mosvlerësimit të drejtë ana e bankave të nivelit të dytë të aktivitetit dhe aftësisë pagueuse të subjekteve që kanë aplikuar për kredi, në kushtet e ofrimit të një garancie nga Shteti.</p> <p>7. Në lidhje me kthimin e garancisë shtetërore të huasë marrëveshja e garancive sovrane, nenit “Rikuperimi post-pagesës së garancisë” i cili citon se “...nëse pas 2 vitesh nga data e kryerjes së Pagesës së Garancisë, Huadhënësi nuk ka mundur të rikuperojë detyrimet e Huamarrësit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron të drejtën që të ndjekë vet procedurat ligjore, është jo në përputhje me Nenin 42 të Ligjit të Huamarrjes i cili citon se “Me kryerjen e pagesës në llogarinë e garancisë shtetërore të huasë institucionit huadhënës, Ministri i Financave merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë...”, <u>pasi ky i fundit nuk parashikon afat kohor, por i jep të drejtën Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për të vepruar vet dhe direkt me qëllim rikuperimin e detyrimeve.</u></p> <p>Për sa më sipër shprehemi se garancitë shtetërore të miratuara me VKM, konstatohen jo në përputhje me Ligjin Nr.9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin</p>			
--	--	--	--

	<p>shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.</p> <p>Si rezultat jo vetëm janë paguar nga buxheti i shtetit interesa të kredive në bankat e nivelit të dytë jo në përputhje me Ligjin Nr.9665 datë 18.12.2006 i ndryshuar në vlerën prej 47,948 mijë lekë për vitin 2020, por edhe është rritur risku i ekspozimit të shtetit kundrejt detyrimeve të tjera të mundshme.</p>			
2	<p>Në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, nga qeveria u akorduan gjithsej 26 miliard Lekë në formën e garancive, të cilat deri në fund të vitit 2020 mundësuan kreditimin e shoqërive tregtare me 14.9 miliard Lekë.</p> <p>Garancia e parë shtetërore e miratuar me VKM Nr.277 datë 06.04.2020 u emetua në vlerën 11,000,000 mijë lekë, në favor të 12 bankave të nivelit të dytë. Kredia e miratuar nga bankat e nivelit të dytë kundrejt huamarrësve rezultojnë në vlerën 5,901,304 mijë, nga të cilat deri në 31.12.2020 u disbursuan 5,332,741 mijë lekë. Stoku i detyrimit në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 4,522,952 mijë lekë.</p> <p>Garancia e dytë shtetërore e miratuar me VKM Nr.387 datë 13.05.2020 u emetua në vlerën 15,000,000 mijë lekë, në favor të 12 bankave të nivelit të dytë. Kredia e miratuar nga bankat e nivelit të dytë kundrejt huamarrësve rezultojnë në vlerën 8,950,621 mijë, nga të cilat deri në 31.12.2020 u disbursuan 8,240,103 mijë lekë. Stoku i detyrimit në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 7,629,463 mijë lekë.</p> <p>Deri në fund të vitit 2020 Garancia Sovrane 1 është përdorur në masën prej rreth 54% (vlera e miratimeve kundrejt totalit) ndërsa Garancia Sovrane 2 është</p>	40-80	E lartë	<p>- Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marr masa të menjëhershme për ngritjen e një grup pune me qëllim verifikimin e plotësisimit të kriterëve për përfitimin e garancive sovrane dhe në konkluzion të tij, të marri masa për rishikimin ose ndërprerjen e garancive sovrane nëse konstatohen garanci të përfituara jo në përputhje të plotë me dispozitat ligjore.</p> <p>- Ministria e Financave dhe Ekonomisë të vlerësojë strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj dhe rishikimin e strukturës dhe kompetencave të kësaj Drejtorie me qëllim monitorimin e risqeve të borxhit publik dhe menaxhimin sa më efektiv të garancive sovrane.</p>

<p>përdorur në masën prej 36%, ku kjo e fundit ka vazhduar të përdoret deri në afatin e shtyrë për aplikime 30.06.2021. Me qëllim monitorimin, shqyrtimin dhe raportimin periodikisht pranë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në lidhje me ecurinë e garancive shtetërore me Urdhërin Nr.56 datë 23.04.2020 të Kryeministrit u ngrit Komiteti i Monitorimit.</p> <p>Me Urdhërin Nr.108 prot me nr 7868 datë 06.05.2020 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë u miratua Sekretariatit Teknik dhe rregullorja e funksionimit të Komitetit të monitorimit të ecurisë së garancisë shtetërore të Huasë”.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj nuk disponohen kopje të dosjeve, ekstrakteve, dokumentave, të dhënave të regjistruara dhe të shkresave të të gjitha huave që i nënshtrohen këtyre marrëveshjeve të garancive, kjo jo në përputhje me: <ul style="list-style-type: none"> -Nenin 4 pika 9 e marrëveshjes së parë dhe Nenin 4, pika 10 e marrëveshjes së dytë “Huadhënësi do të vendos në dispozicion të MFE, me kërkesë të kësaj të fundit, kopje të dosjeve, dokumentave, rekordeve dhe shkresave të të gjitha huave që i nënshtrohen këtyre garancive”. -Nenin 8 pika 1 marrëveshjes së garancive sovrane 1 dhe 2“Huadhënësi do të raportojë do të raportojë në formë elektronike pranë MFE...duke përcjellë dhe kopje të dokumentave shoqëruese që vërtetojnë kriteret e kualifikimit të Huamarrësve. -Nenin 35 të Ligjit të Huamarrjes “...cdo huamarrës në bazë të këtij ligji paraqet një kërkesë me shkrim, e cila shoqërohet me dokumentacionin ekonomik dhe financiar për t'i 			
---	--	--	--

<p><i>mundësuar Ministrit të Financave të vlerësojë kushtet financiare dhe aftësinë e pagimit nga huamarrësi”.</i></p> <p>➤ Pikën 6.1 e Rregullores së Funksionimit të Komitetit të Monitorimit, Kreun 7 “Monitorimi dhe Auditimi i garancive shtetërore”, miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, e cila citon se “Garantuesi nëpërmjet Komitetit/ nuk është i detyruar të monitorojë ose verifikojë, dhe nuk do të jetë përgjegjës për monitorimin ose verifikimin e kritereve dhe përdorimin e shumave nga Huadhënësi për klientët...” është jo në përputhje me:</p> <p>- <i>Pikën 1 të Urdhërit të Kryeministrit Nr.56 datë 23.04.2020 “Për ngritjen e Komitetit të Monitorimit”... “<u>urdhëroj ngritjen e Komitetit të Monitorimit, i cili do të monitorojë, shqyrtojë dhe do të raportojë periodikisht pranë Ministrit të Financave ...si dhe për përcaktimin e kushteve dhe kritereve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”.</u></i></p> <p>- <i>Pikën 8 të marrëveshjeve të garancive sovrane, miratuar me VKM: “<u>Struktura e posacme ndërinstitucionale...do të miratojë, shqyrtojë dhe raportojë ...”</u></i></p> <p>- <i>Nenet 36, 37, 38 të Ligjit Nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar, të cilat përcaktojnë kompetenca të plota të MFE për shqyrtimin, vlerësimin dhe dhënien e garancisë shtetërore të huasë.</i></p> <p>➤ Në lidhje me pikën 1 “miratimi i linjës së garancisë shtetërore 1, në favor të bankave të nivelit të dytë, pjesë e skemës së garancisë që do të mundësojë huadhënien për të përballuar pagat e tregtarëve ose të shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave</p>			
--	--	--	--

<p>është mbyllur ose është ndikuar me ulje të xhiros...dhe Nenin 3, garancisë shtetërore 2 “Kriteret e kualifikimit të huamarrësve dhe kriteret për përfitimin e huasë” pika b) huamarrësi mund të jetë subjekt që ushtron veprimtarinë tregtare në të gjithë sektorët e ekonomisë, me kusht që <u>veprimtaria e tij tregtare të jetë prekur direkt ose indirekt nga aktet ligjore dhe nënligjore të qeverisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, nëpërmjet mbylljes së përkohshme të akvitetit tregtar ose nëpërmjet ndikimit me ulje të akvitetit tregtar, <u>mungon gjurma e auditimit për të verifikuar plotësimin e tyre si kriter, duke qënë se vendimmarrja dhe kompetenca i është lënë bankave të nivelit të dytë.</u></u></p> <p>➤ Janë konstatuar subjekte që kanë përfituar nga kredia në më shumë së 1 bankë, si rrjedhojë edhe nga Garancia Sovrane 1 jo në përputhje me pikën 7 të nenit 4 “Detyrimet e Huadhënësit” të VKM Nr.277 datë 06.04.2020, e cila përcakton se: “Në rast se huamarrësi ka marr një hua për këtë program nga banka të tjera, cdo hua tjetër për paga nuk do të jetë subjekt i kësaj marrëveshje”.</p> <p>Në 31.12.2020 shteti shqiptar rezulton garantor i të njëjtit subjekt huamarrës në 2 ose 3 banka të ndryshme në vlerën e stokut prej 733,760 mijë lekë.</p> <p>Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është argumentuar se financimi, si rrjedhojë edhe garancia rezulton në disa banka pasi dhe vet punonjësit e subjekteve janë pagamarrës në banka të ndryshme. Pavarësisht këtij argumenti, kjo mbetet jo në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes së garancisë sovrane 1, miratuar me VKM.</p> <p>Në 31.12.2020 shteti shqiptar rezulton garantues i vlerës totale prej</p>			
---	--	--	--

	<p>9,100,629 mijë lekë.</p> <p>Për sa më sipër shprehemi se mungesa e vlerësimit dhe monitorimit të garancive nga MFE në lidhje me plotësimin ose jo të kriterëve për përfitimin e garancisë sovrane kanë rritur riskun e ekspozimit të shtetit kundrejt detyrimeve të tjera të mundshme në të ardhmen dhe riskun e rritjes së borxhit publik.</p>			
3	<p>Gjatë vitit 2020 nuk është emetuar bono thesari 6-mujore për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit në shumën 6,242,963,462 lekë me efekt në nënvlerësimin e stokut të borxhit në fund të vitit 2020. Banka e Shqipërisë me shkresë nr. 742/1 datë 27.04.2020 ka vendosur në dijeni MFE se në përfundim të procesit të auditimit të pasqyrave financiare të BSH llogaria “Rezerva e Rivlerësimit të Valutave” në mbyllje të vitit financiar 2019 ka rezultuar me gjendje negative 6,242,963,462 lekë, për të cilën në zbatim të nenit 64 (b) të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e shqipërisë” të ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 6 të marrëveshjes “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë” ka kërkuar mbulimin e saj me emetim të bonove të thesarit 6-mujore. Nga ana e MFE me shkresë nr. 7241/1 datë 18.06.2020 drejtuar Bankës së Shqipërisë është njoftuar emetimi i letres me vlere në shumën 6,242.963.462 lekë me afat maturimi 6 muaj dhe normë interesi të barabartë me yield mesatar të ponderuar të ankandit të fundit të bonove të thesarit me afat maturimi 6-mujor.</p> <p>Në vijim, në afatin e maturimit, nga ana e BSH me shkresë nr. 2020/2 datë</p>	40-80	E lartë	<p>Nga ana e MFE të kryhen veprimet e rregulluese duke e raportuar stokun e borxhit publik me përfshirjen e bonos përkatëse 6-mujore në regjistrin e borxhit dhe treguesit e borxhit publik. Të rishikohet marrëveshja me Bankën e Shqipërisë në mënyrë që të parashikohet detyrimi për paraqitjen e kërkesës për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit përpara hartimit të ligjit të buxhetit vjetor.</p>

	<p>18.12.2020 drejtuar MFE, protokolluar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me prot 23754 prot, datë 21.12.2020 është kërkuar riemetimi i titullit 6-mujor që maturohet në datë 21.12.2020, nëpërmjet rinovimit me çmim blerje të instrumentit me vlerë 6,242,963,462.33 lekë. Kjo shkresë është përcjellë në Drejtorinë e Huamarrjes në datën 28.12.2020.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se në vijim të shkresës nr 2020/2 prot, datë 18.12.2020, referuar marrëveshjes së datës 20.01.2015 nr 716/6 prot, “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë”, Neni 6 <i>Mbulimi i humbjeve neto nga rivlerësimi</i>”, Ministria e Financave ka rinovuar emetimin me vlerë në shumën 6,242,963,462 lekë e njëjtë me nivelin e yield-it mesatar të ankandit më të fundit të Bonove të Thesarit me afat maturimi 6 mujor, në momentin e emetimit të letrës me vlerë në datën 11.01.2021, përtej datës së maturimit 21.12.2020. Si konkluzion kjo letër me vlerë nuk është paraqitur në regjistrin e borxhit për vitin 2020, treguesit e borxhit dhe rrjedhimisht stokun e borxhit publik të fundvitit 2020.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se nuk është përmbushur detyrimi për refinancimin e këtij instrumenti brenda afateve të përcaktuara.</p>			
4	<p>Nga auditimi është konstatuar se pagesat e principalit dhe interesave për garancitë jo performuese nuk kryhen nga MFE pasi të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme nga ana e institucionit huadhënës për rikuperimin e detyrimit, por vetëm bazuar në vetdeklarimin e përfituesit të garancisë</p>	40-80	E lartë	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e Autoritetit Publik dhe të Kompetencës nëpërmjet nga strukturat e borxhit, të ndjek të gjitha rrugët ligjore që të merren masa për hartimin dhe implementimin e procedurave të qarta ligjore me qëllim</p>

<p>mbi paaftësinë paguese të tij. Nga auditimi është konstatuar se pagesat e kryera nga Buxheti i Shtetit për garancitë e huaja jo-performuese kryhen jo në përputhje me kërkesat e nenit e nenit 42 të ligjit nr. 9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në të cilën citohet se “Kur huamarrësi s'ka mundur të bëjë pagesën/pagesat, në përputhje me kushtet dhe afatet e marrëveshjes së huasë, të përcaktuara për këtë qëllim dhe institucioni huadhënës vërteton se ka marrë të gjitha masat e nevojshme, siç përcaktohet në këtë ligj dhe në marrëveshjen e garancisë, për të marrë në dorëzim pagesën/pagesat e premtuara, institucioni huadhënës i paraqet Ministrit të Financave një kërkesë për pagesë, në përmbushje të së drejtës së tij, sipas garancisë shtetërore të huasë. Ministri i Financave, pasi vëren se kërkesa për pagesë është në përputhje me kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për institucionin huadhënës brenda pesëmbëdhjetë ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës”. Aktualisht konstatohet se procesi konsiston në komunikim paraprak nga MFE me përfituesin e garancisë i cili konfirmon nëse është apo jo në gjendje që të shlyejë këstin e radhës dhe në rast të gjendjes së paaftësisë paguese nga ana e tij procedohet me pagesën nga</p>			<p>përcaktimin e një procedurë që parashikon monitorimin proaktiv dhe dinamik dhe konfirmimit të gjendjes financiare dhe aftësisë paguese të subjekteve kredimarrëse (përmes aksesit të autorizuar në informacion mbi gjendjen e llogarive bankare të subjekteve përfituese të garancisë), përpara realizimit të pagesës në mbështetje të vështirësisë financiare të deklaruar nga subjektet përfituese.</p>
---	--	--	--

	Buxheti i Shtetit. Një procedurë e tillë, sipas komenteve të përfaqësuesve të Drejtorisë së Borxhit është kryer me qëllim shmangien e kamatëvonesave apo penaliteteve në rast vonese të pagesës si pasojë e procedurës për ndjekjen e paaftësisë paguese deri në kërkesën e huadhënësit drejt MFE.			
5	<p>Nga auditimi i ushtruar, u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, me shkresën nr.344/8, datë 29.10.2020, ku nga 10 rekomandime, janë pranuar nga titullari 9 rekomandime, ose 90% e tyre. Nga rekomandimet e pranuar:</p> <p>A- Për propozim për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi është rekomanduar 1 masë e cila është në proces zbatimi.</p> <p>B- Për përmirësimin e gjëndjes janë rekomanduar 7 masa organizative, ku 6 janë pranuar nga të cilat 1 rekomandim është zbatuar plotësisht, 3 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, 2 rekomandime janë në proces zbatimi</p> <p>C- Për eleminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, janë rekomanduar 2 masa të cilat janë të zbatuara pjesërisht.</p>	40-80	E lartë	Ministria e Financave të rishqyrtojë dhe të analizojë situatën lidhur me rekomandimet e pa realizuara, duke marrë masa të menjëhershme për nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësi konkrete ligjore për moszbatimin e tyre, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 344/8, datë 29.10.2020.
6	KLSH ka konstatuar krijim të detyrimeve të reja në shumën 7,750 milionë lekë (rreth 62.6 milion euro) të subjekteve nënhuamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë përgjatë vitit 2020, si pasojë e mos shlyerjes së	80-90	E lartë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa të menjëhershme për rikuperimin e të drejtave për të arkëtuar nëpërmjet ushtrimit të instrumentave ligjore që

<p>detyrimeve përkatëse. Nga auditimi në lidhje me marrëveshjet e nënhuasë konstatohet se stoku i kredive në lidhje me këtë komponent të borxhit shtetëror është përkeqësuar përgjatë vitit 2020.</p> <p>Sektorët me përkeqësim të situatës financiare paraqiten sektori i energjitikës kryesisht me nënhuatë e K.E.SH, OSHEE dhe OST me rreth 5,791 milion lekë (46.8 milion euro) të rritjes totale të detyrimeve nga 7,750 milion lekë në total, pushteti vendor me rreth 1,173 milion lekë (9.5 milion euro) dhe sektori i ujësjellësve me rreth 768 milion lekë (6.2 milion euro). Në nenin 30 “Huadhënia e të ardhurave të borxhit shtetëror, mbi të cilat zbatohen kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare”, <i>të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është përcaktuar që “...është përgjegjësi ligjore e huamarrësve, të cilët kanë marrë fonde, sipas paragrafit të parë të këtij neni, që ti kthejnë fondet e marra hua në përputhje me marrëveshjet e nënhuave dhe të paraqesin raporte përgjendjen e huasë dhe përdorimin e saj, sipas kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Financave”.</i></p> <p><i>Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet e bëra në këtë nen, duke paraqitur një situatë ku detyrimet ndaj shtetit si pasojë e mos pagesave janë rritur nga viti në vit, duke filluar nga 15,814 milion lekë në fund të vitit 2017, në 21,279 milion lekë në fund të vitit 2018, në 27,344 milion lekë në fund të vitit 2019, dhe në 35,094 milion lekë në fund të vitit 2020. Detyrimet ndaj shtetit si pasojë e mos pagesave përgjatë vitit 2020 janë rritur me 7,750 milion lekë.</i></p>			<p>rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuasë.</p>
--	--	--	--

7	<p>Gjatë vitit 2020 janë krijuar detyrime të reja në shumën 3,051 milion lekë (3 miliard lekë) në kuadër të dështimit të pagesave për kreditë e garantuara nga përfituesi i garancisë. Garancitë shtetërore përgjatë vitit 2020 paraqesin një risk të shtuar në drejtim të administrimit të tyre dhe situatës së rënduar financiare të cilën kalon kryesisht sektori energjistik.</p> <p>Për vitin 2020 gjendja e detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është rritur nga 13,198 milion lekë në 15,885 milion lekë, me një rritje vjetore prej 2,687 milion lekë, pa përfshirë efektin e garancive të dhëna në kuadër të projektit me numër identifikimi në regjistrin e kredive “88” në vlerën 364 milion lekë. Me këtë efekt rritja vjetore vlerësohet në shumën 3,051 milion lekë, ose 3 miliard lekë.</p> <p>Detyrimet si pasojë e pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit për vitin 2020 janë akumuluar në masën më të madhe nga kompanitë private me kapital shtetëror përfituese në sektorin energjistik në shumën 2,098 milion lekë (16.96 milion euro). Gjatë vitit 2020 konstatohet se Buxheti i Shtetit ka kryer pagesa si pasojë e paaftësisë paguese edhe të R.T.S, duke rritur stokun e detyrimeve me 354 milion lekë (2.86 milion euro). Gjithashtu edhe në sektorin e ujësjellësve për projektet në U.K.T situata paraqitet problematike duke vendosur Buxhetin e Shtetit në risk për kryerjen e pagesave që kanë dështuar të kryhen nga ky përfitues i garancisë dhe rritjen e detyrimeve në shumën 146 milion lekë (1.18 milion euro).</p> <p>Në nenin 43 “Kthimi i garancisë shtetërore të huasë” të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen</p>	40-80	Ministria e Financave dhe Ekonomisë të rishikojë kuadrin ligjor për shtimin e instrumentave me qëllim administrimin efikas të riskut të garancive. Në vijim të ushtrijë të gjitha mjetet ligjore për arkëtimin e të drejtave për pagesa të kryera për garancitë e arkëtuara dhe në të njëjtën kohë të ushtrijë kontroll mbi planet ekonomike dhe financiare për shlyerjen e këtyre shumave.	

	<p>shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është përcaktuar që “Me kryerjen e pagesës në llogarinë e garancisë shtetërore të institucionit huadhënës, Ministri i Financave merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, në masën e çdo pagese të bërë në kuadër të garancisë së dhënë. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë Ministrin të Financave së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ai i ka në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit. Huamarrësi, në zbatim të këtij ligji dhe të marrëveshjes së mirëkuptimit, është i detyruar ti kthejë Ministrisë së Financave shumën që kjo e fundit i ka paguar huadhënësit, në kuadër të garancisë shtetërore të huasë. Ministri i Financave ndërmerr të gjitha masat e paracaktuara në këtë ligj, në ligje të tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përftuar nga huamarrësi çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të.”</p> <p>Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet e bëra në këtë nen, për aq kohë sa stoku i detyrimeve jo vetëm që nuk është ulur përgjatë vitit 2020, por edhe është rritur me 3 miliard lekë. Konstatohet se masat e marra janë të pa mjaftueshme për zgjidhjen e situatës së krijuar ku risku i kreditit të këtyre institucioneve është mjaft i lartë.</p>			
--	---	--	--	--

3. Konkluzioni i Përgjithshëm Dhe Opinioni i Auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinioni i Auditimit të Përputhshmërisë

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik

dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, bazuar në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinionin, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime materiale por jo të përhapura, jo në përputhje me kriteret e auditimit

Baza për opinionin e auditimit

Problematikat e konstatuara përfshijnë:

- Arkëtimi i të drejtave të Buxhetit të Shtetit nga marrëdhëniet e nënhuasë jo vetëm që nuk realizohet në mënyrë që të mblidhen detyrimet që subjektet kanë krijuar ndër vite, por gjatë periudhës objekt auditimi janë krijuar detyrime të reja në shumën 7,750 milion lekë.
- Garancitë e jashtme paraqesin një risk të shtuar në gjykimin e grupit të auditimit duke angazhuar pagesa të konsiderueshme nga Buxheti i Shtetit si pasojë e paaftësisë së përfituesve të garancisë për të realizuar shlyerjen e tyre dhe nga ana tjetër këto pagesa të kryera nuk kthehen në Buxhetin e Shtetit, ku vetëm për periudhën objekt auditimi rritja e detyrimeve të garancive vlerësohet në rreth 2,687 milion lekë.
- Gjatë periudhës auditimi nuk është emetuar bono thesari 6-mujore për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë në shumën 6,243 milion lekë.
- Miratimi me VKM Nr.277 datë 06.04.2020 dhe VKM Nr.387 datë 13.05.2020 i garancive shtetërore jo në përputhje me Ligjin Nr.9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar duke sjellë ekspozim të lartë të shtetit kundrejt detyrimeve të mundshme të huamarrësve të cilat rezultojnë të pavlerësuar dhe të pamonitoruara nga MFE në lidhje me plotësimin ose jo të kriterëve për përfitimin e garancisë sovrane.

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Drejtimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për planifikimin, realizimin dhe raportimin e aktivitetit të huamarjes vjetore dhe treguesve të borxhit publik.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e MFE është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit..

Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne: Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuar, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm.

Krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke patur si qëllim kryesor dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutine të raportimit të treguesve fiskalë janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion u konsiderua i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve të mbajtura si dhe observacioneve të paraqitura për këto akte u përgatit Raporti i Auditimit.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

I. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 512/1, datë 14.05.2021 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 17.05.2021 deri në datë 30.07.2021, në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për periudhën nga 01.01.2020 deri në 31.12.2020 u krye auditimi “Mbi treguesit e borxhit publik për vitin 2020” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A.P, Përgjegjës Grupi
2. E.H, Auditues
3. R.XH, Auditues

1. Objektivat dhe qëllimi. Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë aktivitetin e huamarrjes dhe monitorimin e treguesve të borxhit. Qëllimi lidhet me vlerësimin nëse aktivitetet e autorizimit, mbikqyrjes dhe informacionet e raportuara në lidhje me borxhin publik janë në çdo aspekt material në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti.

2. Identifikimi i çështjes. Drejtoria e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj e ushtron veprimtarinë në drejtim të regjistrimit të transaksioneve të borxhit publik, realizimin e huamarrjes në tregun e brendshëm dhe të jashtëm, kryerjen e pagesave të principalit dhe shpenzimeve të maturuara të interesit si dhe raportimin e tyre në treguesit e konsoliduar fiskalë. Gjithashtu drejtoria mban kontakte me kreditorët, kryen analiza dhe harton strategjinë afatmesme të menaxhimit të borxhit publik, komunikon me subjektet përfituese të marrëveshje të nënhuasë apo garancive shtetërore dhe angazhohet në arkëtimin e të drejtave që burojnë nga detyrimet e akumuluar nga këto subjekte.

3.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim
Përgjegjësia e strukturave drejtuese të MFE për borxhin publik është e lidhur me realizimin e huamarrjes dhe raportimin e treguesve të borxhit

4.Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për borxhin publik. Auditimi është kryer në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

5.Kriteret e vlerësimit. Për dhënien e opinionit të përputhshmërisë jemi bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të ligjit për huamarrjen dhe për menaxhimin e sistemit buxhetor.

6.Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës. Auditimi është kryer sipas standarteve ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI.

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik“ që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
 - ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë“ që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
 - ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200;
 - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
 - Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t,
- INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

7.Dokumentimi i auditimit.

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet testeve të kontroleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm u administrua dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar vlerësimin përmes skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH.

8.Metodat e auditimit:

1. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta.

2. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

3. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

- 1. Informacioni i përgjithshëm** – Veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përfshin aktivitete në drejtim të administrimit të regjistrimit të borxhit, të raportit të treguesve të borxhit publik, realizimit të huamarrjes etj.

Veprimtaria e huamarrjes

Objekti i veprimtarisë në mënyrë specifike përcaktohet në emetimin dhe menaxhimin e huamarrjes shtetërore, të borxhit shtetëror dhe të garancive shtetërore të huasë. Në këtë mënyrë, menaxhimi i borxhit vlerësohet si veprimtari shtetërore, qëllimi kryesor i së cilës është sigurimi i fondeve të nevojshme të huamarrjes, duke vlerësuar riskun dhe koston e tij, në këndvështrimin afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe zhvillimin e tregut të titujve të shtetit. Qëllimi i marrjes së huasë është definuar në nenin 7 të ligjit të huamarrjes ku është përcaktuar “*Ministri i Financave, në emër të Këshillit të Ministrave, merr hua:*

- a) për të financuar deficitin buxhetor të shtetit;*
- b) për të financuar mungesën e përkohshme të likuiditetit;*
- c) për të rifinancuar borxhin shtetëror, të nënshkruar më parë;*
- ç) për të paguar garancitë shtetërore;*
- d) për të paguar koston e emetimit të borxhit shtetëror;*
- e) Për të financuar nevojat e njësisve të qeverisjes vendore dhe të subjekteve të tjera, për qëllim të financimit të projekteve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.*
- dh) për të përballuar koston e shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore dhe emergjenca të tjera.”*

Rritja vjetore e borxhit dhe nënshkrimi i borxhit të ri

Çdo vit buxhetor përcaktohet në ligjin e buxhetit të vitit përkatës kufiri për rritjen e borxhit publik dhe në vijim ai detajohet sipas instrumentave përkatëse në financim të brendshëm dhe të jashtëm. Në të njëjtën kohë parashikohen edhe pagesat për shërbimin e borxhit që përfshijnë pagesat e principalit, shpenzimet e interesit si dhe një kontigjencë për risqet e borxhit publik. Borxhi i ri i marrë mund të jetë në formën e titujve të shtetit afatgjatë ose afatshkrutër (bono thesari ose obligacione), marrëveshjeve të huasë shtetërore apo garancitë shtetërore të huasë. Titujt e shtetit emetohen me anë të ankandit ose në bazë të marrëveshjeve dypalëshe/shumëpalëshe. Ankandet e titujve të brendshëm zhvillohen në Bankën e Shqipërisë që administron sistemin AFISAR. Nga ana tjetër, procedura e negociimit dhe miratimit të marrëveshjeve për huatë shtetërore/garancitë shtetërore përfshin përcaktimin e kushteve thelbësore nga ministri i financave, lëshimin e një opinionit ligjor nga Ministri i Drejtësisë dhe në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare më tej ratifikohen me ligj në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Fondet e përfituara nga huatë shtetërore depozitohen në Bankën e Shqipërisë, në një nënlligari të veçantë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Administrimi i marrëveshjeve të nënshkrimit

Ministri i Financave, jep hua nga fondet që përbëjnë të ardhura të borxhit shtetëror, për huamarrësit, përfshirë këtu edhe institucionet financiare dhe pushtetin vendor, me veprimtari kryesore brenda Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që këta të fundit të mundësojnë financimin e projekteve të investimit, importit apo të veprimtarive të tjera. Procedurat për huazimin e fondeve dokumentohen me shkrim, nëpërmjet marrëveshjeve të nënshkrimit, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe huamarrësit. Është përgjegjësi ligjore e huamarrësve, të

cilët kanë marrë fonde, që t'i kthejnë fondet e marra hua në përputhje me marrëveshjet e nënshkrimeve. Ministri është i autorizuar të ndërmarrë çdo hap tjetër lehtësues ligjor për mbledhjen e të ardhurave.

Administrimi i garancive shtetërore

Garancia shtetërore e huasë nuk përbën detyrim të drejtpërdrejtë për shtetin, por përfaqëson një detyrim të mundshëm të tij. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtpërdrejtë në rastin kur përfituesi i drejtpërdrejtë i huasë nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë. Garancia shtetërore e huasë konvertohet në borxh shtetëror pas përcaktimit nga Ministri i Financave se pagesa apo pagesat e papaguara për huanë, për të cilën është dhënë garancia, nuk janë bërë në përputhje me kushtet dhe afatet e huasë, duke shkaktuar në këtë mënyrë mospërbushjen e detyrimit të huamarrësit. Ministria e Financave kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marrë garanci shtetërore të huasë. Kur huamarrësi s'ka mundur të bëjë pagesën/pagesat, në përputhje me kushtet dhe afatet e marrëveshjes së huasë, të përcaktuara për këtë qëllim dhe institucioni huadhënës vërteton se ka marrë të gjitha masat e nevojshme, siç përcaktohet në ligjin e huamarrjes dhe në marrëveshjen e garancisë, për të marrë në dorëzim pagesën/pagesat e premtuara, institucioni huadhënës i paraqet Ministrin të Financave një kërkesë për pagesë, në përmbushje të së drejtës së tij, sipas garancisë shtetërore të huasë. Me kryerjen e pagesës në llogarinë e garancisë shtetërore të huasë institucionit huadhënës, Ministri i Financave merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, në masën e çdo pagese të bërë në kuadër të garancisë së dhënë. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë Ministrin të Financave, së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ai ka në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit. Huamarrësi, në zbatim të ligjit të huamarrjes dhe të marrëveshjes së mirëkuptimit, është i detyruar t'i kthejë Ministrisë së Financave shumën që kjo e fundit i ka paguar huadhënësit, në kuadër të garancisë shtetërore të huasë. Ministri i Financave ndërmerr të gjitha masat e paracaktuara në ligjin e huamarrjes, në ligje të tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përftuar nga huamarrësi çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të.

Administrimi i regjistrit të borxhit

Regjistri i borxhit shtetëror përmban të dhëna për borxhin shtetëror, të emetuar në formën e titujve të shtetit dhe borxhin në formën e marrëveshjeve të huasë. Për administrimin e të dhënave për borxhin shtetëror dhe për garancitë shtetërore të huasë, Ministria e Financave krijon dy regjistra: a) regjistrin e borxhit shtetëror; b) regjistrin e garancive shtetërore të huasë. Regjistri i garancive shtetërore të huasë përmban informacion, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e miratuar nga Ministri i Financave. Ky regjistër publikohet në baza tremujore nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë së bashku me treguesit kryesorë të borxhit publik.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Vlerësimi i kuadrit rregullator në fuqi lidhur me borxhin publik. Struktura e Drejtorisë së Borxhit dhe përshtatshmëria e saj në funksion të arritjes së menaxhimit të kujdesshëm të borxhit. Sistemet e kontrollit të brendshëm dhe përshtatshmëria e tyre.

“Mbi auditimin e vlerësimit të funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i

ndryshuar. Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi e komunikimi, monitorimi”

Objekti i këtij auditimit është auditimi i sistemeve të kontrollit të ndjekura nga Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj, për periudhën 01.01.2020 deri në periudhën 31.12.2020.

Në zbatim të pikës “a” të programit të auditimit nr. “Nr 512/1 Prot. datë 14.05.2021”, për periudhën 2020, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- *Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj*
- *Dosjet e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj, vlerësimet e punës, trajnimet, përshkrimet e punës, rekrutime,*
- *Ligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar me Ligjin nr.178 / 2014*
- *Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*
- *Memo, shkresa përcjellëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj*
- *Manualin për MFK-në (miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016*
- *Procedura, procese pune, etapa raportimi*
- *Strategjia afatmesme e monitorimit të Borxhit*
- *Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15/10/2015*
- *Ligji nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar*

Në zbatim të nenit 9 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj. Në kuptimin e këtij ligji, menaxhimi dhe kontrolli financiar përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e borxhit, kontabilitetin dhe raportimin, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimet apo pasaktësitë në raportim.

Strukturat përgjegjëse të MFE kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin për MFK-në (miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016) si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Nga auditimi rezultoi se, Drejtoria e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj përgjatë vitit 2020 ka funksionuar mbi bazën e Rregullores së Brendshme, e miratuar me Urdhër Nr 29.01.2016 prot nr 1407, datë 29.01.2016 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Ministrisë së Financave”.

Nga auditimi kemi konstatuar se Rregullorja e Brendshme nuk ka qënë e përditësuar me ndryshimet në strukturë dhe organikën e miratuar me urdhrin Nr.8 datë 31.01.2017 dhe Nr.161 datë 05.10.2017 të MFE. Kjo rregullore i përgjigjet kërkesave të Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit sipas strukturës së vjetër kur përbëhej nga:

-Drejtoria e Huamarrjes

-Drejtoria e Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit

Në këtë mënyrë, mungesa e një rregulloreje që t’i përshtatej ndryshimeve strukturore ka rritur riskun e cënimit të mjedisit të kontrollit për vitin 2020.

Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përditësimi i rregullores është bërë me Urdhërin Nr.52 datë 10.03.2021 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Ministrisë së Financave”.

A.1 Organika / Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj.

Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj ka të miratuar në strukturë 25 punonjës: 1 Drejtor të Përgjithshëm, 3 Drejtor, 6 përgjegjës sektori, 15 specialistë, si në vijim:

Drejtor i Përgjithshëm	1	II-a
Drejtoria e Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndihmës së Huaj (8)		
Drejtor	1	II-b
Sektori i Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj (3)		
Përgjegjës Sektori	1	III-a
Specialist	1	III-b
Specialist	1	III-b
Sektori i Sigurimit të Ndihmës së Huaj dhe Marrëveshjeve (4)		
Përgjegjës Sektori	1	III-a
Specialist	1	III-b
Specialist	1	III-b
Specialist	1	III-b
Drejtoria e Huamarrjes (9)		
Drejtor	1	II-b
Sektori i Huamarrjes në Tregun e Brendshëm (4)		
Përgjegjës Sektori	1	III-a
Specialist	1	III-b
Specialist	1	III-b
Specialist	1	III-b
Sektori i Huamarrjes në Tregjet Ndërkombëtare (3)		
Përgjegjës Sektori	1	III-a
Specialist	1	III-b
Specialist	1	III-b
Drejtoria e Strategjise dhe Monitorimit të Borxhit (8)		
Drejtor	1	II-b
Sektori i Strategjise dhe Riskut (3)		
Përgjegjës Sektori	1	III-a
Specialist	1	III-b
Specialist	1	III-b
Sektori i Regjistrimit dhe Shërbimit të Borxhit (3)		
Përgjegjës Sektori	1	III-a
Specialist	1	III-b
Specialist	1	III-b

Struktura në muajin janar 2020 rezulton si më poshtë:

Drejtor i Përgjithshëm	Vakant
Drejtoria e Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndihmës së Huaj (8)	
Drejtor	A.D
Sektori i Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj (3)	
Përgjegjës Sektori	A.H
Specialist	E.C
Specialist	G.S
Sektori i Sigurimit të Ndihmës së Huaj dhe Marrëveshjeve (4)	
Përgjegjës Sektori	E.M
Specialist	E.F
Specialist	Vakant
Specialist	T.B
Drejtoria e Huamarrjes (9)	
Drejtor	Vakant

Sektori i Huamarrjes në Tregun e Brendshëm (4)	
Përgjegjës Sektori	B.M
Specialist	Vakant
Specialist	G.K
Specialist	O.A
Sektori i Huamarrjes në Tregjet Ndërkombëtare (3)	
Përgjegjës Sektori	B.J
Specialist	E.S
Specialist	V.S
Drejtoria e Strategjise dhe Monitorimit te Borxhit (8)	
Drejtor	Vakant
Sektori i Strategjise dhe Riskut (3)	
Përgjegjës Sektori	M.B
Specialist	D.G
Specialist	E.K
Sektori i Rregjistrimit dhe Sherbimit te Borxhit (4)	
Përgjegjës Sektori	I.GJ
Specialist	S.SH
Specialist	Vakant
Specialist	E.A

**Në mënyrë të përmbledhur ndryshimet në strukturë gjatë vitit 2020 paraqiten si në vijim:
Janar 2020**

- A.D – emërohet në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndihmës së Huaj në datën 22.01.2020 dhe lirohet në datën 23.06.2020.
- S.H – lirim në dtaën 22.01.2020 nga pozicioni Drejtor i Drejtorisë së Huamarrjes.

Shkurt 2020

- K.H – emërohet në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, periudha 20.02.2020-29.12.2020.
- D.G – del në pension, pozicioni Specialiste e Sektorit të Strategjisë dhe Riskut.

Prill 2020

- L.H – emërohet në datën 10.04.2020 specialiste në Sektorin e Huamarrjes në Tregun e Brendshëm.

Gusht 2020

- S.N – punonjëse me kontratë, në pozicionin specialiste e Sektorit të Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, periudha 05.08.2020 – 10.12.2020 (largim me dorëheqje).
- E.S (ekselenca) – emërohet specialiste në Sektorin e Huamarrjes në Tregjet Ndërkombëtare në datën 10.08.2020.
- V.SH (ekselenca) - emërohet specialiste në Sektorin e Huamarrjes në Tregjet Ndërkombëtare në datën 10.08.2020.
- E.M – specialiste me kontratë në Sektorin e Regjistrimit dhe Shërbimit të Borxhit periudha 05.08.2020 -31.12.2020.

Shtator 2020

- E.F - transferim i përkohshëm në Sektorin e Sigurimit të Ndihmës së Huaj dhe Marrëveshjeve, nga data 19.11.2019 -19.05.2020. Pozicioni i mëparshëm Specialist në Sektorin e Sigurimit të Cilësisë dhe Kontrollit, në Drejtorinë për Menaxhimin e Projekteve IPA. Me levizje paralele datë 25.09.2020 emërohet specialiste në Sektorin e Sigurimit të Ndihmës së Huaj dhe Marrëveshjeve.
- O.M – lëvizje paralele në datën 21.09.2020 Specialiste në Sektorin e Strategjisë dhe Riskut pas daljes në pension të Donika Gogos në datën 03.02.2020.

Tetor 2020

- K.A – emërohet datë 26.10.2020 Specialist në Sektorin e Sigurimit të Ndhmës së Huaj dhe Marrëveshjeve. Lirohet nga pozicioni në datën 08.02.2021.
- B.J – ngritje në detyrë nga përgjegjëse sektori në Sektorin e Huamarrjes në Tregjet Ndërkombëtare, Drejtoria e Huamarrjes, në Drejtor Drejtorie të Drejtorisë së Huamarrjes në datën 09.06.2020. Në datën 26.10.2020 bën lëvizje paralele në Drejtorinë e Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit.

Vendet vakante për 12 muajt paraqiten si më poshtë:

Muaji	Pozicione vakante	Pozicioni vakant
Janar	6	1 Drejtor i përgjithshëm, 2 Drejtor, 3 specialistë
Shkurt	6	2 Drejtor, 4 specialistë
Mars	6	2 Drejtor, 4 specialistë
Prill	5	2 Drejtor, 3 specialistë
Maj	5	2 Drejtor, 3 specialistë
Qershori	5	2 Drejtor, 3 specialistë
Korrik	5	2 Drejtor, 3 specialistë
Gusht	4	2 Drejtor, 2 specialistë
Shtatori	3	2 Drejtor, 1 specialist
Tetor	3	1 Drejtor, 1 përgjegjës sektori, 1 specialist
Nëntor	3	1 Drejtor, 1 përgjegjës sektori, 1 specialist
Dhjetor	3	1 Drejtor, 1 përgjegjës sektori, 1 specialist

Në mënyrë të përmbledhur situata paraqitet si në vijim:

- ✓ Përgjatë vitit 2020 konsatohet vakancë e 2 Drejtorëve të kësaj Drejtorie të Përgjithshme. Po kështu vakancë në përgjegjës sektori dhe specialistë sipas tabelës së mësipërme.
- ✓ Konstatohen transferime të përkohshme për plotësimin e strukturës, si rezultat i vakancave në nr të konsiderueshëm në disa sektorë.

Si një drejtori me një nr të lartë vendesh vakante përgjatë vitit 2020 gjykojmë se kjo shoqërohet me risk të lartë në mbarëvajtjen e punës. Plotësimi i strukturës së kësaj Drejtorie duhet të jetë prioritet për shkak të rëndësisë dhe ngarkesës së shtuar, vecanërisht gjatë vitit pandemik 2020, me miratimin dhe emetimin e garancive sovraane.

A.2 Vlerësimi i efektivitetit të komponentëve të kontrollit të brendshëm bëhet në drejtim të hartimit të kontrolleve të brendshme, implementimit të tyre dhe në fund funksionimit.

Për sa më sipër, komponentët e kontrollit të brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj rezultojnë si më poshtë:

A.2.1. Mjedisi i kontrollit

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Kjo Drejtori ashtu si dhe gjithë Institucioni përgjatë vitit 2020 ka funksionuar sipas një Rregullore të Brendshme të papërditësuar me ndryshimet, e cila përcakton rregullat mbi organizimin dhe funksionimin e brendshëm sipas strukturave të mëparshme.

Lidhur me respektimin e etikës, Institucioni nuk ka të hartuar veçmas Kodin e Etikës, sikundër kërkohet prej Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, gërma (a). Ajo është pjesë e rregullores së brendshme, e përmbledhur në 1 nen (neni 30) me 14 pika.

Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga Titullari i njësisë publike në një Kod të brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje sipas Manualit për Menaxhimin Financiar

dhe Kontrollin, kap II MFK “Rregulla të përgjithshme”, pika 2.5 Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit, pjesa Integriteti dhe Vlerat Etike.

Kodi i Etikës është integruar në rregulloren e miratuar me Urdhërin Nr.52 datë 10.03.2021 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Ministrisë së Financave” në nenin 28 “Etika për Stafin”.

b. *Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.*

Struktura lejon monitorimin e veprimtarisë së institucionit nga Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorët, përgjegjësit e sektorëve deri tek specialistët dhe e ndihmon drejtuesin në vendimarrje. Sipas strukturës së njësisë, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj është përgjegjës për përmbushjen e misionit dhe funksioneve të kësaj strukture. Drejtuesit, drejtorët apo përgjegjësit e sektorëve janë në varësi direkte të tij. **Mungesa e Drejtorëve të 2 Drejtorive ka bërë të mos sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i plotë i punës për secilin punonjës** në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” në lidhje me “ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin”.

c. *Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.*

Marrëdhëniet e punëdhënësit rregullohen në bazë të Ligjit për Statusin e Nëpunësit Civil. Ligji për Statusin e Nëpunësit Civil, Kodi i Punës dhe dispozitat e tjera ligjore si, Ligji për buxhetin e shtetit, Ligji për prokurimin publik, kontabilitetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin, etj, lejojnë titullarin e Institucionit që në rast të shkeljes së normave ligjore, apo të rregullave të ndërmarrë hapat e duhura. Por mospërditësimi i rregullores dhe mungesa e Kodit Etik përgjatë vitit 2020 ka lënë hapsira për mospërcaktim të saktë të funksioneve dhe përgjegjësi të secilit punonjës.

d. *Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.*

Nga auditimi i dosjeve të punonjësve të kësaj Drejtorie në lidhje me nivelin e diplomës, vjetërsinë e punës dhe kualifikimet u konstatua si në vijim:

Edukimi dhe kualifikimi

Emër/Mbiemër	Universiteti/ Fakulteti/Dega	Niveli i diplomës/ Profesionit	Data e emërimit në Institucion	Data e emërimit në Drejtori
A.D	Shqipëri Universiteti i Tiranës Financë - Kontabilitet - Master Shkencor Financier-Kontabilist	Financë - Kontabilitet - Master Shkencor	07.04.1997	05.12.2018
E.C	Shqipëri Universiteti i Tiranës Shkenca Politike - Master Shkencor Shkenca Politike - Master Shkencor	Shkenca Politike - Master Shkencor	11.03.2011	05.12.2018
G.S	Shqipëri Universiteti i Tiranës Administrim Biznesi - Bachelor Administrim Biznesi Shqipëri Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë Financë - Master Profesional Master Profesional në Kontabilitet	Financë - Master Profesional, Administrim Biznesi - Bachelor	18.11.2015	05.12.2018
B.N	Shqipëri Universiteti i Tiranës Financë - Kontabilitet - Master Shkencor Finance Universiteti i Tiranës Menaxhim Biznesi - Master Shkencor Menaxhim financiar	Financë - Kontabilitet - Master Shkencor, Menaxhim Biznesi - Master Shkencor	03.03.2008	09.12.2013
E.M	Shqipëri Universiteti i Tiranës Administrim Biznesi - Master Shkencor Administrator biznesi, profili marketing	Administrim Biznesi - Master Shkencor	05.04.2010	19.11.2019
T.B	Shqipëri Universiteti i Tiranës Drejtësi - Master Shkencor Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë në Drejtësi	Drejtësi - Master Shkencor	20.01.2017	01.01.2018
B.M	Francë Universiteti Jean Monnet - Saint- Etienne Shkenca Ekonomike - Master Shkencor Shkenca	Shkenca Ekonomike - Master Shkencor	17.03.2009	14.10.2019

	Ekonomike			
G.K	Shqipëri Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër Financë Kontabël - Master Shkencor Financier- Kontabilist Shqipëri Universiteti i Tiranës Administrim Publik - Master Shkencor master në Administrim Publik	Financë Kontabël - Master Shkencor, Administrim Publik - Master Shkencor	15.08.2016	05.12.2018
O.A	Shqipëri Universiteti i Tiranës Financë - Bachelor në Financë Shqipëri Universiteti i Tiranës Financë - Master Shkencor Master Shkencor në Financë	Financë - Master Shkencor, Financë - Bachelor	11.11.2015	01.01.2018
I.GJ	Shqipëri Universiteti i Tiranës Ekonomi - Master Shkencor Ekonomist për Industrinë	Ekonomi - Master Shkencor	22.07.1991	1994
S.SH	Shqipëri Universiteti i Tiranës Financë - Kontabilitet - Master Shkencor Financiar Kontabilist -Profili Financë	Financë - Kontabilitet - Master Shkencor	11.11.2015	01.01.2015
E.A	Shqipëri Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan Administrim Biznesi - Master Shkencor Administrator biznesi, profili Menaxher Biznesi Shqipëri Universiteti "Marin Barleti" Financë Kontabilitet - Master Profesional Vërtetim deri në marrjen e diplomës, Master Profesional Financë Kontabilitet	Administrim Biznesi - Master Shkencor, Finance Kontabilitet - Master Profesional	19.11.2007	01.01.2018
M.B	Shqipëri Universiteti "Neë York" Tiranë Financë - Master Profesional Finance	Financë - Master Shkencor	06.01.2011	09.12.2013
D.G	Shqipëri Universiteti i Tiranës Financë - Master Shkencor Ekonomist per Financë Shqipëri Universiteti "Marin Barleti" Shkenca Juridike me profil e Drejtë Publike - Master Profesional E drejte biznesi (Tregtare)	Financë - Master Shkencor, Shkenca Juridike me profil e Drejtë Publike - Master Profesional	01.02.2017	01.02.2017
E.K	Shqipëri Universiteti i Tiranës Financë - Master Shkencor Finance Master i Shkencave	Financë - Master Shkencor	11.11.2015	11.11.2015
E.S (Ekselencia)	Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	Bachelor + Master Shkencor në Financë Kontabilitet	15.03.2019	15.03.2019
V.SH (Ekselencia)	Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	Bachelor + Master Shkencor në Financë Kontabilitet	25.03.2019	25.03.2019
E.F	Shkenca Ekonomike (me transferim të përkohshëm, prej datës 19.11.2019)	Master Shkencor Finance me kohë të pjesshme	19.11.2019	19.11.2019
K.H	Universiteti i Mesdheut Lindor në Republikën Turke të Qipros së Veriut, Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë, Dega Bankë dhe Financë, program 4 vjeçar Universiteti i Mesdheut Lindor në Republikën Turke të Qipros së Veriut, Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë, Dega Bankë dhe Financë Universiteti i Tiranës, Dega "Sistemet e kontrollit të brendshëm në sektorin publik dhe ndikimi i auditimit të brendshëm në efektivitetin e tyre"	Bachelor Bankë dhe Financë (Stuente Nderi) Master (Master of Arts) Shkencor Bankë dhe Financë Grada shkencore "Doktor" "Sistemet e kontrollit të brendshëm në sektorin publik dhe ndikimi i auditimit të brendshëm në efektivitetin e tyre"	29.01.2007	20.02.2020
A.D	Universiteti i Tiranës - Financë - Kontabilitet	Financë - Kontabilitet - Master Shkencor; Doktor i Shkencave ne Ekonomi Master in direzione strategica per lo sviluppo sostenibile	01.06.2007-01.02.2016 Rikthyer 08.05.2019	22.01.2020
S.N	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Dega Drejtësi Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Dega E drejtë penale	Bachelor në Drejtësi Master Shkencor në e drejtë penale	22.07.2019	05.08.2020
K.A	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Dega Administrim Biznesi Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Dega Financë	Master Shkencor (Diplomë 4 vjeçar) në Administrim Biznesi Master i nivelit të dytë në Financë	26.10.2020	26.10.2020 Eksp e parë
L.H	Universiteti "Neë York" Tiranë	Bachelor - Finance M. Profesional- Administrim Biznesi-	10.04.2021	10.04.2021 Eksp e parë
O.M	Universiteti i Tiranës	Bachelor+ Master Shkencor Financë	29.12.2015 Ish MZHEETTS	21.09.2020
E.M	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Dega Administrim Biznesi Universiteti "Kristal", Fakulteti i Ekonomisë, Dega Financë dhe Kontabilitet	Master shkencor (Diplomë 4 vjeçar) në Administrim Biznesi Master Profesional në Financë dhe Kontabilitet	05.08.2020	05.08.2020

Specialistët në përgjithësi, nisur nga kriteret e pozicionit sipas përshkrimeve të punës, nuk kërkojnë përvojë dhe eksperiencë pune. Nisur nga rëndësia e kësaj Drejtorie dhe misionit të saj, gjykojmë se do të ishte e nevojshme vendosja e një eksperiencë bazë pune për rekrutim. Punësimi i dy

studenteve të Ekselencës, në të njëjtin Sektor dhe vecanërisht në një sektor që ka qënë me vakancë të plotë, mungesa e eksperiencës së punës për 2 punonjësit e rinj të rekrutuar gjatë vitit 2020, dhe e trajnimeve të lidhura me pozicionin, rrit riskun e mirëfunksionimit të punës. Kjo situatë bëhet edhe më domethënëse për shkak të rëndësisë që kjo Drejtori e Përgjithshme ka. Eksperienca, kualifikimet e duhura dhe trajnimet e vazhdueshme janë domosdoshmëri në realizimin e misionit dhe funksioneve të saj.

Në lidhje me trajnimet e zhvilluara në kuadër të rritjes së kapaciteteve dhe shkallës së profesionalizimit në punë kjo Drejtori nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve të administrates gjatë vitit 2020 nisur dhe nga situata e Pandemisë, gjithashtu nuk ka kryer trajnime të mjaftueshme ndër vite, për një pjesë të punonjësve. (Aneksit Nr.2)

Vlerësimet e punës

Në lidhje me vlerësimet e punës në këtë Drejtori janë realizuar për vitin 2020, kryer brenda afatit.

A.2.2. Menaxhimi i Riskut

Risku dhe Menaxhimi i Riskut janë përkufizuar në Nenin 21 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i cili specifikon si vijon:

1. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

2. Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në paragrafin 1, titullari i njësisë publike miraton një strategji e cila azhurnohet çdo tre vjet, ose, sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe azhuron kontrollin që synojnë minimizimin e riskut të paktën një herë në vit.

3. Për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullsive, nëpunësit autorizues të njësisë publike regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive.

Nga auditimi u konstatua se është miratuar dhe publikuar strategjia afatmesme e monitorimit të borxhit, 2019-2021 dhe 2020-2022.

Në strategji janë përfshirë risqet kryesore që janë: *risku i rifinancimit, risku i normave të interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i likuiditetit dhe risku operacional.* Janë përcaktuar masat dhe aktivitetet që mund të ndërmerren për menaxhimin e borxhit duke analizuar dhe pritjen e treguesve bazë dhe analizën e ndjeshmërisë. Në analizën e strategjisë janë përdorur dhe metoda alternative të financimit duke marrë parasysh analizën sasiore (kosto/risk), si edhe vlerësimet dhe kufizimet e parashtruara. Në këtë strategji janë analizuar avantazhet dhe disavantazhet e strategjive kryesore bazë.

Është hartuar analiza e borxhit publik për vitin 2020 ku është trajtuar: *ecuria e borxhit publik deri në fund të vitit 2020, faktorët që kanë ndikuar, portofoli i borxhit publik sipas instrumentave dhe peshës së tyre, analizë borxhi i jashtëm-borxhi i brendshëm, kostot, risqet, zhvillimet e tregut primar të titujve shtetëror etj.*

Por mungon një vlerësim i risqeve që lidhen me mirëfunksionimin e sistemeve të kontrollit, vecanërisht me plotësimin e strukturës dhe elementëve të tjerë të cilësuar me risk në këtë raport.

A.2.3. Aktivitetet e kontrollit

Në drejtim të hartimit të kontroleve të brendshëm lidhur me komponentin e “Aktiviteteve të Kontrollit” u konstatua se janë hartuar proceset kryesore të punës operationale por kontrollet në përgjithësi janë realizuar pa dokumentim për rastet kur janë kryer duke sjell mungesë së rezultateve dhe konstatimeve të tyre. Në përgjithësi Drejtoritë për shkak të vendeve vakante të pozicionit Drejtor, kanë **funksionuar me delegime në mungesë të** detyrave të përgjegjësive ose specialistëve të Sektorëve. *Sipas Aneksit Nr.3*

Delegimi kompetencave është një instrument ligjor i parashikuar për t’u përdorur për detyra të caktuara, për një afat të caktuar kohor në funksion të performancës së institucionit dhe jo për tu përdorur në masë për delegimin e një pozicioni vakant pune me të gjitha atributet e veta dhe në një afat të pacaktuar duke u shndëruar në një mekanizëm të përhershëm. Për sa kohë ka një ligj, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 23.10.2015, që ndalon delegimin e detyrave të caktuara të një pozicioni pune nuk mundet këto pozicione të mbahen nga nëpunës të deleguar në periudha afatgjata apo një vjeçare, duke cënuar kështu përmbushjen e misionit të punës së këtij pozicioni.

Në lidhje me regjistrimin e borxhit konstatohet se:

- *Borxhi i brendshëm regjistrohet në sistemin DMFAS dhe mbahet në databazë në excel.*
- *Borxhi i jashtëm regjistrohet në sistemin DMFAS.*

Po kështu dhe të dhënat e nënshkrimeve dhe garancive mbahen në DMFAS dhe në excel.

Në Sistemin DMFAS, regjistrohen marrëveshjet, disbursimet dhe emetimet, plani i amortizimit si edhe pagesat e borxhit, pasi këto të fundit janë kryer nga llogaria e qeverisë.

Në sistemin e thesarit SIFQ, regjistrohen transaksionet e kryera dhe që prekin llogarinë e qeverisë: disbursimet e borxhit të jashtëm, emetim-maturimet e borxhit të brendshëm, pagesat e borxhit të jashtëm dhe të brendshëm.

Transaksionet në lekë janë elektronike në këtë sistem: emetimet vijnë elektronikisht nga Banka e Shqipërisë dhe pagesat e kryera kalojnë po elektronikisht në Bankën e Shqipërisë. Transaksionet në valutë regjistrohen manualisht (disbursime, pagesa).

A.2.4. Informim komunikimi

Konstatohet se faqja Zyrtare e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk e ka përditësuar strukturën, mision, dhe funksionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, pasi vijon me strukturën e vjetër kur kjo emërtohet Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik.

Drejtesit e Institucionit zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit pasi, janë njohur me Ligjin “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”. Sekretari i Përgjithshëm informohet me anë të raporteve të monitorimit çdo 3-muaj dhe analizave vjetore. Përgjatë vitit 2020 është raportuar ecuria e borxhit publik në Komisionin për Ekonominë dhe Financat me shkresat:

Shkresa nr.12241 prot datë 30.06.2020 (tremujori i parë)

Shkresa nr.20707 prot datë 03.11.2020 (tremujori i dytë)

Shkresa nr. 886 prot datë 18.01.2021 (tremujori i tretë)

Shkresa nr. 6975 prot datë 16.04.2021(raportimi vjetor)

Ankesi II i Rregullores së Brendshme trajton procedurat mbi dokumentat ose aktet administrative, hartimin dhe korrespondencën e tyre. Në këtë Rregullore përcaktohen rregullat për përgatitjen, qarkullimin dhe administrimin e dokumentacionit që hyn dhe del nga MFE dhe dokumentacionin që qarkullon brenda Institucionit, por sjellim në vëmendje se rregullorja në vetvete është e përshtatshme për strukturën e vjetër të kësaj Drejtorie dhe vet Institucionit. Nga auditimi u konstatua se, kjo Drejtori komunikon në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me Institucionin.

Emri i Raporteve Kryesore	Lloji i Raportit/vendimarrja	Skeduli i Kalendarit	Link-u i Raportit
Hartimi i Kalendarëve tremujorë të emetimeve të titujve qeveritare në tregun e brendshëm	Vendimarrja nga ministri	Tremujor	https://financa.gov.al/kalendari-i-emetimeve/
Njoftimi zyrtar i ankandëve të titujve qeveritare tregu i brendshëm sipas kalendarit të miratuar të emetimeve	Vendimarrja nga ministri i cili ka deleguar tek zv / Ministri përgjegjës për borxhin dhe Sekretari i përgjithshëm këte detyre për firmosje	Javor sipas ankandëve	https://financa.gov.al/njoftim-per-ankande-bono-thesari-obligacione/
Vendimarrja dhe firmosja në lidhje me rezultatet e ankandëve	Vendimarrja nga ministri i cili ka deleguar tek zv / Ministri përgjegjës për borxhin dhe Sekretari i përgjithshëm këte detyrë për firmosje	Javor sipas ankandëve	http://ëëë.financa.gov.al/rezultatet-e-ankandëve/
Analiza e huamarrjes së brendshme	Informacion për ministrin në lidhje me ecurinë e huamarrjes tregu i brendshëm	-	-
Raportimet periodike pranë Komisionit për Ekonomine dhe Financat	Keto Raporte përgatiten nga sektori i strategjise dhe riskut, miratohen në linjën e hierarkisë nga Ministri dhe i dërgohen Komisionit për Ekonomine dhe Financat	Tremujor	-
Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit Publik e cila miratohet me VKM	VKM	Vjetor	https://financa.gov.al/strategjia-afatmesme-e-menaxhimit-te-borxhit-publik/

Konstatohet se në përgjithësi komunikimet më të shpeshta janë në 6 mujorin e dytë të 2020 nisur edhe nga situata e pandemisë.

A.2.5. Monitorimi

Përgjatë vitit 2020 Drejtorja e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, nuk ka qënë subjekt auditimi nga auditi i brendshëm.

Kjo Drejtori nuk është as në mbikëqyrje apo monitorim nga asnjë bord apo organ mbikëqyrës.

Drejtorja e Përgjithshme e Borxhit Publik është anëtare e Komitetit të Monitorimit të ecurisë së garancive shtetërore të Huas me bankat e nivelit të dytë, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19”, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe anëtare e Sekretariatit Teknik përfaqësuar nga specialiste e Sektorit të Regjistrimit dhe Shërbimit të Borxhit.

Për sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Në përgjithësi në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj vijohet me vende vakante dhe ndërrime të herëpashershme ose vakancë të pozicionit të Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorëve të Drejtorive.

Në lidhje me menaxhimin e garancive sovraane stafi i kësaj drejtorie është përballur me një sfidë dhe ngarkesë të konsiderueshme pune, duke qënë një eksperiencë e re dhe janë gjendur përballë mungesës së eksperiencës në këtë drejtim.

Në vazhdim kërkohet një vëmendje e shtuar për përmirësimin e aspekteve të referuara më lartë në këtë drejtim.

Megjithatë theksojmë se pavarësisht disa problematikave që janë evidentuar edhe përgjatë vitit 2020, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në kuadër edhe të rekomandimeve të lëna

nga KLSH në raportin e kaluar të auditimit, janë marrë masa për realizimin e tyre përgjatë vitit 2021.

C. Auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e treguesve të borxhit publik. Analiza e qëndrueshmërisë së treguesve dhe vlerësimi i përmbushjes së objektivave të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 dhe strategjive afatshkurtra dhe afatmesme lidhur me këtë tregues fiskal. Paraqitja e treguesve të borxhit në tabelën fiskale dhe Raportin e Zbatimit të Buxhetit për vitin 2020. Testimi i përshtatshmërisë së raportimit të treguesve të borxhit publik.

Në zbatim të programit të auditimit nr. “Nr 512/1 Prot. datë 14.05.2021”, për periudhën 2020, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Strategjia e afatmesme e menaxhimit të borxhit publik 2019-2021;
- Strategjia e afatmesme e menaxhimit të borxhit publik 2020-2022;
- Raporti i Borxhit Faktik për vitin 2020;
- Regjistrat e borxhit në baza 3-mujore për vitin 2020;
- Raportet e treguesve të borxhit të publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për vitin 2020;
- Rezultatet e ankandëve të emetimit të titujve shtetërore të borxhit të brendshëm për vitin 2020;
- Raporte nga sistemi i informatizuar i menaxhimit të borxhit;
- Rakordimet vjetore ndërmjet strukturave të thesarit dhe borxhit në lidhje me pagesat dhe disbursimet e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Korespondencat shkresore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë sikurse janë përmendur përgjatë materialit;
- Strategjia afatmesme e menaxhimit të financave publike 2014-2020.
- Të dhëna në lidhje me garancitë, nënhuatë, garancitë sovraane të emetuara për vitin 2020.

2.2 Auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e treguesve të borxhit publik. Analiza e qëndrueshmërisë së treguesve dhe vlerësimi i përmbushjes së objektivave të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 dhe strategjive afatshkurtra dhe afatmesme lidhur me këtë tregues fiskal.

Treguesit e Borxhit të Brendshëm

Treguesit e Borxhit të Jashtëm

Shërbimi i borxhit

Garancitë dhe nënhuatë

Përfshirja e treguesve të borxhit në Strategjinë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 është kryer përgjithësisht në shtyllën 3 “Ekzekutimi efikas i buxhetit”, në pikën “Menaxhimi i borxhit dhe likuiditetit”. Objektivi i kësaj fushe lidhet me minimizimin e kostove për plotësimin e nevojave të financimit të Qeverisë në një nivel të caktuar risku dhe duke mbajtur në konsideratë normën e kreditimit të Shqipërisë. Masat e përfshira në këtë strategji përfshijnë:

Masa 1: Rishikimi i masave aktuale institucionale, organizimit të brendshëm dhe personelit përgjegjës për menaxhimin e likuiditetit dhe borxhit

Masat aktuale institucionale dhe aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore kanë pësuar ndryshim në vitin 2014, nëpërmjet amendimeve në ligjin për huamarrjen dhe në vitin 2016 në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

ku janë përfshirë përcaktime në lidhje me reduktimin e treguesit të borxhi vit pas viti në raport me PBB, kufizimin për marrjen e borxhit të ri dhe garancive shtetërore të huasë në ligjin e buxhetit vjetor, minimizimin e risqeve nga veprimtaritë ekstrabuxhetore, etj. Në të njëjtën kohë edhe organizimi i brendshëm i drejtorisë ka pësuar ndryshime të vazhdueshme përgjatë viteve sikurse është trajtuar në pjesë të tjera të këtij raporti, në lidhje me strukturat organizative të miratuara dhe efektet në operacionet e menaxhimit të borxhit.

Masa 2: Përgatitja e një strategjie gjithëpërfshirëse të menaxhimit të borxhit

Strategjia gjithëpërfshirëse e menaxhimit të borxhit rezulton të jetë adresuar siç duhet duke përgatitur dhe miratuar një strategji afatmesme të menaxhimit të borxhit. Për periudhën objekt auditimi është miratuar në Dhjetor 2019 Strategjia Afatmesme për Menaxhimin e Borxhit Publik 2019-2022. Në strategji janë vendosur dy objektiva të cilat janë në një linjë me Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020 që paraqiten:


1. Sigurimin e realizimit të nevojave të qeverisë për financim, si edhe nevojave për të shërbyer borxhin aktual me kosto sa më të ulët dhe duke mbajtur nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj risqeve;

2. Zhvillimin e tregut primar dhe hedhjen e hapave për zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë vendas.

Në fokus të strategjisë për këtë periudhë janë përfshirë reduktimi i riskut të rifinancimit dhe atij të normave të interesit të borxhit të brendshëm. Në këtë mënyrë, në lidhje me riskun e rifinancimit është përcaktuar që Koha Mesatare në Maturim e borxhit të brendshëm të ketë si objektivi 2.2-2.4 vite deri në fund të vitit 2021 ndërkohë që borxhi i brendshëm i maturuar në 1 vit në përqindje ndaj totalit të jetë maksimalisht 48% deri në fund të vitit 2021. Nga auditimi konstatohet se në krahasim me treguesit e një viti më parë, menaxhimi i portofolit të borxhit është kryer në linjë me objektivat strategjikë, duke sjellë përmirësim për të dy këto tregues.

Të dhënat historike dhe treguesit për vitin 2020 sipas raportimit në Raportin e Borxhit Faktik për vitin 2020 paraqiten:

Ecuria e treguesve të riskut të rifinancimit (2014–2020)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Për riskun e normave të interesit është përcaktuar që si tregues për menaxhimin të jetë Koha mesatare në maturim e borxhit të brendshëm të jetë minimalisht 2.2 vite deri në fund të vitit 2021. Nga auditimi konstatohet se koha mesatare në maturim faktike për vitin 2020 është në nivelin 2.18 vite që është pranë minimumit të parashikuar. Trendi i lëvizjes së KMM në kuadër të strategjisë nga viti 2014 deri në 2020 ka pasur tendencë rritëse duke kaluar nga 1.75 në vitin 2014 në 2.18 në vitin 2020. Nga auditimi konstatohet se borxhi i brendshëm i rivlerësuar në 1 vit si përqindje ndaj

totalit të stokut është brenda limitit maksimal 48% (të totalit të stokut të borxhit) të vendosur si objektiv në strategji për tu realizuar brenda të vitit 2021, më një trend zbritës nga 47.7% në vitin 2019 në 44.8% në vitin 2020. Risku i normave të interesit gjithashtu është reduktuar pasi pesha e instrumenteve që rifiksojnë normën e interesit në harkun kohor të një viti është ulur nga 50.9% në dhjetor 2019 në 46.7% në dhjetor 2020, duke qenë brenda limitit të vendosur në objektivin strategjikë. ***Në këtë drejtim, ndikim ka pasur reduktimi i peshës së titujve afatshkurtër dhe atyre me norma interesi të ndryshueshme në portofolin e borxhit të brendshëm, përkatësisht me 1.5 dhe 1.8 pikë përqindje. Ulja e ekspozimit ndaj këtij risku ka ulur ndjeshmërinë e borxhit ndaj goditjeve të normave të interesit, duke reduktuar burimet që qeveria duhet të angazhojë në raste të tilla.***

Tabela në vijim paraqet të dhënat historike së bashku me treguesit për vitin 2020 sipas raportimit në Raportin e Borxhit Faktik për vitin 2020:


Ecuria e treguesve të riskut të rifinancimit (2014–2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Sa i takon ekspozimi ndaj riskut të kursit të këmbimit gjatë 2020, treguesi përkatës ka pësuar një rritje në krahasim me nivelin e një viti më parë, kjo për shkak të nevojave të shtuara për financim të cilat janë mbuluar (në terma neto) kryesisht nga burime të jashtme. Megjithatë stoku i borxhit shtetëror në monedhë të huaj edhe gjatë vitit 2020 vazhdon të qëndrojë nën kufirin strategjik të përcaktuar në Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit dhe atë të qëndrueshmërisë së borxhit.

Ecuria e treguesve të riskut të rifinancimit (2014–2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Masa 3: Përgatitja e një strategjie për zhvillimin e tregut të letrave qeveritare me vlerë

Në kuadër të kësaj mase nuk ka një strategji të mirëfilltë për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë të qeverisë, por janë përfshirë si një komponent përbërës i Strategjisë Afatmesme për Menaxhimin e Borxhit Publik 2019-2022. Kjo strategji përfshin zhvillimin e tregut të titujve shtetërorë nëpërmjet aktiviteteve të cilat do të kenë si objektivi: a) rritjen e likuiditetit; b) rritjen e efikasitetit; dhe c) rritjen e transparencës.

Masa 4: Integrimi i sistemit të menaxhimit të borxhit me SIFQ dhe SIMFQ-in e ardhshëm

Aktualisht integrimi i sistemit të borxhit me Sistemin Informativ Financiar Qeveritar dhe Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar Qeveritar nuk është realizuar duke qenë se transaksionet vazhdojnë të regjistrohen paralelisht në të dy sistemet. Gjithashtu edhe SIMFQ nuk është ende në funksion të plotë.

2.3 Paraqitja e treguesve të borxhit në tabelën fiskale dhe Raportin e Zbatimit të Buxhetit për vitin 2020. Testimi i përshtatshmërisë së raportimit të treguesve të borxhit publik

Kufijtë e huamarrjes vjetore dhe huaja e marrë për financimin e deficitit

Gjatë vitit 2020, kufizimet për borxhin e ri të emetuar dhe shlyerjen e borxhit ekzistues janë përcaktuar në nenet 10, 19 dhe 20 të ligjit nr.88 datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar.

Në këtë ligj është përcaktuar financimi i deficitit prej 39,699 milion lekësh nëpërmjet rritjes së huamarrjes totale neto nga burime të brendshme dhe të huaja.

Me aktin Normativ nr.6 datë 21.03.2020 për disa ndryshime të ligjit nr.88 datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, **u vendos ndryshimi i deficitit duke kaluar nga 39,699 milion lekë në 68,699 milion lekë.** Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të shtetit prej 68,699 milionë lekë, nëpërmjet huamarrjes totale neto nga burime të brendshme dhe të huaja, është 72,845 milionë lekë. Brenda këtij kufiri të huamarrjes totale neto përfshihet edhe emetimi i mundshëm i një eurobondi me vlerë indikative prej 80,177 milion lekë. Financimi i deficitit është realizuar duke rritur huamarrjen e brendshme me 10,000 milion lekë dhe duke rritur huamarrjen afatgjatë të huajë me 18,450 milion lekë.

Me aktin Normativ nr.15 datë 15.04.2020, neni 1, për disa ndryshime të ligjit nr.88 datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, nuk janë bërë ndryshime të deficitit. Me aktin Normativ nr.28 datë 02.07.2020, neni 1, për disa ndryshime të ligjit nr.88 datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”,

u vendos ndryshimi i deficitit duke kaluar nga 68,699 milion lekë në 132,965 milion lekë. Në nenin 10 përcaktohet se Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër se sa deficiti i përcaktuar në nenin 1, të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të brendshme deri në kufirin maksimal prej 49,900 milionë lekë. Financimi i deficitit është realizuar duke rritur huamarrjen e brendshme me 10,000 milion lekë dhe duke rritur mbështetja buxhetore me 46,333.5 milion lekë.

Me aktin Normativ nr.34 datë 16.12.2020, neni 1, për disa ndryshime të ligjit nr.88 datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, nuk janë bërë ndryshime të deficitit por janë bërë rialokime në strukturën e borxhit të jashtëm brenda kufirit të deficitit.

Raportimi në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar për financimin e deficitit të vitit 2020, së bashku me planifikimet e ndryshuara për gjatë vitit paraqiten:

Në milion lekë

ZËRI BUXHETOR	Ligji 88/19	A.N 6	A.N 15	A.N 20	A.N 34	Fakti
DEFIÇITI	-39,699	-68,699	-68,699	-132,965	-132,965	-110,602
FINANCIMI DEFIÇITIT	39,699	68,699	68,699	132,965	132,965	110,602
Brendshem	25,204	35,754	35,754	50,371	50,371	49,426
Te ardhura nga privatizimi						228.13
Hua-marrje e brendshme	29,900	39,900	39,900	49,900	49,900	48,380
Te tjera	-4,696	-4,146	-4,146	471	471	818
I Huaj	14,494	32,945	32,945	82,594	82,594	61,176
Hua afatgjate (e marre)	77,545	95,995	95,995	95,361	97,361	97,695
Ndryshimi i gjendjes se arkes	0	0	0	0	0	1,386
Ripagesat	-66,550	-66,550	-66,550	-62,600	-62,600	-61,698
Mbeshetjet buxhetore	3,499.5	3,499.5	3,499.5	49,833	47,833	23,793

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në lidhje me treguesit fiskalë tre mujorë të konsoliduar të buxhetit për vitit 2020 informacioni i detajuar gjendet bashkëlidhur në aneksin nr 1.

Sipas raportimit në treguesit fiskalë të konsoliduar, konstatohet se nuk kemi tejkalime të kufirit të huamarrjes të përcaktuara sipas ligjit dhe akteve normative përkatëse.

Huamarrja e brendshme me anë të instrumentave të bonove të thesarit dhe obligacioneve sipas raportimit në treguesit fiskalë të konsoliduar paraqitet në shumën 48,380 milion lekë, me nën realizim përkundrejt planit në shumën 49,900 milion lekë. Edhe ripagesat për borxhin e huaj paraqiten me nën realizim duke shlyer principal të borxhit të jashtëm në shumën 61,698 milion lekë përkundrejt 62,600 milion lekë të planifikuara.

Në lidhje me raportimet për huanë e re të marrë dhe pagesat e principalit të kryera sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe bashkërendimit të ndihmës së huaj konstatohen diferenca në disa prej elementëve sipas tabelës së mëposhtme:

Në milion lekë

Lloji I huasë	Plani perfundimtar	Fakti DPTH	Fakti DPB	Diferenca thesar - borxh	Diferenca fakt - plan
Hua-marrje e brendshme	49,900	48,380	48,558	-178	-1,342
Ripagesat	-62,600	-61,698	-61,567	-131	1,033
Hua afatgjate (e marre) e jashtme	97,361	97,695	97,385	310	24
nga e cila Eurobond			80,148		
Mbeshetjet buxhetore	47,833	23,793	23,933	-140	-23,900
Plan/fakt pa mbeshetjet buxhetore	84,661	84,377	84,376	1	-285
Plan/fakt me mbeshetjet buxhetore	132,494	108,170	108,309	-139	-24,185

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Për sa i përket raportimit të këtyre shifrave nga auditimi konstatohet se kufijtë e rritjes së borxhit publik të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor të ndryshuar janë realizuar në masën 83% ose 24,185 milion lekë më pak se plani i përgjithshëm sipas aktit normativ nr 34.

- **Huaja e re e brendshme** që ka shërbyer për financimin e deficitit në treguesit fiskale të konsoliduar paraqitet në shumën 48,380 milion lekë ndërkohë që sipas raportimit nga drejtorja e borxhit, huaja e re e brendshme paraqitet në shumën 48,558 milion lekë. Vlera prej 48,558 milion lekë rezultoi e konfirmuar edhe në akt rakordimit ndërmjet strukturave të thesarit dhe strukturave të borxhit. Konstatohet se realizimi faktik i huamarrjes së brendshme i konfirmuar edhe me strukturat e DPTH nuk rakordon me realizimin faktik të paraqitur në treguesit fiskalë të konsoliduar në huamarrjen e brendshme për financimin e deficitit në shumën 139 milion lekë.

- Të dhënat në lidhje me **huanë afatgjatë të marrë**, disbursimet e projekteve me financim të huaj janë rakorduar në fillim të vitit 2020 ndërmjet strukturës së thesarit dhe strukturës së borxhit në monedhën origjinale të disbursuar nga kreditorët duke evidentuar diferenca për të cilat është kryer një akt rakordim i dytë. Nga auditimi konstatohet se megjithë rakordimin e dytë evidentohen diferenca në regjistrimin në monedhën kombëtare si pasojë e faktit të paraqitur në pasqyrën e treguesve fiskalë të konsoliduar që kanë ardhur kryesisht si pasojë e diferencave në kursin e këmbimit të përdorur të evidentuara në rreth 170 milion lekë. Gjithashtu konstatohet se disbursimi i eurobondit sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit është klasifikuar si mbështetje buxhetore, ndërkohë në treguesit fiskalë është paraqitur si hua afatgjatë e marrë e jashtme.

- Në lidhje me **pagesat e principalit** të regjistruara për vitin 2020 janë kryer rakordimet ndërmjet strukturës së thesarit dhe strukturës së borxhit në monedhë kombëtare nga e cila nuk kanë rezultuar diferenca përsa i përket shlyerjeve në monedhë origjinale dhe në monedhën kombëtare, duke konfirmuar principal të shlyer në vlerën 61,698 milion lekë. Nga auditimi është konstatuar se fakti i raportuar në sistemin e DPB paraqitet në shumën 61,567 milion lekë e cila në krahasim me faktin e paraqitur në treguesit fiskalë, paraqitet me diferencë në shumën 131 milion lekë. Kjo diferencë e cila paraqet një pagesë të kryer jo në shumën e detyrimit të lindur nuk është reflektuar në treguesit fiskalë për vitin 2020, por në vitin pasardhës, trajtuar më gjerësisht në pjesën e materialit mbi disbursimet e kryera.

Treguesit e borxhit publik.

Raporti i borxhit publik ndaj PBB përgjatë vitit 2020 ka rezultuar në rritje në krahasim me një vit më parë, ku ky raport ka shënuar rritje nga 66.3% në 77.9% të PBB sipas raportimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në treguesit e borxhit publik për tremujorin e katërt të vitit 2020. Treguesit kryesorë të borxhit publik dhe ecuria e tij sipas raportimit të MFE, sipas stokut të raportuar në fund të vitit 2020 paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Në milion lekë

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Borxhi publik	977,965	1,043,229	1,066,611	1,088,169	1,107,285	1,112,626	1,224,470
Borxhi i qeverisë qendrore	977,102	1,042,272	1,065,710	1,087,342	1,106,569	1,112,044	1,224,038
Borxhi i pushtetit lokal	863	957	910	827	716	582	432
PBB	1,395,305	1,434,307	1,472,480	1,550,644	1,635,715	1,679,284	1,572,269
Stoku i borxhit / PBB (%)	70.1	72.7	72.4	70.2	67.7	66.3	77.9

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Analiza e treguesve të borxhit)

Në raportin e buxhetit faktik për vitin 2020 të hartuar nga MFE është raportuar se stoku i borxhit publik ndaj PBB në nivelin e 77.9% në vitin 2020 nga 66.3% në vitin 2019. Rritja e treguesit të borxhit publik në raport me PBB ka ardhur kryesisht nga rritja më e madhe e PBB se rritja e stokut të borxhit publik. Në këtë mënyrë, rritja e stokut të borxhit vlerësohet në rreth 111,844 milionë lekë ose rreth 7% më shumë në krahasim me vitin 2019 duke përfshirë efektin e rivlerësimit të stokut të borxhit nga kursi i këmbimit, ndërkohë që ulja e PBB në raport me një vit më parë vlerësohet në rreth 107,015 milion lekë ose rreth 6% më pak.

Diferenca ndërmjet huamarrjes së paraqitur në tabelën e mësipërme me diferencën e stokut të borxhit publik në krahasim me një vit më parë konstatohet se vjen si pasojë e efektit favorizues të kursit të këmbimit në vlerësimin e stokut edhe për këtë vit. Stoku i rivlerësuar i borxhit sipas kursit të këmbimit të ndryshuar në krahasim me një vit më parë për secilin komponent të borxhit publik dhe monedhës përkatëse origjinale paraqitet:

Milion lekë

Instrumenti	Monedha	2019		2020		Efekti kursit të këmbimit
		Njësi monedhë origjinale	Milion lekë	Njësi monedhë origjinale	Milion lekë	
Bono Thesari	ALL	193,739,276,514	193,739	200,436,549,578	200,437	-
Garanci te brendshme	ALL	10,478,547,000	10,479	10,870,632,489	10,871	-
	EUR	38,399,257	4,676	19,612,504	2,426	38
Obligacione	ALL	388,396,300,000	388,396	417,984,600,000	417,985	-
	EUR	-	-	100,000,000	12,370	-
Kredi shtetërore	ACU	43,854,920	6,588	38,175,520	5,545	(190)
	AED	250,450,921	7,412	219,136,646	6,016	(434)
	EUR	2,355,929,168	286,881	2,778,575,714	343,710	4,882
	JPY	8,258,507,821	8,266	7,788,229,821	7,623	(164)
	KËD	11,026,637	3,954	16,123,641	5,346	(288)
	SAR	111,037,869	3,217	105,525,726	2,835	(221)
	SDR	731,359,216	109,872	806,871,847	117,190	(4,946)
Garanci te huaja	USD	569,449,851	61,865	557,024,345	56,170	(4,346)
	EUR	190,042,299	23,141	261,777,517	32,382	325
	JPY	1,511,379,000	1,513	1,277,457,000	1,250	(21)
Pusheteti lokal	KRË	21,737,850,000	2,044	20,288,660,000	1,884	(22)
	ALL	581,549,820	582	432,125,108	432	-
Totali milion ALL			1,112,626		1,224,470	(5,388)

Ky efekt, duke marrë në konsideratë vetëm tepricën e huasë së rivlerësuar në raport me një vit më parë për njësi të monedhës së huaj (pa efektin e disbursimeve apo pagesave të principalit) vlerësohet në rreth 5,388 milion lekë dhe ndikimin më të madh e ka nga borxhi në monedhën USD dhe SDR, kursi i këmbimit të të cilave ka ardhur në ulje në krahasim me lekun. Përsa i përket monedhave të tjera kryesisht Euro, ndikimi i tyre ka qenë jo i favorshëm duke qenë se në raport me një vit më parë kursi i këmbimit të tyre në raport me lekun ka ardhur në rritje.

Kompozimi i borxhit shtetëror i klasifikuar në të brendshëm dhe të jashtëm dhe i garantuar ose jo paraqitet në milion lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Stoku I borxhit të brendshëm	561,120	577,056	580,310	597,290	644,087
Stoku i brendshëm shtetëror	530,834	546,939	565,093	582,136	630,791
Stoku i brendshëm i garantuar	30,286	30,117	15,218	15,154	13,296
Stoku I borxhit të jashtëm	504,589	510,286	526,259	514,754	579,950
Stoku i jashtëm shtetëror	481,407	490,518	496,804	488,056	544,434
Stoku i jashtëm i garantuar	23,182	19,768	29,454	26,698	35,516
Stoku i borxhit te qeverisjes qendrore	1,065,709	1,087,342	1,106,569	1,112,044	1,224,037

Rritja në stokun e borxhit të qeverisjes qendrore i atribuohet kryesisht rritjes së stokut të borxhit të brendshëm në rreth 48,655 milion lekë në terma neto, e ndikuar nga emetimi i më shumë instrumentave të borxhit në tregun e brendshëm. Përsa i përket borxhit të brendshëm të garantuar paraqitet në ulje me -1,858 milion në lidhje me një vit më parë. Nga ana tjetër, stoku i borxhit të jashtëm shtetëror në krahasim me një vit më parë ka ardhur në rritje me rreth 56,378 milion lekë si pasojë e emetimit të eurobondit dhe kredisë së marrë nga FMN, si dhe të njëjtës tendencë edhe në stokun e borxhit të jashtëm të garantuar me rreth 8,818 milion lekë.

Borxhi i brendshëm

Borxhi i brendshëm shtetëror

Sipas regjistrimit të borxhit në fund të vitit 2019 dhe fund të vitit 2020, kryqëzuar me rezultatet e ankandëve të shpallura në raportimet e MFE konstatohet se titujt e emetuar janë të ndarë me afate maturimi:

- Bono thesari, sipas afateve të maturimit: 6 dhe 12 mujore;
- Obligacione sipas afateve të maturimit: 2, 7 dhe 10 vjeçar;
- Obligacione reference (Benchmark) me afat maturimi 3 dhe 5 vjeçar.

Nga auditimi konstatohet se janë emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 349.7 miliard lekë me çmim blerje/pastër në total, nga të cilat 223.9 miliard lekë bono thesari dhe 125.8 miliard lekë obligacione. Nga instrumentat e emetuar 337.1 miliard lekë janë në monedhë kombëtare dhe 12.6 miliard lekë janë në monedhë të huaj (Euro). Sipas raportimit në treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar, 48.6 miliard lekë të kësaj huamarrje janë përdorur për financimin e deficitit, ndërkohë që pjesa tjetër është përdorur për rifinancimin e titujve të maturuar sipas instrumentave të brendshëm.

Pjesa më e madhe e borxhit të ri është huazuar nëpërmjet titujve afatgjatë (41.9 miliard nga 48.6 miliard huamarrje neto), duke qenë në linjë me objektivat strategjike afatmesëm për reduktimin e riskut të rifinancimit dhe atij të normave të interesit.

Rreth 86.1% e huamarrjes së brendshme ka shërbyer për rifinancimin e titujve ekzistues dhe pjesa tjetër për nevojat buxhetore të planifikuara në rritje kryesisht për shkak të pandemisë COVID-19. Maturimet përgjatë vitit 2020 paraqiten në shumën 301.1 miliard lekë në total me çmim blerje, nga të cilat 217.2 miliard lekë për bonot e thesarit dhe 84 miliard lekë për obligacionet.

Procedura e planifikimit, zhvillimit dhe raportimit të ankandëve të bonove të thesarit dhe obligacioneve është zhvilluar në Bankën e Shqipërisë, si autoriteti përkatës i mandatuar për emetimin këtyre instrumentave për llogari të shtetit shqiptar. Emetimet dhe maturimet përgjatë vitit 2020 të instrumentave të borxhit të brendshëm paraqiten si më poshtë:

Në mld lekë

Instrumenta te tregut të brendshëm	Viti 2020		Huamarrja neto (në mld lekë)	Huamarrja neto (në %)
	Emetim (në mld lekë)	Maturim (në mld lekë)		
Tituj afatshkurtër	223,9	217,2	6,7	13,8%
Bono thesari në lekë	223,9	217,2	6,7	13,8%
Bono thesari 12-mujor				
Tituj afatgjatë	125,8	84	41,9	86,2%
Obligacione 2-vjeçar lekë	44,2	45,9	-1,8	-3,6%
Obligacione 2-vjeçar euro	12,6	0,0	12,6	26%
Obligacione 3-vjeçar	20,2	3,0	17,2	35,3%
Obligacione 5-vjeçar	18,5	13,5	5	10,4%
Obligacione 7-vjeçar	16,9	21,5	-4,7	-9,6%
Obligacione 10-vjeçar	13,5	0,0	13,5	27,7%
TOTALI	349,7	301,1	48,6	100%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Stoku i borxhit të brendshëm dominohet kryesisht nga instrumentat afatgjatë të obligacioneve me një vlerë stoku në fund të vitit 2020 në shumën 388,396 milion lekë, përkundërt 193,739 milion lekë të stokut të instrumentave afatshkurtër. Të krahasuara në raport me të njejtën periudhë të vitit më parë, stoku i instrumentave të tregut të brendshëm paraqitet si më poshtë:

Në milion lekë

Instrumenti	2019	2020	Ndryshimi
Bono thesari	193,739	200,437	6,698
6 mujore	354	1,901	1547

12 mujore	193,385	197,038	3,653
Obligacione	388,396	430,355	41,959
2 vjecare	86,791	97,455	10,664
3 vjecare	26,201	43,358	17,157
2 vjecare euro			0
5 vjecare	107,569	112,837	5,268
7 vjecare	88,306	83,675	-4,631
10 vjecare	79,529	93,029	13,500
Total instrumentave	582,135	630,791	48,656

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Stoku i borxhit për vitin 2020 është rritur me 48,656 milion lekë ose rreth 8%, duke kaluar nga 582,135 milion lekë në vitin 2019 në 630,791 milion lekë në vitin 2020.

Në lidhje me instrumentat afatshkurtër konstatohet se është rritur pesha specifike e bonove të thesarit 6 mujore dhe 12 mujore dhe financimi i nevojave buxhetore me anë të instrumentave afatshkurtër, me një efekt neto në instrumenta afatshkurtër në 6,698 milion lekë ose rreth 3% e totalit të stokut të bonove të thesarit, duke kaluar nga 193,739 milion lekë në vitin 2019 në 200,437 milion lekë në vitin 2020.

Konstatohet një rritje e konsiderueshme e stokut të borxhit afatgjatë prej 41,959 milion lekë ose rreth 9% të totalit të stokut afatgjatë, nga 388,396 milion lekë në fund të vitit 2019 në 430,355 milion lekë në fund të vitit 2020.

Tendenca përgjatë vitit 2020 (ashtu sikurse dhe gjatë vitit 2019) është në drejtim të rikompozimit të portofolit me instrumenta më afatgjatë duke qenë në përputhje me objektivat strategjike afatmesëm për rritjen e maturitetit të portofolit të borxhit. Emetimi i obligacioneve 3, 5 dhe 10 vjecare ka kontribuar më së shumti në këtë drejtim.

Emetimi i bonove të thesarit për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit të BSH

Në bazë të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e shqipërisë” të ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 6 të marrëveshjes “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë”, në rastet kur pasqyra financiare e Bankës së Shqipërisë rezulton me humbje mbulimi i humbjes nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit kryhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Banka e Shqipërisë me shkresë nr. 742/1 datë 27.04.2020 ka vendosur në dijeni MFE se në përfundim të procesit të auditimit të pasqyrave financiare të BSH llogaria “Rezerva e Rivlerësimit të Valutave” në mbyllje të vitit financiar 2019 ka rezultuar me gjendje negative 6,242,963,462 lekë, për të cilën në zbatim të nenit 64 (b) të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e shqipërisë” të ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 6 të marrëveshjes “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë” ka kërkuar mbulimin e saj me emetim të bonove të thesarit 6-mujore. Nga ana e MFE me shkresë nr. 7241/1 datë 18.06.2020 drejtuar Bankës së Shqipërisë është njoftuar emetimi i letres me vlerë në shumën 6,242.963 mijë lekë me afat maturimi 6 muaj dhe normë interesi të barabartë me yield mesatar të ponderuar të ankandit të fundit të bonove të thesarit me afat maturimi 6-mujor. Në vijim, në afatin e maturimit, nga ana e BSH me shkresë nr. 2020/2 datë 18.12.2020 drejtuar MFE, protokolluar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me prot 23754 prot, datë 21.12.2020 është kërkuar riemetimi i titullit 6-mujor që maturohet në datë 21.12.2020, nëpërmjet rinovimit me çmim blerje të instrumentit me vlerë 6,242,963 mijë lekë. Kjo shkresë është përcjellë në Drejtorinë e Huammarrjes në datën 28.12.2020.

Nga auditimi konstatohet se në vijim të shkresës nr 2020/2 prot, datë 18.12.2020, referuar marrëveshjes së datës 20.01.2015 nr 716/6 prot, “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së

Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë”, Neni 6 *Mbulimi i humbjeve neto nga rivlerësimi*”, Ministria e Financave ka rinovuar emetimin me vlerë në shumën 6,242,963 mijë lekë e njëjtë me nivelin e yield-it mesatar të ankandit më të fundit të Bonove të Thesarit me afat maturimi 6 mujor, në momentin e emetimit të letrës me vlerë në datën 11.01.2021, përtej datës së maturimit (21.12.2020). Si konkluzion kjo letër me vlerë nuk është paraqitur në regjistrin e borxhit për vitin 2020, treguesit e borxhit dhe rrjedhimisht stokun e borxhit publik të fundvitit 2020.

Emetimi i këtij instrumenti nuk është realizuar sipas kërkesës së BSH. Nga auditimi konstatohet se nuk është përmbushur detyrimi për rifinancimin e këtij instrumenti brenda afatit të përcaktuar. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 64 (b) të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e shqipërisë” të ndryshuar në të cilin citohet që “Për sa kohë shuma e regjistruar në llogarinë e vlerësimit të rezervës i korrespondon humbjeve neto në valutë, kjo shumë duhet të mbulohet me letrat me vlerë të borxhit, të cilat mbartin interes sipas interesit të tregut, të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë për Bankën e Shqipërisë dhe të mbajtura nga Banka e Shqipërisë në llogarinë e vlerësimit të rezervës së letrave me vlerë jashtë bilancit.. Gjithashtu, mos financimi në kohë i këtij instrumenti nuk është në përputhje me nenin 6 “Mbulimi i humbjeve neto nga rivlerësimi” të marrëveshjes me Bankën e Shqipërisë “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë” në të cilën citohen që “Për sa kohë që shuma e regjistruar në llogarinë e vlerësimit të rezervave valutore pranë Bankës, i korrespondon humbjeve neto në valutë, Ministria emeton për Bankën bono thesari 6 – mujore sipas pikës 4 të nenit 5”. **Efekti i mungesës së emetimit të instrumentit të borxhit të mësipërm në shumën 6.2 miliard lekë përfaqëson një nënvlerësim të stokut të borxhit real të raportuar në fund të vitit 2020 në të njëjtën shumën.** Rrjedhimisht, stoku i borxhit në 31.12.2020 vlerësohet në shumën 1,230.4 miliard lekë nga 1,224.2 miliard lekë i raportuar nga MFE në treguesit e borxhit publik.

Banka e Shqipërisë me shkresë nr. 136/1 datë 06.04.2021 ka vendosur në dijeni MFE se në përfundim të procesit të auditimit të pasqyrave financiare të BSH llogaria “Rezerva e Rivlerësimit të Valutave” në mbyllje të vitit financiar 2019 ka rezultuar me gjendje negative 6,242,963,462 lekë, për të cilën në zbatim të nenit 64 (b) të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e shqipërisë” të ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 6 të marrëveshjes “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë” ka kërkuar mbulimin e saj me emetim të bonove të thesarit 6-mujore. Nga ana e MFE me shkresë nr. 7241/1 datë 18.06.2020 drejtuar Bankës së Shqipërisë është njoftuar emetimi i letrës me vlerë në shumën 6,242,963,462 lekë me afat maturimi 6 muaj dhe normë interesi të barabartë me yield mesatar të ponderuar të ankandit të fundit të bonove të thesarit me afat maturimi 6-mujor.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi D.H....., S.P..... dhe M.F.E.....

Borxhi i brendshëm i garantuar

Në fund të vitit 2020 borxhi i brendshëm i garantuar është reduktuar me 1,857 milion lekë duke kaluar nga 15,154 milion lekë në fund të vitit 2019 në 13,297 milion lekë në fund të vitit 2020 të detajuar në tabelën e mëposhtme.

Në mln lekë

Huamarrësi	Huadhënësi	2019		2020	
		milion/Euro	milion/Lekë	milion/Euro	milion/Lekë
KESH	R.....		4,980		
KESH	R.....		1,390		
KESH	L.....		270.0		270

KESH	L.....		1,000		1,000
KESH	S.....	6.00	730.6		
KESH	R.....		2,838		500
KESH	R.....	32.40	3,945	19.61	2,426
GS1	R..... ¹				4,523
GS2	S.B..... ²				4,578
Totali milion Lekë			15,154		13,297

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ulja e stokut të garancive të brendshme konstatohet se vjen nga mbyllja dhe ulja e limitit të overdraftit për huamarrësin K.E.SH, duke reduktuar ekspozimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ndaj garancinë për këtë institucion nga 15,154 milion lekë në vitin 2019 në 4,196 milion lekë në vitin 2020 të detajuar si në vijim:

Me shkresën nr 7124 prot, datë 23.04.2020 drejtuar Ministrisë së Financave, R..... njofton dakortësinë për mbylljen e linjës së kredisë së dhënë kredimarrësit KESH sha, duke proceduar me mbylljen e linjës së kredisë prej 1,390 milion lekë.

Me shkresën nr 7125 prot, datë 23.04.2020 drejtuar Ministrisë së Financave, R.B njofton dakortësinë për mbylljen e linjës së kredisë së dhënë kredimarrësit KESH sha, duke proceduar me mbylljen e linjës së kredisë prej 2,839 milion lekë.

Me shkresën nr 20127 prot, datë 26.10.2020 drejtuar Ministrisë së Financave, R..... njofton dakortësinë për reduktimin e limitit të overdraftit së dhënë kredimarrësit KESH sha në përgjigje të shkresës nr 2928/7 prot datë 07.10.2020, duke:

- Ulur me 2,584 milion lekë limitin në vlerën totale 3,084 milion lekë, si rrjedhojë limiti i mbetur i këtij overdrafti është në vlerën 500 milion lekë.
- Ulur me 12.8 milion euro limitin në vlerën totale 33.4 milion euro, si rrjedhojë limiti i mbetur i këtij overdrafti është në vlerën 19.6 milion euro.

Me shkresën nr 2986 prot, datë 22.10.2020 drejtuar Ministrisë së Financave, O..... njofton për mbylljen e linjës së kredisë së dhënë kredimarrësit KESH sha, duke proceduar me mbylljen e linjës së kredisë prej 6 milion euro.

Në stokun e garancive përfshihen dhe dy garancitë që janë emetuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë gjatë muajve prill – maj 2020, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 në vlerën 9,101 milion lekë të detajuara në analizën e garancive sovrane.

Në lidhje me konstatimet e paraqitura më sipër, nga ana e MFE janë paraqitur observacione me shkresën nr.8596/7 datë 27.09.2021 në të cilën është parashtruar që:

- Në lidhje me këtë çështje, referuar faqes 24 të projektraportit, konkretisht konstatimit në lidhje me Emetimit të bonove të thesarit për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit të BSH-së sqarojmë se referuar marrëveshjes dypalëshe ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave datë 20.01.2015 Nr.716/6 Prot. “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve neto të Bankës së Shqipërisë”, Neni 6 “Mbulimi i humbjeve neto nga rivlerësimi i valutave” “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë”, në mbyllje të vitit financiar 2019 llogaria “Rezerva e Rivlerësimit të Valutave” ka rezultuar me gjendje negative 6,242,963,462.95 lekë. Në zbatim të nenit 64, pika b e ligjit Nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 6, pika 3 e marrëveshjes “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave

¹ GS1: Garancia shtetërore për pagat, miratuar me VKM nr. 277, datë 06.04.2020, amenduar me VKM Nr. 370, datë 06.05.2020

² GS2: Garancia shtetërore për financimin e rimëkëmbjes së aktivitetit tregtar, miratuar me VKM nr. 387, datë 13.05.2020

dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë emetoi letër me vlerë më dt. 22.06.2020 maturimi 21.12.2020 për mbulimin e vlerës negative të lartpërmendur me afat maturimi 6- muaj ku norma e interesit është e barabartë me nivelin e yield-it mesatar të ponderuar të ankandit më të fundit të Bonove të Thesarit me afat maturimi 6-mujor, në momentin e emetimit të letrës me vlerë. Sipas nenit 6, pika 4, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka rinovuar emetimin ku afati sipas marrëveshjes është 10 dite pune. Shkresa e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim është marrë në dorëzim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë më 21 dhjetor 2020 ku afati 10 ditor i bie më datë 06 janar 2021 ku kemi vijuar me rinovimin e vlerës 6,242,963,462.95 lekë. Theksojmë se rinovimi është bërë në afatin kohor brenda 10 ditë pune nga momenti i marrjes në dorëzim nga drejtorja e huamarrjes më datë 28.12.2021.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Duke qënë se nga ana e MFE me shkresë nr. 7241/1 datë 18.06.2020 drejtuar Bankës së Shqipërisë është njoftuar emetimi i letres me vlerë në shumën 6,242.963 mijë lekë me afat maturimi 6 muaj dhe normë interesi të barabartë me yield mesatar të ponderuar të ankandit të fundit të bonove të thesarit me afat maturimi 6-mujor, MFE kishte njohuri për afatin e maturimit brenda vitit 2020 të letrës me vlerë të emetuar nga vetë ajo, si dhe kërkesave të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e shqipërisë” të ndryshuar. Emetimi duhet të ishte realizuar brenda vitit 2020, me qëllim pasqyrimin e stokut të borxhit real të raportuar në fund të vitit 2020. *Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.*

Borxhi i jashtëm

Mbi Raportin e Disbursimeve.

Përgjatë vitit 2020 janë regjistruar në sistemin e brendshëm të menaxhimit të borxhit transaksionet e disbursimit për 42 kredi me një total në monedhë kombëtare në shumën 133,200 milion lekë nga të cilat katër kredi janë evidentuar si garanci që kanë pasur disbursime gjatë vitit në shumën 11,881 milion lekë. Pjesa tjetër prej 38 projektsh përfshin një shumë të disbursuar prej 121,318 milion lekë. Nga këto 38 projekte 5 prej tyre projektet që janë klasifikuar si mbështetje buxhetore në shumën 104,080 milion lekë që kanë pasur këtë trajtim duke qënë se janë transferuar drejtpërsëdrejti në llogarinë e unifikuar të thesarit në monedhën të huaj dhe jo në llogarinë speciale në Bankën e Shqipërisë për projektin përkatës. Konkretisht projektet për të cilat është klasifikuar shuma e disbursuar si mbështetje buxhetore në monedhë origjinale dhe monedhë kombëtare paraqiten:

Në mijë lekë

ID kredia	Shuma në Euro	Shuma në Leke
15/10/IBRD	5,027	618,616
18/04/IBRD	2,414	276,021
20/01/IBRD	9,100	1,129,220
20/03/IMF	139,300	21,909,104
EUR7Y/20/01	645,053	80,147,897
Totali	800,894	104,080,860

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Vlera specifike e disbursuar për kredi shtetërore jo mbështetje buxhetore vlerësohet në shumën 17,237 milion lekë. Regjistrimi i transaksioneve të disbursimit vlerësohet të jetë kryer në mënyrë të rregullt duke pasur parasysh vlerën e raportuar në ditë të caktuara në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë. Nga ana tjetër, kreditë shtetërore të disbursuara

dhe mbështetja buxhetore rezultojnë të jenë rakorduar në monedhë origjinale pa evidentuar asnjë diferencë me strukturat përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.

Kanë rezultuar diferenca në vlerën për disbursimet e huaja në monedhën kombëtare dhe evidentohet se vjen nga kursi i përdorur për regjistrimin e transaksioneve. Diferenca ndërmjet të dhënave nga Drejtoria e Borxhit për disbursimet e huaja dhe atyre të publikuara në tabelën fiskale vijnë nga kursi i këmbimit i përdorur për konvertimin në lekë të disbursimeve, ku Drejtoria e Borxhit përdor kursin e ditës së disbursimit ndërsa Drejtoria e Thesarit përdor një kurs mesatar. Sipas llogaritjeve të kryera nga grupi i audituesve të KLSH rezultoi se diferenca për disbursimet e huaja midis të dhënave të borxhit dhe atyre të publikuar në tabelën e treguesve fiskalë është 169,677 mijë lek. Më konkretisht në të dhënat sipas treguesve fiskalë kjo vlerë është 121,488,000 mijë lek kurse sipas të dhënave të cilat janë vendosur në dispozicion nga drejtoria e borxhit kjo vlerë është 121,318,322 mijë lek, ku arsytet e kësaj difference janë për shkak të kurseve të këmbimit të përdorur.

Projektet specifike të cilat janë financuara më shumë përgjatë vitit 2020, duke përfshirë edhe mbështetjen buxhetore sipas disbursimeve të kredive respektive rezultojnë si në vijim:

Në mijë Lekë

Loan ID	Përshkrimi	Disbursime ALL	Njësia Zbatuese
EUR7Y/20/01	Mbështetje për buxhetin	80,147,897	M.F.E
20/03/IMF	Instrument i financimit të shpejtë	21,909,104	M.F.E
16/02/EBRD	Plani i ristrukturimit të KESH	11,164,012	KESH
11/10/EBRD	Bypass Fier-Vlorë	1,978,345	ARRSH
16/01/KUËAIT	Rehabilitimi i Lumit të Vlorës	1,932,901	F.SH.ZH
12/07/EIB	Bypass Fier	1,848,900	ARRSH
18/01/IBRD	Financim shtesë "Shpërndarja dhe Burimet Ujore"	1,621,549	M.B
15/03/KfE	Furnizimi me ujë i zonave rurale III	1,309,075	F.SH.ZH
13/03/IDB	Rruga Qukës - Qafë Pllaçë	1,244,233	ARRSH
17/03/KfE	Infrastruktura ujore bashkiake III/IV	1,129,789	AKUK

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

”Përgjatë 2020 janë nënshkruar 8 marrëveshje huaje në kuadër të huamarrjes së jashtme, për financim të projekteve apo mbështetje buxhetore, shuma dhe kreditorë sipas tabelës në vijim:

Në mijë

Kreditori	Projekti	Shuma	Monedha	Njësia Zbatuese
I.....	Barazia gjinore ndaj mundësive ekonomike	9,100	EUR	M.F.E
E.....	Rrugët Sekondare Lokale	50,000	USD	F.SH.ZH
I.....	Instrument i financimit të shpejtë	139,300	SDR	M.F.E
E.....	Mbështetje për buxhetin	650,000	EUR	M.F.E
I.....	Mbështetje për situatën e emergjencës covid-19	15,000	EUR	M.F.E
K.....	Mbështetje për buxhetin	180,000	EUR	M.F.E
K.....	Furnizimi me ujë i zonave rurale V	80,000	EUR	F.SH.ZH
E.....	Zhvillimi i Turizmit & Infrastruktures ne Shqiperi	60,000	EUR	F.SH.ZH

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Nga auditimi konstatohet se marrëveshjet më të rëndësishme (për nga shuma e financimit) dhe të cilat janë miratuar në Kuvend dhe kanë termat e financimit si në vijim:

- *“Instrument i financimit të shpejtë” (RFI)*: paraqet si Huadhënës Fondi Monetar Ndërkombëtar huamarrës Republikën e Shqipërisë dhe njësi zbatuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë, miratuar me ligjin nr.70/2020 datë 28.05.2020.

Instrumenti i Financimit të Shpejtë (RFI) është një mekanizëm lehtësues që ofron FMN për të ndihmuar vendet që përballen me nevoja urgjente për financimin e bilancit të pagesave për shkak të një emergjence, krize, fatkeqësie natyrore ose të një pandemie. Tashmë, më

shumë se 80 vende i janë drejtuar FMN-së për financim. Më 10 prill, Bordi i FMN-së miratoi Instrumentin e Financimit të Shpejtë (RFI-të) për tre vende të Ballkanit Perëndimor: Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën.

Termet e Huasë paraqiten si vijon:

Shuma e Huasë 139,300,000 SDR

Norma e Interesit përbëhet nga (i) një normë bazë (e përcaktueshme nga tregu [0.05% javën që përfundon në 10 prill]) plus një marzh të caktuar nga Bordi Drejtues çdo dy vjet (aktualisht 100 bps); (ii) tarifën shtesë të bazuar në nivel prej 200 bps mbi stokun e kredisë mbi 187.5% të kuotës; dhe (iii) tarifën shtesë të bazuar në kohë prej 100 bps kur shuma e stokut të kredisë qëndron mbi 187.5% të kuotës për më shumë se 36 muaj.

Instrumenti që i akordohet Shqipërisë ka një normë huadhënie që do të përfshijë normën bazë të interesit në SDR (0.05%), një marzh të vendosur nga Bordi Drejtues (1%), tarifën shtesë të bazuar në nivel prej 2%, dhe një tarifë shtesë të bazuar në kohë prej 1%, duke e çuar normën totale të instrumentit në 4.05%.

Komisioni i Shërbimit aplikohet mbi çdo shumë që tërhiqet nga huaja dhe është 0.5% (50 bps).

Maturimi i Huasë 3¼ deri në 5 vjet.

Hera e parë që Shqipëria i është drejtuar FMN-së për hua është për programin me FMN (EFF/Extended Fund Facility) në vlerën 295,420,000 SDR. Nga kjo kredi është për t'u shlyer deri në vitin 2027 vlera prej 249.599.169 SDR. Për kredinë në fjalë aplikohen interesat si me poshtë: Norma e interesit është e lidhur me normën bazë SDR (e cila ka një nivel minimal prej 0.05%) të cilës i shtohet një marzh prej 1%. Në kushtet ku kredia e pashlyer e kalon nivelin prej 187.5% të kuotës së anëtarësimit pranë FMN, normës së interesit i shtohet një normë (surcharge) prej 2 pikë përqindje, dhe nëse ky stok vijon të tejkalojë këtë nivel të kuotave prej më tepër se tre vite, shtesa mbi normën e interesit bëhet 3pp. Vetëm me këtë kredi aktualisht nuk tejkalohet kufiri i përcaktuar i kuotave (*Kuotat që ka Republika e Shqipërisë pranë FMN aktualisht janë në vlerën prej 139,300,000 SDR), në këtë mënyrë interesi i kredisë aktualisht është në normën prej 1.05%.

Më 10 prill, Bordi i FMN-së miratoi Instrumentin e Financimit të Shpejtë (RFI-të), duke i siguruar Shqipërisë shumën e huasë se siguruar nëpërmjet instrumentit të Shpejtë (RFI) në vlerën 139,300,000 SDR. Për kredinë në fjalë aplikohen interesat si me poshtë: Norma e interesit edhe për këtë kredi është e lidhur me normën bazë SDR (e cila aktualisht është në nivelin minimal prej 0.05%) të cilës i shtohet një marzh prej 1%. Në kushtet ku kredia e pashlyer e kalon nivelin prej 187.5% të kuotës së anëtarësimit pranë FMN* (dhe këtu konsiderohet shuma e gjithë kredive që ka vendi kundrejt FMN), normës së interesit i shtohet një normë (surcharge) prej 2 pikë përqindje, dhe nëse ky stok vijon të tejkalojë këtë nivel të kuotave prej më tepër se tre vite, shtesa mbi normën e interesit bëhet 3pp. Me këtë kredi tejkalohet kufiri i përcaktuar i kuotave (Aktualisht jemi në nivelin prej 279% të kuotave) ndaj interesi i kredisë për pjesën e kredisë që qëndron nën nivelin e përcaktuar ndaj kuotave i nënshtrohet normës prej 1.05% (me këtë normë interesi përlllogarit vetëm një pjesë e vogël e kredisë prej 11.6 mln SDR), ndërsa pjesa e kredisë që tejkalon kufirin, ka aktualisht një normë prej 3.05% (norma e interesit +surcharge / me këtë normë interesi përlllogarit pjesa e mbetur e kredisë prej 127.7 mln SDR). Pjesa e kredisë që kalon kufirin për më shumë se tre vjet, do të ketë normën e përberë prej SDR base rate (aktualisht 0.05%) + marzhi prej 1% + surcharge prej 3% (total 4.05%). Për sa më sipër, çdo shume kredie që tejkalon kufirin prej 187.5%, përveç normës bazë të interesit i nënshtrohet edhe tarifës (surcharge) prej +2% për një jetëgjatësi të kredisë së pa shlyer që tejkalon kufirin deri në 3 vjet,

dhe +3% për afate mbi 3 vjet.

- “Emetimi i Eurobondit”

Eurobondi është një instrument me afat maturimi më shumë se një vit, i cili emetohet në monedhë të huaj në tregun ndërkombëtar. Transaksioni për emetimin e eurobondit ka natyrë të ngjashme me letrat me vlerë, të emetuara në tregun e brendshëm. Vendimi për të dalë me Eurobond është miratuar në Parlament me ligjin nr.72/2020., datë 04.06.2020 dhe më datë 09.06.2020 është bërë dalja në tregjet ndërkombëtare me një obligacion ndërkombëtar të ri 7-vjeçar në vlerën prej 650 milion € me një kupon prej 3.50%. Emetimi i obligacionit është bërë më skonto pra me 99.239% të vlerës nominale duke e fiksuar vlerën e yieldit efektiv në 3.625%. Eurobondi është përdorur për: *Shlyerjen e një pjesë të eurobondit të marrë në vitin 2015 dhe të maturuar prej 250 milion euro dhe plotësimin e nevojave për financim për vitin 2020.* Puna për emetimin e eurobondit filloi në fund të vitit 2019 dhe bankat ndërkombëtare parashikuan që ai të emetohej në muajt Maj-Qershor 2020. Gjithashtu, ato parashikuan që eurobondi i tanishëm të kishte normë interesi, vlerë dhe shpërndarje të investitorëve më të favorshme se eurobondet e mëparshme. Ministria e Financave ka kryer procedurat e nevojshme për emetimin e eurobondit, si konsultimet me bankat ndërkombëtare, përzgjedhjen e këshilltarit ligjor dhe të bankave bashkëdrejtuese si dhe përgatitjen e dokumentacionit. Bankat bashkëdrejtuese kryesorë janë B.I, C.G.M, J.P.M.S dhe R.B.I AG të cilat kanë drejtuar procesin e emetimit të eurobondit. Ata kanë ndjekur në kohë reale kushtet e tregut financiar ndërkombëtar dhe kanë bërë sugjerimet përkatëse palës shqiptare për investitorët e mundshëm të eurobondit. Këto subjekte kanë pasur një rol mjaft të rëndësishëm për sigurimin e investitorëve në kushtet kur transaksioni i eurobondit është kompleks dhe i ndërlikuar dhe tregu financiar ndërkombëtar mund të pësojë ndryshime nga pikëpamja kosto/risk për realizimin e transaksionit. Si Agjent Fiskal ka vepruar “C.....”, i cili kryen funksionin e pagesës së principalit dhe interesave, si dhe të transferimit të eurobondit ndërsa si Agjent Regjistruar ka vepruar “C.....”, i cili kryen funksionin e regjistrimit të eurobondit. Kjo është hera e katërt që merret borxh në tregjet ndërkombëtare të kapitalit me instrumentin e eurobondit.

Në milion euro

<i>Eurobond</i>	<i>2010</i>	<i>2015</i>	<i>2018</i>	<i>2020</i>
Vlera Nominale (Në milion Euro)	300	450	500	650
Norma e Interesit (%)	7.50%	4.75%	3.50%	3.50%
Afati i Maturimit (Vite)	5	5	7	7

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Eurobondi i parë është emetuar në vitin 2010 (me vlerë 300 milionë euro, maturim 5-vjeçar dhe interes 7.5%) dhe është shlyer në vitin 2015. Eurobondi i emetuar në vitin 2015 (me maturim 5-vjeçar), në vlerë prej 450 milionë eurosh dhe me një normë interesi 4.75%. Pjesa prej 200 milion euro u shlye nëpërmjet transaksionit të blerjes së instrumenteve ekzistuese që kishte Republika e Shqipërisë në treg gjatë daljes me eurobondin e vitit 2018. Kurse pjesa e mbetur prej 250 milion euro është shlyer nga fondet e disbursuara nga emetimi i eurobondit të vitit 2020. Eurobondi i emetuar në vitin 2018 i cili është ende aktiv dhe i pashlyer plotësisht në vlerën prej 500 milionë euro, me maturim 7-vjeçar dhe normë interesi 3.5%.

Mbi Pagesat e Principalit.

Në sistemin e brendshëm të regjistrimit të transaksioneve të borxhit janë evidentuar shlyerje principali në shumën 62,577,690,657.43 lekë, duke përfshirë edhe pagesat e kryera nga përfituesit e garancive apo nën huamarrësit. Të dhënat e detajuara në lidhje me pagesat e principalit të kryera

për kreditë shtetërore dhe garancitë, të kryera nga Buxheti i Shtetit dhe përfituesit përkatës paraqiten:

Në mijë lekë

Principali i Shlyer	Principali i shlyer/LEK	Njësia Përfituese	Totali
	Buxheti i Shtetit		
Kredi Shtetërore	59,182,891	-	59,182,891
Garanci Shtetërore	2,384,513	1,010,285	3,394,798
Totali	61,567,405	1,010,285	62,577,690

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në raportin e treguesve fiskalë të konsoliduar janë pasqyruar si pagesa principali shuma prej 61,698,303,488 lekë kurse sipas raportimit të Drejtorisë së Borxhit vlera është në shumën prej 61,567,405,551 lekë, pra rezulton një diferencë prej 130,897,936.68 lekë. Kjo diferencë është justifikuar nga subjekti i audituar, ku sqarohet se:

Në mijë lekë

	Borxh	Thesar
Paguar nga Buxheti i Shtetit nga te cilat:	61,567,405	61,698,303
Paguar per kredine 78 nga UK Korce direkt kreditorit	-13,699	
Paguar Kredia 06/04/IDA	-14,825	
*IDB Dt 30.12.2020	143,991	
*IDB Dt 31.12.2020	15,432	
Ndryshimi ne total	130,897	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Diferenca prej 130,897,939 lekë përfaqëson pagesë të kryer nga vetë kreditori i cili ka likuiduar një pjesë të kështit me një detyrim të lindur nga një vendim gjyqi për kredinë shtetërore me numër identifikimi “78” dhe kredinë me numër identifikimi 06/04/IDA të cilat nuk kalojnë nëpërmjet sistemit të thesarit. Pjesa e mbetur e vlerës është një gabim njerëzorë i bërë nga Banka e Shqipërisë në lidhje me pagesat e që MFE duhet të kryejë në favor të IDB në datat 30 dhe 31 Dhjetor 2020. Nga Banka e Shqipërisë është bërë gabim përdorimi i kursit të këmbimit midis euro dhe dinarit islamik. Nga ana e drejtorisë së borxhit është dërguar MEMO e datës 13.01.2021 ku vihet në dijeni dhe informohet Zv. Ministri për situatën e gabimit në pagesa si dhe për njoftimin që i është bërë Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu propozohet që MFE në rolin e huamarrësit të ketë komunikim me anë të postës elektronike me IDB në mënyrë që të procedohet me kthimin e shumës. Në memon që mban datën 13.01.2021 është bërë identifikimi i gabimit dhe janë vendosur në dijeni të situatës eprorët përkatës, kurse në datë 20.01.2021 është bërë firmosja e akt-rakordimit me strukturën e thesarit. Gjithashtu në datën 27.01.2021 është bërë kthimi i shumës përkatëse gjë e cila është verifikuar nga fatura që na është vendosur në dispozicion drejtoria e borxhit si dokument justifikues.

Nga testet e zhvilluara në lidhje me pasqyrimin e transaksioneve të shlyerjes të principalit në llogarinë e unifikuar të thesarit të marrë nga strukturat e thesarit nuk rezultuan diferencë të tjera. Përgjatë vitit 2020 kreditë shtetërore dhe garancitë të cilat kanë patur nevojë për mbulim buxhetor sipas detyrimeve të borxhit paraqiten:

Në mijë lekë

ID LOAN	Vlera/ALL	Subjekti Përfitues i Garancisë/Kredisë	Garanci/Kredi
EUR5Y/15/01	30,932,500	M.F.E	Kredi
14/03/IMF	4,167,436	M.F.E	Kredi
08/02/ALPHA	2,885,120	M.I.E	Kredi
11/02/IDB	1,347,842	ARRSH	Kredi
13/06/Abu Dhab	603,206	B.T	Kredi
09/09/KfË	578,899	OST	Kredi
01/11/RUSSIA	571,313	M.F.E	Kredi

16/02/EBRD	570,575	KESH	Garanci
10/02/EIB	565,229	FSHZH	Kredi
09/10/KfE	550,927	OST	Kredi
10/01/EBRD	515,435	FSHZH	Kredi
04/08/EIB	500,824	KESH, OST	Garanci
09/06/CEB	494,770	FSHZH	Kredi
11/09/Abu Dhabi	476,876	ARRSH	Kredi
11/10/EBRD	402,485	ARRSH	Kredi
08/04/JAPAN	368,208	AKUK	Kredi
17/03/KfE	347,340	AKUK	Kredi
08/09/IDA	332,438	KESH	Kredi
15/08/DBFrankrt	330,984	R.T.SH	Garanci
07/17/EBRD	321,397	ARRSH	Kredi

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Borxhi i Jashtëm i Garantuar.

Përgjatë vitit 2020 borxhi i jashtëm i garantuar paraqitet në rritje me 8,818 milion lekë sipas raportimeve në regjistrin e borxhit në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë nga 26,698 milion lekë në 35,516 milion lekë në fund të vitit 2020. Ndryshimet në kreditë e jashtme të garantuara sipas viteve paraqiten sipas tabelës së mëposhtme në milion lekë:

Në milion lekë

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Stoku i Jashtëm i Garantuar	23,182	19,768	29,454	26,698	35,516

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Rritja e borxhit të jashtëm të garantuar përgjatë vitit 2020 ka ardhur si pasojë e pagesave më të vogla të principalit të kryera nga buxheti i shtetit përkundrejt disbursimeve për këto garanci. Buxheti i Shtetit për vitin 2020, ka paguar principal 2,384.51 milion lek për rastet e garancive të huaja ku përfituesit e garancive kanë dështuar të përmbushin detyrimet e tyre. E njëjta situatë paraqitet edhe për shpenzimet e interesit, ku Buxheti i Shtetit ka paguar 327.79 milion lekë shpenzime interesi. Shuma e kthyer nga përfituesit e garancive në Buxhetin e Shtetit gjatë vitit 2020 për këto pagesa që janë kryer është vetëm 57.66 milion lekë për principalin dhe 23.90 milion lekë për interesat, duke vazhduar tendencën e akumulimit të detyrimeve ndaj buxhetit si në vitet e kaluara.

Në milion lekë

	Principal i Shlyer	Interes i Shlyer	Totali
Buxheti i Shtetit	2,384.51	327.79	2,712.30
Njesia Perfituese	1,010.29	264.49	1,274.78
Totali	3,394.80	592.28	3,987.08

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Nga auditimi është konstatuar se pagesat e kryera nga Buxheti i Shtetit **për garancitë e huaja jo-performuese kryhen jo në përputhje me kërkesat e nenit 42 të ligjit nr. 9665 datë 18.12.2006** “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në të cilën citohet se: “Kur huamarrësi s’ka mundur të bëjë pagesën/pagesat, në përputhje me kushtet dhe afatet e marrëveshjes së huasë, të përcaktuara për këtë qëllim dhe institucioni huadhënës vërteton se ka marrë të gjitha masat e nevojshme, siç përcaktohet në këtë ligj dhe në marrëveshjen e garancisë, për të marrë në dorëzim pagesën/pagesat e premtuara, institucioni huadhënës i paraqet Ministrit të Financave një kërkesë për pagesë, në përmbushje të së drejtës së tij, sipas garancisë shtetërore të huasë. Ministri i Financave, pasi vëren se kërkesa për pagesë është në përputhje me kushtet që bëjnë të nevojshme

paraqitjen e një kërkesë të tillë, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për institucionin huadhënës brenda pesëmbëdhjetë ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës”. Aktualisht konstatohet se procesi konsiston në komunikim paraprak nga MFE me përfituesin e garancisë i cili konfirmon nëse është apo jo në gjendje që të shlyejë këstin e radhës dhe në rast paaftësie nga ana e tij procedohet me pagesën nga Buxheti i Shtetit.

Mbi Shërbimin e Borxhit

Shpenzimet për interesa përgjatë vitit 2020, kanë rezultuar në ulje të lehtë në krahasim me vitin e kaluar duke shënuar vlerën prej 34,393.40 milion lekë, përkundrejt 35,142.82 milion lekë që rezultuan një vit më parë, pra kemi një ulje prej 749.42 milion lekë në total. Raportimet mbi shpenzimet për interesa për borxhin e brendshëm dhe interesa për borxhin e huaja paraqiten në milion lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Në milion lekë

Shpenzimet e interesit	2016	2017	2018	2019	2020
Interesat e borxhit të brendshëm	25,526.45	21,414.59	23,157.97	22,837.89	22,350.91
Interesat e borxhit të jashtëm	10,733.00	10,489.19	13,355.40	12,304.93	12,042.49
Interesat e borxhit gjithsej	36,259.45	31,903.78	36,513.37	35,142.82	34,393.40

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Ulja më e madhe në interesat e borxhit konstatohet në interesat e borxhit të brendshëm me rreth 486.98 milion lekë, përkundrejt 262.44 milion lekë interesa të paguara më pak për borxhin e jashtëm.

Interesat e Borxhit të Brendshëm

Shpenzimet e interesit të borxhit të brendshëm kanë ardhur në ulje në krahasim me një vit më parë, ku interesat për vitin 2020 vlerësohen në shumën 22,303 milion lekë përkundrejt 22,838 milion lekë në vitin 2019. Pjesa më e madhe e interesave për shërbimin e borxhit të brendshëm është e akumuluar në drejtim të interesave për kuponat e obligacioneve.

Në vijim janë paraqitur të dhënat mbi interesat e paguara përgjatë vitit 2020 sipas instrumenteve të borxhit të brendshëm në lekë:

Në milion lekë

Viti	2019	2020
Interesa Borxh i Brendshëm	22,838	22,303
Interesa Bono Thesari	4,104.07	3,268.34
Interesa bono thesari 3/mujor te emetuara ne tregun financiar	0	28.63
Interesa bono thesari 6/mujor te emetuara ne tregun financiar	39	30.92
Interesa bono thesari një vjeçar te emetuara ne tregun financiar	4,065	3,208.79
Interesa Obligacione	18,733.83	19,034.62
Interesa obligacione ne tregun financiar me afat maturimi 6 deri 10 vjet	10,579	11,030.84
Interesa obligacione ne tregun financiar me afat maturimi nga 1 deri 5 vjet	8,155	8,003.78

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Interesa e bonove të thesarit 3 mujore paraqiten në vlerën 28.63 milion lekë duke qenë se gjatë vitit janë emetuar bono të tilla kurse vitin e kaluar kanë qenë në vlerën 0 lekë. Interesat e bonove të thesarit 6 mujore paraqiten në ulje me rreth 8.196 milion lekë në raport me një vit më parë, duke qenë se janë kryer më pak emetime të këtij instrumenti përgjatë viti në raport me një vit më parë. Nga ana tjetër interesat e paguara për bonot e thesarit njëvjeçare paraqiten me një rënie prej 856.17 milion lekë në krahasim me një vit më parë. Edhe kuponat e obligacioneve paraqiten jo në të njëjtat nivele me një vit më parë, përkatësisht me një ndryshim ndërmjet maturiteteve

përkatëse, ku interesi i paguar për obligacionet me maturitet 1-5 vjet paraqitet në ulje me rreth 150.98 milion lekë ndërkohë që interesi i paguar për obligacionet me maturitet 6-10 vjet paraqiten në rritje me rreth 451.78 milion lekë.

Interesat e Borxhit të Jashtëm

Shpenzimet e interesit të borxhit të jashtëm kanë ardhur në rënie në krahasim me një vit më parë ku shpenzimet e interesit të borxhit të jashtëm për vitin 2020 vlerësohen në shumën 12,396 milion lekë përkundëjt 12,580 milion lekë të deklaruara në vitin 2019. Në vijim janë paraqitur të dhënat mbi interesat e paguara përgjatë vitit 2019 dhe 2020 sipas llojit të huamarrjes në lekë.

Në milion lekë

Viti	2019	2020
Interesa Borxh i Jashtëm Deklaruar	12,580	12,396
Interesa Borxhi i Jashtëm	12,095	11,440
Interesa huamarrje afatgjate nga institucionet nderkombtare	6,193.59	5,650.52
Interesa huamarrje afatgjate nga qeveri te huaja	1,225.21	1,175.19
Interesa huamarrje afatgjate per huamarrje te tjera te jashtme	4,675.80	4,614.01
Komisione Huamarrje e Jashtme	485	956
Komisione te huamarrjes se jashtme	485.38	956.42

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Ulja në shërbimin e borxhit i atribuohet kryesisht uljes së interesave të huamarrjes së jashtme në krahasim me vitin e kaluar me rreth 655 milion lekë. Ku më konkretisht kemi rënie me 543 milion lekë të “Interesave të huamarrjes afatgjatë nga institucionet ndërkombëtare”, 50 milion lekë të “Interesave të huamarrjes afatgjatë nga qeveri të huaja” dhe 62 milion lekë të “Interesave të huamarrjes afatgjatë për huamarrje të tjera të jashtme”. Kjo për arsye se gjatë vitit 2020 ka pasur një ulje të mëtejshme të normave referencë të interesit Euribor dhe Libor. Kurse shpenzimet e komisioneve në raport me një vit më parë për borxhin e jashtëm kanë ardhur në rritje me rreth 471.05 milion lekë, e kushtëzuar kjo nga komisionet e larta të menaxhimit kur kredia bëhet aktive, ku për tu përmendur është një kredi e B..... për projektin e konektivitetit të rrugëve lokale dhe rurale dhe Eurobondi.

Në lidhje me konstatimet e paraqitura më sipër, nga ana e MFE janë paraqitur observacione me shkresën nr.8596/7 datë 27.09.2021 në të cilën është parashtruar që:

- *MFE i qëndron opinionit të shprehur edhe më parë se Neni 42 i Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është në kundërshtim me marrëveshjet e garancive, të cilat ratifikohen me ligj nga Kuvendi dhe bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, prevalojnë ndaj ligjeve të vendit.*
- *Këto marrëveshje parashikojnë që Garantuesi (Qeveria e RSH) do të paguajë kreditorin menjëherë dhe pa kushte, në rastet kur huamarrësi nuk përmbush detyrimet e tij dhe nuk përmbajnë asnjë detyrim për Institucionin huadhënës që të marrë masa për rekuperimin e detyrimeve.*
- *Lidhur me vendosjen e detyrueshme të konfirmimit për paaftësi paguese përpara realizimit të pagesës, jemi të mendimit se realizimi i kësaj procedure (verifikimi i llogarive, bllokimi, mbajtja e shumave) përpara kryerjes së pagesës nga MFE, kërkon kohë që do të sjellë vonesa në kryerjen e pagesës dhe për rrjedhojë edhe penalitete dhe dëm moral për Shqipërinë, kjo në rastin më të mirë. Gjithashtu mosshlyerja në kohë i ndonjë prej detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e garancisë mund të sjellë konsekuenca akoma më të mëdha për vendin duke përbërë kështu rrethana për pezullimin apo pagesë të menjëhershme të gjithë kredive të tjera aktive që ka vendi ynë me kreditorin respektiv apo edhe me kreditorë të tjerë. Ndaj një ndërhyrje e tillë në ligj*

nuk është e përshtatshme, dhe për më tepër mund të konsistojë në një risk të shtuar për financat publike të vendit.

- *Parë nën këtë këndvështrim, realizimi i procedurës së verifikimit duhet ti shërbejë vetëm masave administrative për tu ndërmarrë në vijim, por nuk mund të çojë në moszbatim nga ana e Qeverisë Shqiptare, të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja përkatëse e Garancisë.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Konstatimi dhe gjetja e grupit të auditimit qëndron duke qenë se mbetet ende i paqartë dhe jo i rregulluar procesi i përcaktimit të gjendjes së paaftësisë paguese të huamarrësit, bazuar vetëm në një njoftim të tij, e parë kjo së bashku me mungesën e arkëtimit të detyrimeve në lidhje me këto të drejta për të arkëtuar për Buxhetin e Shtetit në vijim. Observacioni i subjektit të audituar nuk e kundërshton gjetjen dhe konstatimin e grupit të auditimit por shpreh opinionin e vet në lidhje me rekomandimin e lënë në projekt raportin e auditimit.

Garancitë Sovrane

Në stokun e garancive përfshihen dhe dy garancitë që emtoi qeveria e Republikës së Shqipërisë gjatë muajve prill – maj 2020, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

a) Garancia Shtetërore 1: Miratimi i Garancisë shtetërore të Huasë me Bankat e Nivelit të Dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga COVID-19

Në vijim të Paketës Financiare 1 u miratua VKM Nr. 277 datë 06.04.2020 “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur si pasojë e Vendimeve të Këshillit të Ministrave”, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar, si dhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së mirëkuptimit”.

Elementët kryesorë të Garancisë Shtetërore 1:

- U emetua garancia shtetërore në vlerën **11,000,000,000 lekë**, në favor të 12 bankave të nivelit të dytë, pjesë e skemës së garancisë që do të mundësojë huadhënien për të përballuar pagat e tregtarëve, shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është mbyllur ose është ndikuar me ulje të xhiros, si pasojë e vendimeve dhe urdhërave të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë **nuk merr përsipër asnjë rast garantimin e interesave** ose penalteteve që mund të burojnë nga Huatë që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve.
- Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka të drejtë që pas 60 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse të garancisë t’i propozojë Këshillit të Ministrave nëse është e nevojshme, rialokimin e shumës së garancisë, nga huadhënësi që nuk e ka ezauruar shumën e garancisë në favor të tij të huadhënësi që e ka ezauruar atë plotësisht.
- Në këtë skemë nuk përfshihen tregtarët ose shoqëritë tregtare të cilët janë subjekt i përfitimit nga skema e subvencionimit të pagës.
- Autorizohet Ministri i Financave dhe Ekonomisë për nënshkrimin e marrëveshjeve të garancisë me secilën nga bankat e nivelit të dytë.

Nëpërmjet VKM Nr.370 datë 06.05.2020, Këshilli i Ministrave miratoi disa shtesa dhe

ndryshime në Marrëveshjen e Garancisë, ndryshime që konsistojnë si në vijim:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë krahas garantimit të principalit, merr përsipër të **rimbursojë interesat e Huave që të do** trajtohen në këtë Marrëveshje Garancie.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë do t'i rimbursojë Huadhënësit interesat që burojnë nga Huatë e garantuara nga kjo Marrëveshje Garancie 1 herë në 3 muaj ku tremujori i parë do të fillojë të llogaritet nga data e bërjes efektive të kësaj marrëveshje.
- Huamarrësi nuk duhet të ketë kredi me probleme (sipas përcaktimit të Rregullores së Bankës së Shqipërisë nr.62 datë 14.09.20211 “Për administrimin e riskut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave, të ndryshuar), në muajin shkurt 2020.
- Huadhënësi do të ofrojë Huanë me një normë interesi preferenciale, të barabartë me normën mesatare të interesit të tre ankandeve të fundit të bonove të thesarit 12 mujore plus një marzh prej 0.5%, por në asnjë rast **norma e interesit nuk do të jetë më e lartë se 2,85%.**

Kriteret e kualifikimit të Huamarrësve:

- Huamarrësi duhet të bëj pjesë në kategorinë e subjekteve të prekura nga vendimet e qeverisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19.
- Huamarrësi duhet të ketë aftësi ripaguese për të marr hua në linjë me kriteret që operon sektori bankar, e vlerësuar kjo me kushtet përpara shpalljes së fatkeqësisë natyrore dhe në diskrecion të plotë të Huadhënësit.
- Qëllimi i përdorimit të Huasë do të jetë vetëm për të paguar pagat e punonjësve të Huamarrësit, bazuar në listat e procesuara pranë Huadhënësit në muajin shkurt.
- Huamarrësi duhet të nënshkruaj Marrëveshjen e Mirëkuptimit sipas formës dhe përmbajtjes të përcaktuar në Aneks.
- Huamarrësi duhet të dorëzoj kërkesën e aplikimit për Hua pranë Huadhënësit jo më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.

b) Garancia Shtetërore 2: Miratimi i Garancisë shtetërore të Huasë me Bankat e Nivelit të Dytë, për rimëkëmbjen e biznesit nga COVID-19

Në vijim të zbatimit të Paketës Financiare 2 për rimëkëmbjen e biznesit nga COVID-19, u miratua VKM Nr.387 datë 13.05.2020 “Për miratimin e garancisë shtetërore të huasë me bankat e nivelit të dytë për garantimin e huamarrjes së tregtarëve ose shoqërive tregtare për të mundësuar financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar të ndikuar nga situata e krijuar nga covid-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”

Elementët kryesorë të Garancisë Shtetërore 2:

- U emetua Garancia Shtetërore e dytë, në shumën prej **15,000,000,000 Lekë**, në favor të bankave tregtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Republikën e Shqipërisë, pjesë e skemës së garancisë që do të mundësojë huadhënien për tregtarët dhe shoqëritë tregtare për të siguruar fondet e nevojshme për kapital qarkullues dhe investime për të mbështetur rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar që është ndikuar nga situata e krijuar nga COVID-19.
- Në këtë skemë garancie, **Qeveria garantoj 60% të principalit.**
- Ministri i Financave ka të drejtë që pas 90 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse, nëse është e nevojshme, sipas raportit të strukturës së posaçme ndërinstitucionale, i propozon Këshillit të Ministrave ri-alokimin e shumës së garancisë, nga huadhënësi që nuk e ka ezauruar shumën e garancisë në favor të tij te huadhënësi që e ka ezauruar atë plotësisht.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë mund të kërkoj këshillim/asistencë nga Banka e Shqipërisë gjatë implementimit të marrëveshjeve të garancisë. Ky bashkëpunim mund të rregullohet edhe nëpërmjet një memorandum bashkëpunimi.
- Autorizohet Ministri i Financave dhe Ekonomisë për nënshkrimin e marrëveshjeve të garancisë me secilën nga bankat e nivelit të dytë.

Kriteret e kualifikimit të Huamarrësve:

- Huamarrësi duhet të jetë tregtar ose shoqëri tregtare i regjistruar në QKB dhe struktura e kapitalit të zotërohet 100% nga subjekte jopublike.
- Huamarrësi mund të jetë subjekt që ushtron veprimtarinë tregtare në të gjithë sektorët e ekonomisë, me kusht që veprimtaria e tij tregtare të jetë prekur direkt ose indirekt nga aktet ligjore ose nënligjore të qeverisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, nëpërmjet mbylljes së përkohshme të aktivitetit tregtar ose nëpërmjet ndikimit me ulje të aktivitetit tregtar.
- Huamarrësi nuk duhet të ketë detyrime tatimore të papaguara për 3 periudhat tatimore: dhjetor 2019, janar-shkurt 2020, përjashtuar tatimpaguesit të cilët kanë lidhur marrëveshje për pagimin me këste të detyrimeve tatimore si dhe tatimpaguesit, detyrimet e papaguara të të cilëve janë në process apelimi në të gjitha shkallët.
- Huamarrësi duhet të nënshkruajë formularin e vetëdeklarimit nëpërmjet të cilit deklaron se:
 - *Nuk ka aplikuar dhe nuk ka marr ndonjë Hua tjetër që do të mbulohet nga kjo skemë garancie.*
 - *Fondet e Huasë do të përdoren vetëm për të mbështetur rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar që është prekur nga COVID-19.*
- Huamarrësi duhet të dorëzojë kërkesën e aplikimit për Hua pranë Huadhënësit jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.

Nëpërmjet VKM Nr.480 datë 17.06.2020 Këshilli i Ministrave miratoi disa shtesa dhe ndryshime në Marrëveshjen e Garancisë të miratuar më herët me VKM nr.387 datë 13.05.2020 si mjeti për zbatimin e Garancisë Shtetërore në kuadër të Paketës Financiare II. Këto ndryshime konsistojnë në rishikimin e nenit 7 “Rikuperimi post-pagesës së garancisë”. Pikat kryesore të rishikuara janë:

*“...nëse pas 2 vitesh nga data e kryerjes së Pagesës së Garancisë, Huadhënësi nuk ka mundur të rikuperojë detyrimet e Huamarrësit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron të drejtën që të **ndjekë vetë procedurat ligjore**, në masën e cdo pagese të kryer nga MFE, në kuadër të garancisë për këtë Hua, në përputhje me të drejtat dhe mjetet ligjore që ka në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit, paragrafi 3”.*

“...Vlera që Huadhënësi paguan në favor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në rast të rikuperimit të detyrimit të Huamarrësit nga Huadhënësi pas Pagesës së Garancisë, është e barabartë me vlerën e rikuperuar pasi të jenë zbritur principli dhe interesi i papaguar ndaj Huadhënësit, si dhe shpenzimet për rikuperimin e Huasë (paragrafi 5).

Sipas këtij vendimi parashikohet se ndryshimet e nenit 7, reflektohen edhe në marrëveshjet e garancisë së lidhura e bankat tregtare, përpara hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

Me Urdhrin Nr.56 datë 23.04.2020 “Për ngritjen e Komitetit të Monitorimit të ecurisë së garancisë shtetërore të Huas me bankat e nivelit të dytë, për pagat e tregtarëve ose të shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e Këshillit të Ministrave, në kuadër të menaxhimit

të situatës së krijuar nga COVID-19”, u ngrit Komiteti i Monitorimit me qëllim monitorimin, shqyrtimin dhe raportimin periodikisht pranë Ministrin të Financave dhe Ekonomisë në lidhje me ecurinë e garancisë shtetërore, miratuar me VKM Nr. 277 datë 06.04.2020.

Ky Komitet Monitorimi përbëhet nga:

- Znj.B.E,
- Znj.K.H
- Znj.E.P
- Znj.I.K.....
- Znj.E.A
- Z.A.P
- Znj.A.K

Detyrat e Komitetit të Monitorimit:

- a) Miratimi i formave standarte të raportimit ditor, javor, mujor, që bankat e nivelit të dytë bëjnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- b) Ndryshimi në cdo moment i formatit standard të raportimit si dhe miratimi i formave të tjera të raportimit standard, periodike ose specifike.
- c) Shqyrtimi i raporteve ditore, javore dhe mujore, të cdo huadhënësi për huatë e aprovuara prej tij, sipas përcaktimeve të nenit 8, të marrëveshjes së garancisë.
- d) Shqyrtimi i raporteve mujore të cdo huadhënësi dhe përgatitja e një raporti përmbledhës për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, brenda datës 25 të muajit pasardhës.
- e) Dërgimi pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i sygjërimeve për ecurinë e garancisë sovrane.

Sipas përcaktimit të pikës 5 të këtij Urdhëri “Komiteti i Monitorimit mbledhet jo më pak se 2 herë në muaj” dhe mbështetet nga 1 sekretariat teknik, i cili sëbashku me rregulloren e funksionimit të Komitetit të Monitorimit miratohen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Me Urdhërin Nr.108 prot me nr 7868 datë 06.05.2020 “Për miratimin e Sekretariatit Teknik dhe rregullores së funksionimit të Komitetit të monitorimit të ecurisë së garancisë shtetërore të Huasë” u ngrit Sekretariati Teknik me përbërje si në vijim:

- Znj.S.SH specialiste, Sektori i Regjistrimit dhe Shërbimit të Borxhit
- Znj.V.XH, specialiste, Sektori i Analizës dhe Statistikës së Politikave Fiskale
- Znj.R.M, specialist, Sektori i Tregut të Brendshëm, **si dhe u miratua Rregullorja me objekt përcaktimin e rregullave për mënyrën e funksionimit të Komitetit të Monitorimit.**

Konstatohet se Rregullorja në përmbajtje të saj përbëhet nga seksionet si në vijim:

- **Vendimmarrja:** kuorumi i domosdoshëm për vendimmarrje në mbledhjet e Komitetit kërkon pjesëmarrjen e shumicës së anëtarëve.
- **Monitorimi dhe Auditimi:** Garantuesi nëpërmjet Komitetit nuk është i detyruar të monitorojë ose verifikojë dhe nuk do të jetë përgjegjës për monitorimin ose verifikimin e kriterëve dhe përdorimit të shumave të dhëna nga Huadhënësi për klientët. Pavarësisht kësaj, Garantuesi mund të kërkojë informacion nga Huadhënësi për t’i mundësuar Garantuesit të verifikojë nëse një transaksion është i pranueshëm dhe nëse përfshirja e tij në Portofol është në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshje. Për të mundësuar monitorimin, kontrollin dhe auditimin e përdorimit të saktë të Garancisë dhe pajtueshmërisë me dispozitat e marrëveshjes, Garantuesi mund të kërkojë në cdo

moment, ndërmarrjen e Kontrolleve/auditimeve nga strukturat përkatëse sipas ligjit pas Miratimit nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

➤ **Dokumentacioni dhe Informacioni:** Të gjitha të dhënat, dokumentet dhe informacionet e depozituara nga bankat e nivelit të dytë ruhen elektronikisht dhe fizikisht pranë Sekretariatit, i cili menaxhon dhe administron inventarin e tyre.


Me Urdhërin Nr.92 datë 10.07.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne urdhërin Nr.56 datë 23.04.2020 të Kryeministrit, janë bërë disa ndryshime që konsistojnë në përfshirjen e monitorimit, shqyrtimit dhe raportimit edhe të garancisë së dytë Sovrane (nga Komiteti i Monitorimit) në lidhje me financimin për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar.”

Nga auditimi u konstatua se:

Të kategorizuara sipas Bankave shumat e miratuara, disbursuara dhe stoku i detyrimit të subjekteve në datën 31.12.2020 për Garancinë Sovrane 1 paraqiten si në vijim:

Mijë lekë

BANKA	Nr.raste (subjekte) – Hua Miratuar	% mbi totalin	Vlera e Huasë së miratuar	% mbi totalin	Vlera e Huasë së Disbursuar	Stoku 31.12.2020
C.....	47	9%	319,241	5%	316,558	255,344
A.....	22	4%	495,065	8%	430,170	373,521
P.....	30	6%	300,801	5%	300,801	236,801
T.....	31	6%	334,395	6%	308,422	235,090
I.....	60	12%	604,415	10%	546,609	482,061
B.....	1	0%	1,650	0%	1,650	1,489
F.....	19	4%	90,342	2%	90,342	74,811
O.....	56	11%	913,014	15%	850,295	711,326
R.....	82	16%	1,410,873	24%	1,217,644	1,058,705
U.....	25	5%	192,040	3%	188,501	157,943
A.....	24	5%	150,256	3%	125,920	105,520
B.....	103	21%	1,089,212	18%	955,829	830,341
TOTAL	500	100%	5,901,304	100%	5,332,741	4,522,952



Pika 7 e nenit 4 “Detyrimet e Huadhënësit” të VKM Nr.277 datë 06.04.2020, përcakton se: “Në rast se huamarrësi ka marr një hua për këtë program nga banka të tjera, cdo hua tjetër për paga nuk do të jetë subjekt i kësaj marrëveshje”.

Në kundërshtim me këtë përcaktim nga auditimi janë konstatuar subjekte që kanë përfituar nga kredia në më shumë se 1 bankë, si rrjedhojë edhe nga Garancia Sovrane 1 si në vijim:

Në 2 Banka

Mijë lekë

Nipt	Emri Subjektit	Shuma e miratuar Total	Shuma e disbursuar Total	Stoku 31.12.2020 Total	BANKA
J.....	Gj.....	29,909	29,313	23,832	C.O.....
J.....	E.....	3,974	3,438	2,888	B.....
K.....	C.....	8,963	7,596	6,277	C-R.....
K.....	A.....	213,890	202,761	193,082	O-R.....
K.....	N.....	46,866	32,080	21,701	T-R.....
K.....	R.....	29,064	22,570	18,981	B.R.....
K.....	M.S.....	26,991	22,284	18,237	A-O.....
K.....	R.....	103,617	103,557	82,460	R.P.....
K.....	H.A.....	4,214	3,953	3,615	B-I.....
K.....	G.M.....	29,825	29,592	25,447	O-A.....
K.....	I.H.....	94,658	91,243	78,707	O-R.....
K.....	G.S.....	44,180	37,904	31,129	B-C.....
K.....	D.....	5,515	5,403	4,246	T-A.....
L.....	K.....	27,505	18,837	14,281	O-A.....
L.....	F.....	4,363	3,202	2,806	B-C.....
L.....	B.....	1,736	1,727	1,416	C-R.....
L.....	A.....	5,610	4,589	3,816	A.....
L.....	K.....	27,536	13,257	11,016	B-T.....

Në 3 Banka

Mijë lekë



Nipt	Emri Subjektit	Shuma e miratuar Total	Shuma e disbursuar Total	Stoku 31.12.2020 Total	BANKA
J.....	A.....	130,663	129,666	110,755	T-O-P

J.....	A.....	50,846	49,430	42,040	T-O-B.....
K.....	A.....	14,368	11,989	10,206	R-B-T.....
K.....	L.....	13,205	11,517	9,847	T-R-B.....
L.....	P.....	22,950	19,853	16,975	A-B-C.....

Të kategorizuara sipas Bankave shumat e miratuara, disbursuara dhe stoku i detyrimit të subjekteve në datën 31.12.2020 për Garancinë Sovrane 2 paraqiten si në vijim:

Mijë lekë

BANKA	Nr.raste (subjekte) – Hua e Miratuar	% totalin mbi	Vlera e Huasë së miratuar	% mbi totalin	Vlera e Huasë së Disbursuar	Stoku 31.12.2020
C.....	55	17%	1,165,550	13%	950,229	928,348
A.....	3	1%	155,000	2%	155,000	147,506
P.....	35	11%	507,500	6%	507,500	463,192
T.....	12	4%	970,500	11%	829,469	796,358
L.....	24	8%	505,054	6%	505,055	460,438
B.....	3	1%	106,000	1%	106,000	103,219
F.....	18	6%	439,300	5%	439,300	427,822
O.....	71	22%	2,242,874	25%	2,194,974	2,136,789
R.....	74	23%	1,829,736	20%	1,613,339	1,450,013
U.....	7	2%	350,500	4%	350,500	349,225
A.....	14	4%	648,607	7%	563,738	341,552
B.....	2	1%	30,000	0%	25,000	25,000
TOTAL	318	100%	8,950,621	100%	8,240,103	7,629,463



Nga auditimi mbi përputhshmërinë me Ligjin Nr. 9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM të lartpërmendura për miratimin e Garancive shtetërore të huasë me bankat e nivelit të dytë, Urdhrave për ngritjen e Komitetit të Monitorimit dhe Sekretariatit Teknik, si dhe rregullore së Funkcionimit të Komitetit konstatohen problematikat e mëposhtme:

Grupi auditimit konstaton se marrëveshjet me Bankat për të dy garancitë sovrane të miratuara me VKM janë jo në përputhje si me Ligjin e Huamarrjes ashtu edhe me përcaktimet në nenet në brendësi të vetë marrëveshjes. Sqarojmë si në vijim:

1. Pika 2, Neni 2, i aneksit të marrëveshjes miratuar me VKM Nr.370 datë 06.05.2020 citon se: Ministria e Financave dhe Ekonomisë krahas garantimit të principalit, merr përsipër të rimburojë/paguajë interesat e Huave që do të trajtohen në këtë Marrëveshje Garancie.

Ky përcaktim nuk gjen parashikim në Ligjin Nr. 9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Neni 3 “Kuptimi i garancisë shtetërore të huasë” i cili citon se *“Garancia shtetërore e huasë është marrëveshja e lidhur me shkrim, e cila përmban rregulla për të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet dhe mënyrat, sipas të cilave shteti është përgjegjës për detyrimet financiare të një huamarrësi, kur ai nuk arrin t’i paguajë ato në kohën dhe masën e duhur”* dhe neni 34 “Natyra e garancisë shtetërore” i cili citon se *“Garancia shtetërore e huasë nuk përbën detyrim të drejtëpërdrejtë për shtetin, por përfaqëson një detyrim të mundshëm. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtëpërdrejtë kur përfituesi i drejtëpërdrejtë nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë”*.

Për sa më sipër rimbursimi i Interesave të Huasë nga buxheti shtetit, përcaktuar me VKM nuk gjen mbështetje dhe parashikim në Ligjin e Huamarrjes shtetërore, pa plotësuar kushtin që përfituesi i drejtëpërdrejtë “të mos arrijë të paguajë”.

Konstatohet se Interesat e paguara nga Buxheti i Shtetit deri në datën 31.12.2020 janë në vlerën prej 47,948 mijë lekë.

2. Neni 2 “Garancia” e Marrëveshjes së Garancisë Sovrane 1, pika 3 dhe Neni 2 “Garancia “Marrëveshja e garancisë Sovrane 2 ”, pika 4 citon “Në asnjë rast, MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve”.

Këto përcaktime, në të dyja Garancitë Sovrane, **janë jo në përputhje me Ligjin e Huamarrjes, Neni 34** “Natyra e garancisë shtetërore” i cili citon se *“Garancia shtetërore e huasë nuk përbën detyrim të drejtëpërdrejtë për shtetin, por përfaqëson një detyrim të mundshëm. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtëpërdrejtë kur përfituesi i drejtëpërdrejtë nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë.”*

Sipas këtij përcaktimi në Ligjin e Huamarrjes nuk ka parashikim për mospagimin e interesave ose penaliteteve të cilat në fakt janë pjesë të detyrimit, në rast se përfituesi i drejtëpërdrejtë nuk arrin të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë.

3. Grupi auditimit konstaton gjithashtu Neni 2 “Garancia” Marrëveshja e Garancisë së parë, pika 3 e cila citon se *“MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve”* **bie në**

kundërshtim me Nenin 6 “Procedurat për kryerjen e pagesave të garancisë” së po kësaj marrëveshje pikën 1 e cila citon “Kur huamarrësi nuk ka mundur të kryej pagesën e detyrimeve në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë....huadhënësi rezervon të drejtën për t’i dërguar MFE-s kërkesën me shkrim për pagesën e detyrimeve dhe pikën 2 e cila citon se “...Kërkesa për pagesë që Huadhënësi do t’i drejtojë MFE-s duhet të përmbajë:

b) Një përshkrim të detajuar të shumës që kërkohet, duke përcaktuar në mënyrë analitike, principalin, interesat e akumuluar, penalitetet, si dhe cdo shpenzim tjetër të kryer në zbatim të marrëveshjes së huasë që është në ngarkim të Huamarrësit, pavarësisht faktit që garancia mbulon vetëm detyrimin e principalit të Huasë.

Për sa më sipër dhe Neni 2 dhe Neni 6 i marrëveshjeve së Garancisë Sovrane 1 janë jo në përputhje me njëra tjetrën.

4. Pika 2 e Nenit 2 të VKM Nr.370 datë 06.05.2020, për disa ndryshime në VKM Nr.277 datë 06.04.2020 e cila citon se “*MFE krahas garantimit të principalit merr përsipër të rimbursojë Interesat e Huave që do të trajtohen nën këtë marrëveshje Garancie...është jo në përputhje me pikën 3 të Nenit 2* e cila citon se “*MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë... ”.*

5. Grupi auditimit konstaton gjithashtu Neni 2 “Garancia” Marrëveshja e Garancisë Sovrane 2, pika 4 e cila citon se “*MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve” është jo në përputhje me Nenin 6 “Procedurat për kryerjen e pagesave të garancisë” së po kësaj marrëveshje pika 1 e cila citon “Kur huamarrësi nuk ka mundur të kryej pagesën e detyrimeve në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë....huadhënësi rezervon të drejtën për t’i dërguar MFE-s kërkesën me shkrim për pagesën e detyrimeve” dhe pikën 2 e cila citon se “...Kërkesa për pagesë që Huadhënësi do t’i drejtojë MFE-s duhet të përmbajë:*

b) Një përshkrim të detajuar të shumës që kërkohet, duke përcaktuar në mënyrë analitike, principalin, interesat e akumuluar, penalitetet, si dhe cdo shpenzim tjetër të kryer në zbatim të marrëveshjes së huasë që është në ngarkim të Huamarrësit, pavarësisht faktit që MFE garanton vetëm principalin në masën 60%.

Për sa më sipër dhe Neni 2 dhe Neni 6 i marrëveshjeve Garancia Sovrane 2 janë jo në përputhje me njëra tjetrën.

6. Nenet 36, 37, 38, 40 të Ligjit Nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar përcaktojnë kompetenca të plota të MFE për shqyrtimin, vlerësimin dhe dhënien e garancisë shtetërore të huasë si në vijim:

Neni 36 “Shqyrtimi dhe analiza e garancisë”: “...kur dokumentacioni mbështetës i kërkesës për garanci është i plotë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, është i detyruar që Brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, të shpallë vendimin për dhënien e garancisë”.

Neni 37 “Vlerësimi i riskut”: “...analiza ekonomike-financare sipas nenit 36, përfshin një përcaktim të riskut që merr përsipër shteti, në rast se jepet garancia. Ministri i Financave mund të kërkojë asistencën e Bankës së Shqipërisë për të përcaktuar dhe vlerësuar riskun”.

Neni 38 “Dhënia e garancisë shtetërore të huasë”: “...Ministri i Financave dhe Ekonomisë miraton dhënien e garancisë shtetërore të huasë pasi shqyrton dokumentet e mëposhtme:

- d) *Projekt-marrëveshjen e huasë ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit;*
- e) *Projekt-marrëveshjen e garancisë ndërmjet institucionit huadhënës dhe shtetit;*
- f) *Marrëveshjen e mirëkuptimit, të nënshkruar nga huamarrësi.*

Neni 40 “Mbikëqyrja nga Ministria e Financave”... Ministria e Financave kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marr garanci shtetërore të Huasë...”

Ndërkohë Neni 3 i marrëveshjeve të garancive Sovrane 1 dhe 2 “Kriteret e kualifikimit të Huamarrësve”, pika 1 e cila citon se “Huadhënësi do të jap hua të garantuar vetëm huamarrësve që plotësojnë kriteret si në vijim...” **ka një përcaktim të ndryshëm nga Nenet 36-37 të Ligjit Nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar në lidhje me përgjegjësitë lidhur me vendimmarrjen mbi garancitë shtetërore të huasë, pasi ky Nen ia kalon kompetencën Bankave të nivelit të dytë. Grupi i auditimit vlerëson një risk të lartë në lidhje me këtë duke qënë se nga ana e bankave të nivelit të dytë ekziston mundësia e mosvlerësimit të drejtë të aktivitetit dhe aftësisë paguese të subjekteve që kanë aplikuar për kredi, në kushtet e ofrimit të një garancie nga Shteti.**

7. Në lidhje me kthimin e garancisë shtetërore të huasë marrëveshja e garancive sovraane, nenit 7 “Rikuperimi post-pagesës së garancisë” i cili citon se “...*nëse pas 2 vitesh nga data e kryerjes së Pagesës së Garancisë, Huadhënësi nuk ka mundur të rikuperojë detyrimet e Huamarrësit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron të drejtën që të ndjekë vet procedurat ligjore*”, është jo në përputhje me Nenin 42 të Ligjit të Huamarrjes i cili citon se “*Me kryerjen e pagesës në llogarinë e garancisë shtetërore të huasë institucionit huadhënës, Ministri i Financave merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë...*”, pasi ky i fundit nuk parashikon afat kohor, por i jep të drejtën Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për të vepruar vet dhe direkt me qëllim rikuperimin e detyrimeve.

8. Konstatohet gjithashtu se Kreu 7 “Monitorimi dhe Auditimi”, pika 6.1 e Rregullores së Funksionimit të Komitetit të Monitorimit, të garancive shtetërore, miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, citon se “*Garantuesi nëpërmjet Komitetit/ nuk është i detyruar të monitorojë ose verifikojë, dhe nuk do të jetë përgjegjës për monitorimin ose verifikimin e kritereve dhe përdorimin e shumave nga Huadhënësi për klientët...*”

Për sa më sipër Rregullorja është jo në përputhje me:

- *Urdhri e Kryeministrit Nr.56 datë 23.04.2020 “Për ngritjen e Komitetit të Monitorimit”, pika 1 si në vijim: “urdhëroj ngritjen e Komitetit të Monitorimit, i cili do të monitorojë, shqyrtojë dhe do të raportojë periodikisht pranë Ministrit të Financave...si dhe për përcaktimin e kushteve dhe kritereve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”.*
- *VKM-t për miratimin e garancive sovraane, pika 8 e cila citon: “Struktura e posacme ndërinstucionale...do të miratojë, shqyrtojë dhe raportojë ...”*
- *Nenet 36, 37, 38 të Ligjit Nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar, sqaruar si më lart.*

Problematika të tjera të Vendimit Nr.277 datë 06.04.2020 “Për miratimin e Garancisë shtetërore të huasë me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare” në gjykimin e grupit të auditimit:

▪ Pika 1 “miratimi i linjës së garancisë shtetërore në vlerën 11,000,000,000 lekë, në favor të bankave të nivelit të dytë, pjesë e skemës së garancisë që do të mundësojë huadhënien për të përballuar pagat e tregtarëve ose të shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është mbyllur ose është ndikuar me ulje të xhiros, si pasojë e VKM dhe urdhërave të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19.

Në lidhje me këtë përcaktim mungon gjurma e auditimit për të verifikuar plotësimin e tij si kriter, duke qënë se vendimmarrja dhe kompetenca i është lënë bankave të nivelit të dytë.

▪ Pika 2 “linja e garancisë shtetërore lëshohet në favor të secilës bankë të nivelit të dytë si më poshtë:

- R..... në vlerën 1 900 000 000 lekë;
- B.T..... në vlerën 600 000 000 lekë;
- B.U..... në vlerën 600 000 000 lekë;
- B.I.S..... në vlerën 900 000 000 lekë;
- B.K.....në vlerën 1 900 000 000 lekë;
- B.O.A....në vlerën 1 100 000 000 lekë;
- B.P..... në vlerën 400 000 000 lekë;
- B.A..... në vlerën 700 000 000 lekë;
- B.A.I.... në vlerën 500 000 000 lekë;
- B.C..... në vlerën 2 000 000 000 lekë;
- B.B.SH... në vlerën 100 000 000 lekë;
- B.P.I.A... në vlerën 300 000 000 lekë

Nuk ka një përcaktim në lidhje me kriterin e ndarjes dhe përcaktimit të linjës së garancisë për secilën bankë. Gjykojmë se për aq kohë sa kjo garanci është lëshuar dhe miratuar për të mbuluar pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, ndarja e peshës/vlerës së linjës së garancisë duhet të ishte bërë nisur nga bankat me të cilat subjektet operojnë për kalimin e pagave punonjësve të tyre (detajimi i nr të punonjësve sipas secilit subjekt dhe secilës bankë me të cilën subjekti operon).

Problematika të Vendimit Nr.387 datë 13.05.2020 “Për miratimin e Garancisë shtetërore të huasë me bankat e nivelit të dytë për të mundësuar financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar” në gjykimin e grupit të auditimit:

▪ Pika 2 “linja e garancisë shtetërore lëshohet në favor të secilës bankë të nivelit të dytë si më poshtë:

- R.B..... në vlerën 2 600 000 000 lekë;
- B.T..... në vlerën 850 000 000 lekë;
- B.U..... në vlerën 800 000 000 lekë;
- B.I.S.A...në vlerën 1 200 000 000 lekë;
- B.K..... në vlerën 2 550 000 000 lekë;
- B.O.A.... në vlerën 1 450 000 000 lekë;
- B.P..... në vlerën 600 000 000 lekë;
- B.A..... në vlerën 950 000 000 lekë;
- B.A.I.... .në vlerën 650 000 000 lekë;
- B.C..... në vlerën 2 800 000 000 lekë;

- B.B.SH..... në vlerën 150 000 000 lekë;
- B.P.I..... në vlerën 400 000 000 lekë

Nuk ka një përcaktim në lidhje me kriterin e ndarjes dhe përcaktimit të linjës së garancisë për secilën bankë.

▪ Neni 3 “Kriteret e kualifikimit të huamarrësve dhe kriteret për përfitimin e huasë” pika b) huamarrësi mund të jetë subjekt që ushtron veprimtarinë tregtare në të gjithë sektorët e ekonomisë, me kusht që veprimtaria e tij tregtare të jetë prekur direkt ose indirekt nga aktet ligjore dhe nënligjore të qeverisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, nëpërmjet mbylljes së përkohshme të akvitetit tregtar ose nëpërmjet ndikimit me ulje të akvitetit tregtar.

Në lidhje me këtë përcaktim mungon gjurma e auditimit për të verifikuar plotësimin e tij si kriter, duke qënë se vendimmarrja dhe kompetenca i është lënë bankave të nivelit të dytë.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj nuk disponohen kopje të dosjeve, ekstrakteve, dokumentave, të dhënave të regjistruara dhe të shkresave të të gjitha huave që i nënshtrohen këtyre marrëveshjeve të garancive, dokumentacioni i kërkuar me emailin dhe sqaruar se ky dokumentacioni disponohet nga bankat, pasi janë bankat ato që miratojnë përfituesit.

Kjo nuk është në përputhje me:

-Nenin 4 pika 9 e marrëveshjes së parë dhe Nenin 4, pika 10 e marrëveshjes së dytë “Huadhënësi do të vendos në dispozicion të MFE, me kërkesë të kësaj të fundit, kopje të dosjeve, dokumentave, rekorodeve dhe shkresave të të gjitha huave që i nënshtrohen këtyre garancive”.

-Nenin 8 pika 1 marrëveshjes së parë dhe të dytë “Huadhënësi do të raportojë do të raportojë në formë elektronike pranë MFE...duke përcjellë dhe kopje të dokumentave shoqëruese që vërtetojnë kriteret e kualifikimit të Huamarrësve.

-Nenin 35 të Ligjit të Huamarrjes “...cdo huamarrës në bazë të këtij ligji paraqet një kërkesë me shkrim, e cila shoqërohet me dokumentacionin ekonomik dhe financiar për t’i mundësuar Ministrit të Financave të vlerësojë kushtet financiare dhe aftësinë e pagimit nga huamarrësi”.

Për sa më sipër sqaruar, konstatohet se nga qeveria u akorduan gjithsej 26 miliard Lekë në formën e garancive, të cilat deri në fund të vitit 2020 mundësuan kreditimin e shoqërive tregtare me 14.9 miliard Lekë.

Deri në fund të vitit, Garancia Sovrane 1 është përdorur në masën prej rreth 54% (vlera e miratimeve kundrejt totalit) ndërsa Garancia Sovrane 2 është përdorur në masën prej 36%, ku kjo e fundit do vazhdojë të përdoret deri në afatin e shtyrë për aplikime (30.06.2021) si në vijim:

Garancia 1

Mijë lekë

Nr	Bankat	Marrëveshja e miratuar Nr/datë	Vlera e Miratuar në marrëveshje	Shuma e miratuar nga Banka	% e shumës së dhënë nga banka mbi vlerën e miratuar nga marrëveshja
1	B.C.....	6448/3 prot datë 14.04.2020	2,000,000	319,241	16%
2	A.B.....	6448/12 prot datë 14.04.2020	500,000	495,065	99%
3	R.B.....	6448/8 prot datë 15.04.2020	1,900,000	1,410,873	74%
4	A.B.....	6448/1 prot datë 14.04.2020	700,000	150,256	21%
5	P.C.....	6448/5 prot datë 14.04.2020	400,000	300,801	75%
6	O.B.....	6448/7 prot datë 14.04.2020	1,100,000	913,014	83%
7	I.S.P.....	6448/2 prot datë 14.04.2020	900,000	604,415	67%
8	F.....	6448/4 prot datë 14.04.2020	300,000	90,342	30%
9	B.B.SH.....	6448/10 prot datë 14.04.2020	100,000	1,650	2%
10	U.B....	6448/6 prot datë 14.04.2020	600,000	192,040	32%
11	B.....	6448/11 prot datë 14.04.2020	1,900,000	1,089,212	57%

12	T.B.....	6448/9 prot datë 15.04.2020	600,000	334,395	56%
Total	12		11,000,000	5,901,304	54%

Garancia 2

Mijë lekë

Nr	Bankat	Marrëveshja e miratuar Nr/datë	Vlera e Miratuar në marrëveshje	Shuma e miratuar nga Banka	Shteti 60% garanci (60% e shumës së miratuar nga banka)
1	B.C.....	8640 prot datë 15.05.2020	2,800,000	1,165,550	699,330
2	A.B.....	8640/4 prot datë 15.05.2020	650,000	155,000	93,000
3	R.B.....	8640/8 prot datë 15.05.2020	2,600,000	1,829,736	1,097,842
4	A.B.....	8640/2 prot datë 15.05.2020	950,000	648,608	389,165
5	P.C.....	8640/10 prot datë 15.05.2020	600,000	507,500	304,500
6	O.B.....	8640/14 prot datë 15.05.2020	1,450,000	2,242,874	1,345,724
7	I.S.B.....	8640/12 prot datë 15.05.2020	1,200,000	505,055	303,033
8	F.....	8640/18 prot datë 15.05.2020	400,000	439,300	263,580
9	B.B.SH....	8640/6 prot datë 15.05.2020	150,000	106,000	63,600
10	U.B.....	8640/20 prot datë 15.05.2020	800,000	350,500	210,300
11	B.....	8640/16 prot datë 15.05.2020	2,550,000	30,000	18,000
12	T.B.....	8640/22 prot datë 15.05.2020	850,000	970,500	582,300
Total	12		15,000,000	8,950,623	5,370,374
% e përdorimit të garancisë sovrane					36%

Në lidhje me pjesën e garancive sovrane kërkohet nga strukturat drejtuese një vëmendje e shtuar për problematikat e konstatuara nga auditimi.

Titulli i gjetjes:	Gjatë vitit 2020 nuk është emetuar bono thesari 6-mujore për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit në shumën 6,242,963,462 lekë me efekt në nënvlerësimin e stokut të borxhit në fund të vitit 2020.
Situata:	<p>Banka e Shqipërisë me shkresë nr. 742/1 datë 27.04.2020 ka vendosur në dijeni MFE se në përfundim të procesit të auditimit të pasqyrave financiare të BSH llogaria “Rezerva e Rivlerësimit të Valutave” në mbyllje të vitit financiar 2019 ka rezultuar me gjendje negative 6,242,963,462 lekë, për të cilën në zbatim të nenit 64 (b) të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e shqipërisë” të ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 6 të marrëveshjes “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë” ka kërkuar mbulimin e saj me emetim të bonove të thesarit 6-mujore. Nga ana e MFE me shkresë nr. 7241/1 datë 18.06.2020 drejtuar Bankës së Shqipërisë është njoftuar emtimi i letres me vlere në shumën 6,242.963.462 lekë me afat maturimi 6 muaj dhe normë interesi të barabartë me yield mesatar të ponderuar të ankandit të fundit të bonove të thesarit me afat maturimi 6-mujor.</p> <p>Në vijim, në afatin e maturimit, nga ana e BSH me shkresë nr. 2020/2 datë 18.12.2020 drejtuar MFE, protokolluar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me prot 23754 prot, datë 21.12.2020 është kërkuar rrimetimi i titullit 6-mujor që maturohet në datë 21.12.2020, nëpërmjet rinovimit me çmim blerje të instrumentit me vlerë 6,242,963,462.33 lekë. Kjo shkresë është përcjellë në Drejtorinë e Huamarrjes në datën 28.12.2020.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se në vijim të shkresës nr 2020/2 prot, datë 18.12.2020, referuar marrëveshjes së datës 20.01.2015 nr 716/6 prot, “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së</p>

	<p>Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë”, Neni 6 <i>Mbulimi i humbjeve neto nga rivlerësimi</i>”, Ministria e Financave ka rinovuar emetimin me vlerë në shumën 6,242,963,462 lekë e njëjtë me nivelin e yield-it mesatar të ankandit më të fundit të Bonove të Thesarit me afat maturimi 6 mujor, në momentin e emetimit të letrës me vlerë në datën 11.01.2021, përtej datës së maturimit 21.12.2020. Si konkluzion kjo letër me vlerë nuk është paraqitur në regjistrin e borxhit për vitin 2020, treguesit e borxhit dhe rrjedhimisht stokun e borxhit publik të fundvitit 2020. Nga auditimi konstatohet se nuk është përmbushur detyrimi për refinancimin e këtij instrumenti.</p>
Kriteri:	nenin 64 (b) të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe Marrëveshja me Bankën e Shqipërisë “ <i>Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë</i> ”
Ndikimi/Efekti:	Efekti vlerësohet si nënvlerësim i stokut të borxhit real të raportuar në fund të vitit 2020 në shumën 6,242,963,462 lekë
Shkaku:	Mungesa e emetimit nga ana e MFE në afat dhe mungesa e parashikimit në kohë të efekteve në ligjin e buxhetit mbi kufirin e huamarrjes
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga ana e MFE të kryhen veprimet e rregulluese duke e raportuar stokun e borxhit publik me përfshirjen e bonos përkatëse 6-mujore në regjistrin e borxhit dhe treguesit e borxhit publik. Të rishikohet marrëveshja me Bankën e Shqipërisë në mënyrë që të parashikohet detyrimi për paraqitjen e kërkesës për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit përpara hartimit të ligjit të buxhetit vjetor.

Titulli i gjetjes:	Pagesat e principalit dhe interesave për garancitë jo performuese kryhen nga Buxheti i Shtetit pa u marrë të gjitha masat e nevojshme nga ana e institucionit huadhënës për rekuperimin e detyrimit, por vetëm bazuar në vetdeklarimin e përfituesit të garancisë mbi paaftësinë paguese të tij.
Situata:	Nga auditimi është konstatuar se pagesat e kryera nga Buxheti i Shtetit për garancitë e huaja jo-performuese kryhen jo në përputhje me kërkesat e nenit e nenit 42 të ligjit nr. 9665 datë 18.12.2006 “ <i>Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë</i> ”, i ndryshuar në të cilën citohet se “ <i>Kur huamarrësi s'ka mundur të bëjë pagesën/pagesat, në përputhje me kushtet dhe afatet e marrëveshjes së huasë, të përcaktuara për këtë qëllim dhe institucioni huadhënës vërteton se ka marrë të gjitha masat e nevojshme, siç përcaktohet në këtë ligj dhe në marrëveshjen e garancisë, për të marrë në dorëzim pagesën/pagesat e premtuara, institucioni huadhënës i paraqet Ministrit të Financave një kërkesë për pagesë, në përmbushje të së drejtës së tij, sipas garancisë shtetërore të huasë. Ministri i Financave, pasi vëren se kërkesa për pagesë është në përputhje me kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për institucionin huadhënës brenda pesëmbëdhjetë</i>

	<i>ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës</i> ". Aktualisht konstatohet se procesi konsiston në komunikim paraprak nga MFE me përfituesin e garancisë i cili konfirmon nëse është apo jo në gjendje që të shlyejë këstin e radhës dhe në rast të gjendjes së paaftësisë paguese nga ana e tij procedohet me pagesën nga Buxheti i Shtetit. Një procedurë e tillë, sipas komenteve të përfaqësuesve të Drejtorisë së Borxhit është kryer me qëllim shmangien e kamatvonesave apo penaliteteve në rast vonese të pagesës si pasojë e procedurës për ndjekjen e paaftësisë paguese deri në kërkesën e huadhënësit drejt MFE.
Kriteri:	Neni 42 të ligjit nr.9665 datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Risk i shtuar në drejtim të realizimit të drejtave për të arkëtuar.
Shkaku:	Shmangia e kamatvonesave apo penaliteteve në rast vonese të pagesës.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e Autoritetit Publik dhe të Kompetencës nëpërmjet nga strukturat e borxhit, të ndjek të gjitha rrugët ligjore që të merren masa për hartimin dhe implementimin e procedurave të qarta ligjore me qëllim përcaktimin e një procedurë që parashikon monitorimin proaktiv dhe dinamik dhe konfirmimit të gjendjes financiare dhe aftësisë paguese të subjekteve kredimarrëse (<i>përmes aksesit të autorizuar në informacion mbi gjendjen e llogarive bankare të subjekteve përfituese të garancisë</i>), përpara realizimit të pagesës në mbështetje të vështirësisë financiare të deklaruar nga subjektet përfituese.

Titulli i gjetjes:	KLSH ka konstatuar krijim të detyrimeve të reja në shumën 7,750 milionë lekë (rreth 62.6 milion euro) të subjekteve nënhuamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë përgjatë vitit 2020, si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve përkatëse.
Situata:	Nga auditimi në lidhje me marrëveshjet e nënhuasë konstatohet se stoku i kredive në lidhje me këtë komponent të borxhit shtetëror është përkeqësuar përgjatë vitit 2020. Sektorët me përkeqësim të situatës financiare paraqiten sektori i energjitikës kryesisht me nënhuatë e KESH, OSHEE dhe OST me rreth 5,791 milion lekë (46.8 milion euro) të rritjes totale të detyrimeve nga 7,750 milion lekë në total, pushteti vendor me rreth 1,173 milion lekë (9.5 milion euro) dhe sektori i ujësjellësve me rreth 768 milion lekë (6.2 milion euro). Në nenin 30 " <i>Huadhënia e të ardhurave të borxhit shtetëror, mbi të cilat zbatohen kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare</i> ", të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, " <i>Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë</i> ", i ndryshuar, është përcaktuar që " <i>...është përgjegjësi ligjore e huamarrësve, të cilët kanë marrë fonde, sipas paragrafit të parë të këtij neni, që ti kthejnë fondet e marra hua në përputhje me marrëveshjet e nënhuave dhe të paraqesin raporte për gjendjen e huasë dhe përdorimin e saj, sipas kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Financave</i> ".

	<i>Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet e bëra në këtë nen, duke paraqitur një situatë ku detyrimet ndaj shtetit si pasojë e mos pagesave janë rritur nga viti në vit, duke filluar nga 15,814 milion lekë në fund të vitit 2017, në 21,279 milion lekë në fund të vitit 2018, në 27,344 milion lekë në fund të vitit 2019, dhe në 35,094 milion lekë në fund të vitit 2020. Detyrimet ndaj shtetit si pasojë e mos pagesave përgjatë vitit 2020 janë rritur me 7,750 milion lekë.</i>
Kriteri:	Neni 30 “Huadhënia e të ardhurave të borxhit shtetëror, mbi të cilat zbatohen kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Rritje e detyrimeve ndaj buxhetit të shtetit
Shkaku:	Mungesa e respektimit të marrëveshjeve të nënhuasë të lidhura ndërmjet shtetit dhe nënhuamarrësit, performanca e dobët e nënhuamarrësve e evidentuar kryesisht në sektorin energjitik, pushtetin vendor dhe ujësjellës.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa të menjëhershme për rikuperimin e të drejtave për të arkëtuar nëpërmjet ushtrimit të instrumentave ligjore që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuasë.

Titulli i gjetjes:	Gjatë vitit 2020 janë krijuar detyrime të reja në shumën 3,051 milion lekë (3 miliard lekë) në kuadër të dështimit të pagesave për kreditë e garantuara nga përfituesi i garancisë.
Situata:	<p>Garancitë shtetërore përgjatë vitit 2020 paraqesin një risk të shtuar në drejtim të administrimit të tyre dhe situatës së rënduar financiare të cilën kalon kryesisht sektori energjitik.</p> <p>Për vitin 2020 gjendja e detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është rritur nga 13,198 milion lekë në 15,885 milion lekë, me një rritje vjetore prej 2,687 milion lekë, pa përfshirë efektin e garancive të dhëna në kuadër të projektit me numër identifikimi në regjistrin e kredive “88” në vlerën 364 milion lekë. <u>Me këtë efekt rritja vjetore vlerësohet në shumën 3,051 milion lekë, ose 3 miliard lekë.</u></p> <p>Detyrimet si pasojë e pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit për vitin 2020 janë akumuluar në masën më të madhe nga kompanitë private me kapital shtetëror përfituese në sektorin energjitik në shumën 2,098 milion lekë (16.96 milion euro). Gjatë vitit 2020 konstatohet se Buxheti i Shtetit ka kryer pagesa si pasojë e paaftësisë paguese edhe të R.T.SH, duke rritur stokun e detyrimeve me 354 milion lekë (2.86 milion euro). Gjithashtu edhe në sektorin e ujësjellësve për projektet në U.K.T situata paraqitet problematike duke vendosur Buxhetin e Shtetit në risk për kryerjen e pagesave që kanë dështuar të kryhen nga ky përfitues i garancisë dhe rritjen e detyrimeve në shumën 146 milion lekë (1.18 milion euro).</p> <p>Në nenin 43 “Kthimi i garancisë shtetërore të huasë” të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është</p>

	<p>përcaktuar që “Me kryerjen e pagesës në llogarinë e garancisë shtetërore të institucionit huadhënës, Ministri i Financave merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, në masën e çdo pagese të bërë në kuadër të garancisë së dhënë. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë Ministrin të Financave së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ai i ka në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit. Huamarrësi, në zbatim të këtij ligji dhe të marrëveshjes së mirëkuptimit, është i detyruar ti kthejë Ministrisë së Financave shumën që kjo e fundit i ka paguar huadhënësit, në kuadër të garancisë shtetërore të huasë. Ministri i Financave ndërmerr të gjitha masat e paracaktuara në këtë ligj, në ligje të tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përfutur nga huamarrësi çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të.”</p> <p>Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet e bëra në këtë nen, për aq kohë sa stoku i detyrimeve jo vetëm që nuk është ulur përgjatë vitit 2020, por edhe është rritur me 3 miliard lekë. Konstatohet se masat e marra janë të pa mjaftueshme për zgjidhjen e situatës së krijuar ku risku i kreditit të këtyre institucioneve është mjaft i lartë.</p>
Kriteri:	Neni 43 “Kthimi i garancisë shtetërore të huasë” të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Rritje e detyrimeve ndaj buxhetit të shtetit me 3 miliard lekë përgjatë vitit 2020 për garancitë shtetërore të huasë të huaja
Shkaku:	Performanca e dobët e subjekteve përfituesve të garancisë si pasojë e paaftësisë paguese dhe mungesa e marrjes së masave të mjaftueshme për realizimin e të drejtave që rrjedhin nga transferimi i të drejtës për të arkëtuar të dorëzanësi.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ushtrojë të gjitha mjetet ligjore për arkëtimin e të drejtave për pagesa të kryera për garancitë e arkëtuara dhe në të njëjtën kohë të ushtrojë kontroll mbi planet ekonomike dhe financiare për shlyerjen e këtyre shumave.

Titulli i gjetjes:	Miratimi me VKM i garancive shtetërore jo në përputhje me Ligjin Nr.9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar duke sjell ekspozim të lartë të shtetit kundrejt detyrimeve të mundshme të huamarrësve.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se përgjatë muajve prill – maj 2020, u miratua emetimi i dy garancive shtetërore në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, përkatësisht: -Me VKM Nr.277 datë 06.04.2020 u miratua garancia shtetërore të huasë me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e Këshillit të Ministrave, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar.

Garancia e parë shtetërore u emetua në vlerën 11,000,000 mijë lekë, në favor të 12 bankave të nivelit të dytë.

-Me VKM Nr.387 datë 13.05.2020 u miratua garancia shtetërore e huasë, me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së tregtarëve ose shoqërive tregtare për të mundësuar financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar.

Garancia e dytë shtetërore u emetua në vlerën 15,000,000 mijë lekë, në favor të 12 bankave të nivelit të dytë.

Në të dyja VKM-t u përcaktuan gjithashtu kushtet e kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e tyre me Ligjin Nr. 9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, u konstatuan problematika dhe mospërputhje që kanë rritur riskun e ekspozimit të shtetit shqiptar kundrejt detyrimeve.

Marrëveshjet me Bankat për të dy garancitë sovrane të miratuara me VKM janë jo në përputhje si me Ligjin e Huamarrjes ashtu edhe me përcaktimet në nenet në brendësi të vetë marrëveshjes. Sqarojmë si në vijim:

1. Pika 2, Neni 2, i aneksit të marrëveshjes miratuar me VKM Nr.370 datë 06.05.2020 citon se: Ministria e Financave dhe Ekonomisë krahas garantimit të principalit, merr përsipër të rimbursojë/paguajë interesat e Huave që do të trajtohen në këtë Marrëveshje Garancie.

Ky përcaktim nuk gjen parashikim në Ligjin Nr. 9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Neni 3 “Kuptimi i garancisë shtetërore të huasë” i cili citon se “Garancia shtetërore e huasë është marrëveshja e lidhur me shkrim, e cila përmban rregulla për të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet dhe mënyrat, sipas të cilave **shteti është përgjegjës për detyrimet financiare të një huamarrësi, kur ai nuk arrin t’i paguajë ato në kohën dhe masën e duhur**” dhe neni 34 “Natyra e garancisë shtetërore” i cili citon se “Garancia shtetërore e huasë nuk përbën detyrim të drejtëpërdrejtë për shtetin, por përfshijë një detyrim të mundshëm. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtëpërdrejtë kur përfituesi i drejtëpërdrejtë nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë”.

Për sa më sipër rimbursimi i Interesave të Huasë nga buxheti shtetit, përcaktuar me VKM nuk gjen mbështetje dhe parashikim në Ligjin e Huamarrjes shtetërore, pa plotësuar kushtin që përfituesi i drejtëpërdrejtë “të mos arrijë të paguajë”.

Interesat e paguara nga Buxheti i Shtetit jo në përputhje me Ligjin Nr. 9665 datë 18.12.2006 i ndryshuar, deri në datën 31.12.2020 rezultojnë në vlerën prej 47,948 mijë lekë.

2. Neni 2 “Garancia” e Marrëveshjes së Garancisë Sovrane 1, pika 3 dhe Neni 2 “Garancia “Marrëveshja e garancisë Sovrane 2 ”, pika 4 citon **“Në asnjë rast, MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve.**

Këto përcaktime, në të dyja Garancitë Sovrane, **janë jo në përputhje me Ligjin e Huamarrjes, Neni 34 “Natyra e garancisë shtetërore”** i cili citon se “Garancia shtetërore e huasë nuk përbën detyrim të drejtëpërdrejtë për shtetin, por përfaqëson një detyrim të mundshëm. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtëpërdrejtë kur përfituesi i drejtëpërdrejtë nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë.

Sipas këtij përcaktimi Ligji i Huamarrjes parashikon mospagimin e interesave ose penaliteteve të cilat në fakt janë pjesë të detyrimit, në rast se përfituesi i drejtëpërdrejtë nuk arrin të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë.

3. Neni 2 “Garancia” Marrëveshja e Garancisë së parë, pika 3 e cila citon se “MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve” është jo në përputhje me Nenin 6 “Procedurat për kryerjen e pagesave të garancisë” së po kësaj marrëveshje pika 1 e cila citon “Kur huamarrësi nuk ka mundur të kryej pagesën e detyrimeve në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë...huadhënësi rezervon të drejtën për t’i dërguar MFE-s kërkesën me shkrim për pagesën e detyrimeve dhe pikën 2 e cila citon se “...Kërkesa për pagesë që Huadhënësi do t’i drejtojë MFE-s duhet të përmbajë:

c) Një përshkrim të detajuar të shumës që kërkohet, duke përcaktuar në mënyrë analitike, principalin, interesat e akumuluar, penalitetet, si dhe cdo shpenzim tjetër të kryer në zbatim të marrëveshjes së huasë që është në ngarkim të Huamarrësit, pavarësisht faktit që garancia mbulon vetëm detyrimin e principalit të Huasë.

Për sa më sipër Neni 2 dhe Neni 6 i marrëveshjes së Garancisë Sovrane 1 janë jo në përputhje me njëra tjetrën.

4. Pika 2 e Nenit 2 të VKM Nr.370 datë 06.05.2020, për disa ndryshime në VKM Nr.277 datë 06.04.2020 e cila citon se “MFE krahas garantimit të principalit merr përsipër të rimbursojë Interesat e Huave që do të trajtohen nën këtë marrëveshje Garancie...është jo në përputhje me pikën 3 të Nenit 2 e cila citon se “MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë...”.

5. Neni 2 “Garancia” Marrëveshja e Garancisë Sovrane 2, pika 4 e cila citon se “MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve” është jo në përputhje me Nenin 6 “Procedurat për kryerjen e pagesave të garancisë” së po kësaj marrëveshje pika 1 e cila citon “Kur huamarrësi nuk ka mundur të kryej pagesën e detyrimeve në përputhje me

kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë....huadhënësi rezervon të drejtën për t'i dërguar MFE-s kërkesën me shkrim për pagesën e detyrimeve” dhe pikën 2 e cila citon se “...Kërkesa për pagesë që Huadhënësi do t'i drejtojë MFE-s duhet të përmbajë:

c) Një përshkrim të detajuar të shumës që kërkohet, duke përcaktuar në mënyrë analitike, principalin, interesat e akumuluar, penalitetet, si dhe cdo shpenzim tjetër të kryer në zbatim të marrëveshjes së huasë që është në ngarkim të Huamarrësit, pavarësisht faktit që MFE garanton vetëm principalin në masën 60%.

Për sa më sipër Neni 2 dhe Neni 6 i marrëveshjes së Garancisë Sovrane 2 janë jo në përputhje me njëra tjetrën.

6. Nenet 36, 37, 38, 40 të Ligjit Nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar përcaktojnë kompetenca të plota të MFE për shqyrtimin, vlerësimin dhe dhënien e garancisë shtetërore të huasë si në vijim:

Neni 36 “Shqyrtimi dhe analiza e garancisë”: “...kur dokumentacioni mbështetës i kërkesës për garanci është i plotë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, është i detyruar që Brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, të shpallë vendimin për dhënien e garancisë”.

Neni 37 “Vlerësimi i riskut”: “...analiza ekonomike-financare sipas nenit 36, përfshin një përcaktim të riskut që merr përsipër shteti, në rast se jepet garancia. Ministri i Financave mund të kërkojë asistencën e Bankës së Shqipërisë për të përcaktuar dhe vlerësuar riskun”.

Neni 38 “Dhënia e garancisë shtetërore të huasë”: “...Ministri i Financave dhe Ekonomisë miraton dhënien e garancisë shtetërore të huasë pasi shqyrton dokumentet e mëposhtme:

g) Projekt-marrëveshjen e huasë ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit;

h) Projekt-marrëveshjen e garancisë ndërmjet institucionit huadhënës dhe shtetit;

i) Marrëveshjen e mirëkuptimit, të nënshkruar nga huamarrësi.

Neni 40 “Mbikëqyrja nga Ministria e Financave”...Ministria e Financave kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marr garanci shtetërore të Huasë...”

Ndërkohë Neni 3 i marrëveshjeve të garancive Sovrane 1 dhe 2 “Kriteret e kualifikimit të Huamarrësve”, pika 1 e cila citon se “Huadhënësi do të jap hua të garantuar vetëm huamarrësve që plotësojnë kriteret si në vijim...” **ka një përcaktim të ndryshëm nga Nenet 36-37 të Ligjit Nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar në lidhje me përgjegjësitë lidhur me vendimmarrjen mbi garancitë shtetërore të huasë, pasi ky Nen ia kalon kompetencën Bankave të nivelit të dytë, duke rritur riskun e mosvlerësimit të drejtë ana e bankave të nivelit të dytë të aktivitetit dhe aftësisë pagueuse të subjekteve që kanë aplikuar për kredi, në kushtet e ofrimit të një garancie nga Shteti.**

7. Në lidhje me kthimin e garancisë shtetërore të huasë marrëveshja e garancive sovrane, nenit 7 “Rikuperimi post-pagesës së garancisë” i cili citon se “...nëse pas 2 vitesh nga data e kryerjes së Pagesës së Garancisë,

	<p>Huadhënësi nuk ka mundur të rikuperojë detyrimet e Huamarrësit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron të drejtën që të ndjekë vet procedurat ligjore, është jo në përputhje me Nenin 42 të Ligjit të Huamarrjes i cili citon se “Me kryerjen e pagesës në llogarinë e garancisë shtetërore të huasë institucionit huadhënës, Ministri i Financave merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë...”, pasi ky i fundit nuk parashikon afat kohor, por i jep të drejtën <u>Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për të vepruar vet dhe direkt me qëllim rikuperimin e detyrimeve.</u></p> <p>Për sa më sipër shprehemi se garancitë shtetërore të miratuara me VKM, konstatohen jo në përputhje me Ligjin Nr.9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.</p> <p>Si rezultat jo vetëm janë paguar nga buxheti i shtetit interesa të kredive në bankat e nivelit të dytë jo në përputhje me Ligjin Nr.9665 datë 18.12.2006 i ndryshuar në vlerën prej 47,948 mijë lekë për vitin 2020, por edhe është rritur risku i ekspozimit të shtetit kundrejt detyrimeve të tjera të mundshme.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>-Ligji Nr. 9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”</p> <p>-VKM Nr.277 datë 06.04.2020 “Për miratimin e garancisë shtetërore të huasë me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e Këshillit të Ministrave, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga Covid-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancive dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”</p> <p>-VKM Nr.370 datë 06.05.2020 “Për disa ndryshime në VKM Nr.277 datë 06.04.2020”.</p> <p>-VKM Nr.387 datë 13.05.2020 “Për miratimin e garancisë shtetërore të huasë, me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së tregtarëve ose shoqërive tregtare për të mundësuar financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar të ndikuar nga situatë e krijuar nga Covid-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”.</p> <p>-VKM Nr.480 datë 17.06.2020 “Për disa ndryshime në VKM Nr.387 datë 13.05.2020”.</p> <p>-Marrëveshjet e garancive dhe mirëkuptimit me bankat e nivelit të dytë”.</p>
<p>Ndikimi/Efekti:</p>	<p>-Marrëveshjet me Bankat për të dy garancitë sovraane të miratuara me VKM janë jo në përputhje si me Ligjin e Huamarrjes ashtu edhe me përcaktimet në nenet në brendësi të vetë marrëveshjeve.</p> <p>-Interesat e paguara nga Buxheti i Shtetit deri në datën 31.12.2020 janë në vlerën prej 47,948 mijë lekë, të parashikuara me VKM Nr.370 datë 06.05.2020 por jo në përputhje me Ligji Nr. 9665 datë 18.12.2006.</p> <p>-Ekspozim i lartë i shtetit kundrejt detyrimeve të tjera të mundshme të</p>

	huamarrësve.
Shkaku:	Miratimi i VKM në lidhje me garancitë sovrane 1 dhe 2 jo në përputhje me Ligjin Nr.9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marr masa të menjëhershme për rishikimin e kuadrit ligjor në vijim të vlerësimit të problematikave të konstatuara nga ky auditim me qëllim shmangien e riskut për detyrimet e tjera të mundshme në të ardhmen.

Titulli i gjetjes:	Miratimi me VKM i garancive shtetërore rezulton i pavlerësuar dhe i pamonitoruar nga MFE në lidhje me plotësimin ose jo të kriterëve për përfitimin e garancisë sovrane.
Situata:	<p>Në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, nga qeveria u akorduan gjithsej 26 miliard Lekë në formën e garancive, të cilat deri në fund të vitit 2020 mundësuan kreditimin e shoqërive tregtare me 14.9 miliard Lekë.</p> <p>Garancia e parë shtetërore e miratuar me VKM Nr.277 datë 06.04.2020 u emetua në vlerën 11,000,000 mijë lekë, në favor të 12 bankave të nivelit të dytë. Kredia e miratuar nga bankat e nivelit të dytë kundrejt huamarrësve rezultojnë në vlerën 5,901,304 mijë, nga të cilat deri në 31.12.2020 u disbursuan 5,332,741 mijë lekë. Stoku i detyrimit në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 4,522,952 mijë lekë.</p> <p>Garancia e dytë shtetërore e miratuar me VKM Nr.387 datë 13.05.2020 u emetua në vlerën 15,000,000 mijë lekë, në favor të 12 bankave të nivelit të dytë. Kredia e miratuar nga bankat e nivelit të dytë kundrejt huamarrësve rezultojnë në vlerën 8,950,621 mijë, nga të cilat deri në 31.12.2020 u disbursuan 8,240,103 mijë lekë. Stoku i detyrimit në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 7,629,463 mijë lekë.</p> <p>Deri në fund të vitit 2020 Garancia Sovrane 1 është përdorur në masën prej rreth 54% (vlera e miratimeve kundrejt totalit) ndërsa Garancia Sovrane 2 është përdorur në masën prej 36%, ku kjo e fundit ka vazhduar të përdoret deri në afatin e shtyrë për aplikime 30.06.2021.</p> <p>Me qëllim monitorimin, shqyrtimin dhe raportimin periodikisht pranë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në lidhje me ecurinë e garancive shtetërore me Urdhërin Nr.56 datë 23.04.2020 të Kryeministrit u ngrit Komiteti i Monitorimit.</p> <p>Me Urdhërin Nr.108 prot me nr 7868 datë 06.05.2020 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë u miratua Sekretariatit Teknik dhe rregullorja e funksionimit të Komitetit të monitorimit të ecurisë së garancisë shtetërore të Huasë”.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj nuk disponohen kopje të dosjeve, ekstrakteve, dokumentave, të dhënave të regjistruara dhe të shkresave të të gjitha huave që i nënshtrohen këtyre marrëveshjeve të garancive, kjo jo në përputhje me:

enin 4 pika 9 e marrëveshjes së parë dhe Nenin 4, pika 10 e marrëveshjes së dytë “Huadhënësi do të vendos në dispozicion të MFE, me kërkesë të kësaj të fundit, kopje të dosjeve, dokumentave, rekordeve dhe shkresave të të gjitha huave që i nënshtrohen këtyre garancive”.

-Nenin 8 pika 1 marrëveshjes së garancive sovrane 1 dhe 2 “Huadhënësi do të raportojë do të raportojë në formë elektronike pranë MFE...duke përcjellë dhe kopje të dokumentave shoqëruese që vërtetojnë kriteret e kualifikimit të Huamarrësve.

-Nenin 35 të Ligjit të Huamarrjes “...cdo huamarrës në bazë të këtij ligji paraqet një kërkesë me shkrim, e cila shoqërohet me dokumentacionin ekonomik dhe financiar për t’i mundësuar Ministrin të Financave të vlerësojë kushtet financiare dhe aftësinë e pagimit nga huamarrësi”.

➤ Pikën 6.1 e Rregullores së Funkcionimit të Komitetit të Monitorimit, Kreun 7 “Monitorimi dhe Auditimi i garancive shtetërore”, miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, e cila citon se **“Garantuesi nëpërmjet Komitetit/ nuk është i detyruar të monitorojë ose verifikojë, dhe nuk do të jetë përgjegjës për monitorimin ose verifikimin e kriterëve dhe përdorimin e shumave nga Huadhënësi për klientët...”** është jo në përputhje me:

- Pikën 1 të Urdhërit të Kryeministrit Nr.56 datë 23.04.2020 “Për ngritjen e Komitetit të Monitorimit”... “urdhëroj ngritjen e Komitetit të Monitorimit, i cili do të monitorojë, shqyrtojë dhe do të raportojë periodikisht pranë Ministrin të Financave...si dhe për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”.

- Pikën 8 të marrëveshjeve të garancive sovrane, miratuar me VKM: “Struktura e posacme ndërinstucionale...do të miratojë, shqyrtojë dhe raportojë ...”

- **Nenet 36, 37, 38 të Ligjit Nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar, të cilat përcaktojnë kompetenca të plota të MFE për shqyrtimin, vlerësimin dhe dhënien e garancisë shtetërore të huasë.**

➤ Në lidhje me pikën 1 “miratimi i linjës së garancisë shtetërore 1, në favor të bankave të nivelit të dytë, pjesë e skemës së garancisë që do të mundësojë huadhënien për të përballuar pagat e tregtarëve ose të shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është mbyllur ose është ndikuar me ulje të xhiros...dhe Nenin 3, garancisë shtetërore 2 “Kriteret e kualifikimit të huamarrësve dhe kriteret për përfitimin e huasë” pika b) huamarrësi mund të jetë subjekt që ushtron veprimtarinë tregtare në të gjithë sektorët e ekonomisë, me kusht që veprimtaria e tij tregtare të jetë prekur direkt ose indirekt nga aktet ligjore dhe nënligjore të qeverisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, nëpërmjet mbylljes së përkohshme të akvitetit tregtar ose nëpërmjet ndikimit me ulje të akvitetit tregtar, mungon gjurma e auditimit për të verifikuar plotësimin e tyre si kriter, duke qënë se vendimmarrja dhe kompetenca i është lënë bankave të nivelit të dytë.

➤ Janë konstatuar subjekte që kanë përfituar nga kredia në më shumë se 1 bankë, si rrjedhojë edhe nga Garancia Sovrane 1 jo në përputhje me

	<p>pikën 7 të nenit 4 “Detyrimet e Huadhënësit” të VKM Nr.277 datë 06.04.2020, e cila përcakton se: “Në rast se huamarrësi ka marr një hua për këtë program nga banka të tjera, cdo hua tjetër për paga nuk do të jetë subjekt i kësaj marrëveshje”.</p> <p>31.12.2020 shteti shqiptar rezulton garantor i të njëjtit subjekt huamarrës në 2 ose 3 banka të ndryshme në vlerën e stokut prej 733,760 mijë lekë.</p> <p>Analiza e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është argumentuar se financimi, si rrjedhojë edhe garancia rezulton në disa banka pasi dhe vet punonjësit e subjekteve janë pagamarrës në banka të ndryshme. Pavarësisht këtij argumenti, kjo mbetet jo në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes së garancisë sovrane 1, miratuar me VKM.</p> <p>Në 31.12.2020 shteti shqiptar rezulton garantues i vlerës totale prej 9,100,629 mijë lekë.</p> <p>Për sa më sipër shprehemi se mungesa e vlerësimit dhe monitorimit të garancive nga MFE në lidhje me plotësimin ose jo të kriterëve për përfitimin e garancisë sovrane kanë rritur riskun e ekspozimit të shtetit kundrejt detyrimeve të tjera të mundshme në të ardhmen dhe riskun e rritjes së borxhit publik.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>-Ligji Nr. 9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”</p> <p>-VKM Nr.277 datë 06.04.2020 “Për miratimin e garancisë shtetërore të huasë me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e Këshillit të Ministrave, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga Covid-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancive dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”</p> <p>-Urdhëri Nr.56 datë 23.04.2020 “Për ngritjen e Komitetit të ecurisë së garancive shtetërore të huasë me bankat e nivelit të dytë, për pagat e tregtarëve ose të shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e Këshillit të Ministrave, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga Covid-19.</p> <p>-Urdhëri Nr.108 datë 06.05.2020 “Për miratimin e Sekretariatit Teknik dhe rregullores së funksionimit të Komitetit të Monitorimit të ecurisë së garancisë shtetërore të huasë, me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e Këshillit të Ministrave, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga Covid-19”.</p> <p>-VKM Nr.370 datë 06.05.2020 “Për disa ndryshime në VKM Nr.277 datë 06.04.2020”.</p> <p>-VKM Nr.387 datë 13.05.2020 “Për miratimin e garancisë shtetërore të huasë, me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së tregtarëve ose shoqërive tregtare për të mundësuar financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar të ndikuar nga situatë e krijuar nga Covid-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”.</p> <p>-VKM Nr.480 datë 17.06.2020 “Për disa ndryshime në VKM Nr.387 datë</p>

	<p>13.05.2020”.</p> <p>-Urdhëri Nr.92 datë 10.07.2020 “Disa ndryshime dhe shtesa në Urdhërin Nr.56 datë 23.04.2020.</p> <p>-Urdhëri Nr.153 datë 19.11.2020 “Disa ndryshime dhe shtesa në Urdhërin Nr.56 datë 23.04.2020.</p> <p>-Marrëveshjet e garancive dhe mirëkuptimit me bankat e nivelit të dytë”.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>-Risk të lartë duke qënë se nga ana e bankave të nivelit të dytë ekziston mundësia e mosvlerësimit të drejtë të aktivitetit dhe aftësisë paguese të subjekteve që kanë aplikuar për kredi, në kushtet e ofrimit të një garancie nga Shteti.</p> <p>-Ekspozim i lartë i shtetit kundrejt detyrimeve të tjera të mundshme të huamarrësve të cilat rezultojnë të pavlerësuara dhe të pamonitoruara nga MFE në lidhje me plotësimin ose jo të kriterëve për përfitimin e garancisë sovrane.</p> <p>-Në 31.12.2020 shteti shqiptar rezulton garantor për vlerën total 9,100,629 mijë lekë si në vijim.</p>
Shkaku:	<p>Miratimi i VKM në lidhje me garancitë sovrane 1 dhe 2 jo në përputhje me Ligjin Nr.9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”.</p>
Rëndësia:	<p>E Lartë</p>
Rekomandime:	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marr masa të menjëhershme për ngritjen e një grup pune me qëllim verifikimin e plotësimit të kriterëve për përfitimin e garancive sovrane dhe në konkluzion të tij, të marr masa për rishikimin ose ndërprerjen e garancive sovrane nëse konstatohen garanci të përfituara jo në përputhje të plotë me dispozitat ligjore.</p> <p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë të vlerësojë strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj dhe rishikimin e strukturës dhe kompetencave të kësaj Drejtorie me qëllim monitorimin e risqeve të borxhit publik dhe menaxhimin sa më efektiv të garancive sovrane.</p>

Në lidhje me konstatimet e paraqitura më sipër, nga ana e MFE janë paraqitur observacione me shkresën nr.8596/7 datë 27.09.2021 në të cilën është paraqitur që:

“...Nuk jemi dakort me rekomandimin për ngritjen e një grupi pune me qëllim verifikimin e plotësimit të kriterëve për përfitimin e garancive, pasi VKM-t që kanë miratuar këto garanci specifikojnë qartë se verifikimi i plotësimit të kriterëve është detyrë e Bankave dhe kjo pasi MFE nuk disponon strukturat e nevojshme për të mundësuar vlerësimet për një numër të konsiderueshëm përfituesish. Nga ana tjetër ashtu si jemi shprehur edhe në shkresën nr. 8596/5 datë 06.08.2021, kthim përgjigje mbi akt-konstatimin nr.2, pavarësisht emetimit këto marrëveshje nuk janë marrëveshje të pastra garancie, në kuptim të Ligjit nr.9665 datë 18.12.2006. Ato janë një instrument miks, ku ndërthuret roli i Qeverisë si garantues por edhe si i detyruar i drejtëpërdrejtë i lindur nga nevoja imediate për të ndihmuar biznesin në situatën e pandemisë Covid-19.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të observacionit në lidhje me rekomandimin e grupit të auditimit sqarojmë se:

-Në Nenin 1 (baza ligjore) të marrëveshjes citohet shprehimisht: Kjo marrëveshje është hartuar në zbatim të neneve 34-43 të Ligjit Nr.9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Nenet 34-43 të Ligjit të mësipërm, konkretisht nenet 35-36-37-38, i japin kompetencën Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për shqyrtimin, vlerësimin e riskut dhe miratimin e dhënies së garancisë, pas vlerësimit të kushteve të huamarrësit.

Gjithashtu në Rregulloren e Funkionimit të Komitetit të Monitorimit të ecurisë së garancive shtetërore të huasë, miratuar me nr.7868 prot datë 06.05.2020, pika 6 “Monitorimi dhe Auditimi” nëncështja 6.2 citon “Për të mundësuar monitorimin, kontrollin, dhe auditimin e përdorimit të saktë të Garancisë dhe pajtueshmërisë me dispozitat e kësaj marrëveshje, Garantuesi mund të kërkojë në cdo moment ndërmarrjen e kontroleve/auditimeve nga strukturat përkatëse sipas ligjit pas miratimit nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Gjithashtu në Nenin 13 “Përfundimi dhe pezullimi i Marrëveshjes”, pika 2/a citon: MFE mund të pezullojë Marrëveshjen e Garancisë, në cdo kohë, duke njoftuar me shkrim huadhënësin në rast të ndodhjes së ndonjë prej ngjarjeve të mëposhtme: ...në rast se MFE vërteton se Huadhënësi ka kryer një shkelje të kësaj marrëveshje...Në lidhje me pamundësinë e kapaciteteve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për kryerjen e këtij procesi, është lënë rekomandimi për “Vlerësimin e ngarkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj dhe rishikimin e strukturës - kompetencave të kësaj Drejtorie me qëllim monitorimin e risqeve të borxhit publik dhe menaxhimit sa më efektiv të garancive sovrane”.

Për sa trajtuar edhe në material në lidhje me risqet e mundshme për ekspozimin e shtetit kundrejt detyrimeve të mundshme në të ardhmen, grupi i auditimit i qëndron konstatimit dhe rekomandimit në këtë raport përfundimtar auditimi.

2.4. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme. Realizimi i programit (Plan veprimi) dhe raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit prej 6 muaj nga data e njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit, siç është përcaktuar në pikën 2 të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit nr. 512/1, datë 14.05.2021 “Mbi përputhshmërinë në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, u kërkua informacion mbi statusin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në raportin përfundimtar “Mbi Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2018” miratuar me vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë Shtetit nr. 124 datë 10.10.2019, përcjellë me shkresën nr. 344/8 datë 29.10.2020.

Për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Raporti Përfundimtar i KLSH me objekt auditimi 01.01.2019-31.12.2019.
2. Shkresa, materiale, evidenca mbi marrjen e masave për zbatimin e Rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

I. Hartimi i programit (Planit të veprimit), si dhe respektimi i afatit ligjor **prej 20 ditësh** nga data e marrjes së kërkesës për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi

i mëparshëm (gërma “j” e nenit 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014).

- Nga auditimi rezultoi se, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.6369/17, datë 27.11.2020, në vijim të shkresës nr 344/8 datë 29.10.2020 mbi raportin përfundimtar dhe rekomandimet e lëna nga KLSH ka bërë raportimin në KLSH, në tejkalimin të afatit 20 ditor.

Rekomandimi është zbatuar jashtë afatit të përcaktuar.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014).

-Nga auditimi rezultoi se, Ministria e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr. 7861 prot, datë 30.04.2021 “*Dërgim Informacioni në lidhje me realizimin e rekomandimeve të lëna në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj*, në vijim të shkresës nr 344/8 datë 29.10.2020 mbi raportin përfundimtar dhe rekomandimet e lëna nga KLSH ka bërë raportimin në KLSH brenda afatit 6/mujor.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

III. Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se KLSH për përmirësimin e gjendjes ka rekomanduar për zbatim:

- a. 1 propozim për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, i cili rezulton në proces zbatimi.
- b. 7 masa organizative nga të cilat 1 rekomandim është zbatuar plotësisht, 3 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, 2 rekomandime janë në proces zbatimi, dhe 1 rekomandime është i pa pranuar dhe pa zbatuar.
- c. 2 rekomandime për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, të cilat konsiderohen pjesërisht të zbatuara.

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.1- Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për propozimin e ndryshimeve ligjore në ndryshimin e praktikës së pagesës drejt huadhënësves për këstet e garancive jo performuese. Vetdeklarimi i përfituesve të garancisë të jetë objekt miratimi nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përpara kryerjes së pagesës, pasi të jetë autorizuar aksesin në informacion mbi gjendjen e llogarive bankare të subjekteve përfituese të garancisë.

Qëndrimi i subjektit: Rekomandimi pranohet pjesërisht.

Komenti i subjektit: Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në bashkëpunim me drejtorinë juridike ka iniciuar procesin e ndryshimit të ligjit të borxhit. Ndryshimet ligjore në draft-ligjin e hartuar, ndër të tjera përfshijnë edhe një klauzolë që i jep mundësinë MFE të marrë nga bankat informacion mbi gjendjen e llogarive bankare të subjekteve përfituese të garancisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi u konstatua se me Urdhërin Nr.279 prot datë

19.11.2020 “Për hartimin e akteve ligjore në Ligjin nr.9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, është ngritur dhe ka funksionuar grupi i punës për ndryshimet ligjore. Dhe me memon e datës 03.12.2020 është përgatitur memo mbi këto ndryshime/propozime ligjore, por deri në përfundim të auditimit vetdeklarimi i përfituesve të garancisë nuk është objekt miratimi nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përpara kryerjes së pagesës

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1- Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të projektohen treguesit fiskalë nëpërmjet vendosjes së kufijve sasiore në lidhje me këto instrumenta të emetuar. Të gjitha huatë e reja, në formën e mbështetjeve buxhetore të jenë pjesë e planifikimit në seksionin nën deficit si burim financimi dhe në të njëjtën kohë pjesë e tabelës së treguesve fiskalë të konsoliduar. Hartimi i planit të disbursimeve të jetë në parashikime konservatore dhe në të njëjtën kohë të rritet monitorimi në mënyrë që të reflektohen në kohë tendecat rritëse të disbursimeve të pritshme.

Qëndrimi i subjektit: Rekomandimi nuk është pranuar.

Komenti i subjektit: Planifikimi i disbursimeve dhe përfshirja e tyre në Buxhet realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit.

Sa i takon parashikimit të financimit të huaj sipas projekteve me financim të huaj, janë vetë Ministrinë e Linjes dhe Institucionet Buxhetore që parashtrajnë një plan shpenzimi vjetor (që apriori perkon dhe me disbursimin e fondeve nga donatorët). Dhe ky planifikim ndodh në 3 faza të dokumentit të PBA. Gjithashtu theksohet se, kërkesa për rialokim mbetet kompetencë e ML/IB. Kjo shprehet qartë edhe në Udhëzimin për “Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2019”, datë 17.01.2019, pika 25 dhe 26, cituar më poshtë: 25. “Plani i miruar në ligjin e buxhetit për financimet e huaja, është kufiri i cili duhet të respektohet gjatë kryerjes së shpenzimeve. Në rast tejkalimi të planit të shpenzimeve, njësitë e qeverisjes qendrore do të marrin masa për sistemimin e tyre nëpërmjet rialokimeve gjatë vitit dhe gjatë procesit të rishikimit të buxhetit”. 26. “Në rastet kur në marrëveshjen dypalëshe, të nënshkruar për zbatimin e projekteve me financim të huaj, është përcaktuar që disbursimi nga donatori/kreditori do të bëhet pasi të jetë kryer shpenzimi dhe pasi të jetë vlerësuar performanca e projektit, atëherë për kryerjen e shpenzimit ministritë/institucionet, në rast se nuk kanë parashikuar fondet përkatëse në planin e buxhetit vjetor, do të shqyrtojnë mundësinë e një rialokimi për të siguruar fondet e nevojshme”. Për sa i takon kompetencave të DMIP dhe bazuar në VKM nr. 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”, Aneksi 2, raportet e monitorimit shërbejnë si bazë për rishikimet buxhetore. Konkretisht në rastet kur konstatohen tejkalime të planit të projekteve me financim të huaj, kjo evidentohet në raportet e monitorimit me qëllim që të merren masa për plotësimin e planit të këtyre projekteve gjatë procesit të rishikimit të buxhetit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

2.1- Rekomandimi: Nga ana e MFE të kryhen veprimet e rregulluese duke e raportuar stokun e borxhit publik me përfshirjen e bonos përkatëse 6-mujore në regjistrin e borxhit dhe treguesit e borxhit publik. Të rishikohet marrëveshja me Bankën e Shqipërisë në mënyrë që të parashikohet detyrimi për paraqitjen e kërkesës për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit përpara hartimit të ligjit të buxhetit vjetor.

Qëndrimi i subjektit: Rekomandimi pranohet pjesërisht.

Komenti i subjektit: U ripublikuan Treguesit e Borxhit dhe Regjistri i Borxhit për tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2019, për të reflektuar efektin e emetimit më 14.06.2019 të letrës me vlerë për mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë nga rivlerësimi i rezervës valutore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi u konstatua se janë ripublikuar treguesit e borxhit për tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2019, me qëllim reflektimin e efektit të emetimit të letrës me vlerë për mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë nga rivlerësimi i rezervës valutore, por deri në përfundim të auditimit nuk është rishikuar marrëveshja me Bankën e Shqipërisë në mënyrë që të parashikohet detyrimi për paraqitjen e kërkesës për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit përpara hartimit të ligjit të buxhetit vjetor.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

3.1- Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrin masa për përditësimin e Rregullores së brendshme, në përputhje të plotë me strukturën aktuale të saj dhe miratimin e Kodit të Etikës me qëllim shmangien e konflikteve të interesit, apo problematikave në lidhje me kompetencat dhe realizimin apo mosrealizimin e detyrave të punës të cilat mund të sjellin hapsira konfliktuale dhe paqartësie gjatë trajtimit dhe menaxhimit të tyre.

Qëndrimi i subjektit: Rekomandim i pranuar.

Komenti i subjektit: Rrregullorja u përditësua dhe miratua me Urdhërin Nr. 52 datë 10.03.2021.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

3.2- Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për plotësimin e pozicioneve vakante me staf të kualifikuar, përgatitjen e programeve të trajnimeve me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale për të gjithë punonjësit.

Qëndrimi i subjektit: Rekomandim i pranuar pjesërisht.

Komenti i subjektit: MFE ka marrë masa për plotësimin e pozicioneve vakante me staf të kualifikuar sipas kriterëve të shpallura ligjore.

Gjithashtu, programet e trajnimeve me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale janë pjesë integrale e vlerësimit periodik të stafit të MFE.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi duke qënë se edhe gjatë vitit 2020 janë konstatuar vende vakante.

3.3- Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë t'i kushtojë një vëmendje të vecantë monitorimit të sistemeve të kontrollit, lidhur me funksionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj.

Qëndrimi i subjektit: Rekomandim i pranuar pjesërisht.

Komenti i subjektit: Janë plotësuar vendet vakante të nivelit të mesëm drejtues brenda Drejtorisë së Përgjithshme, gjë që kontribuon në minimizimin e risqeve të sistemit të kontrollit, dhe janë duke u plotësuar gjithashtu vendet vakante të nivelit të ulët drejtues. Plotësimi i mëtejshëm i gjithë vendeve vakante me staf të kualifikuar do të përmirësojë më tej sistemin e kontrollit të drejtorisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi duke qënë se edhe gjatë vitit 2020 janë konstatuar vende vakante.

4.1- Rekomandimi: Strukturat drejtuese në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masa për:

-Për plotësimin e pozicioneve vakante me staf të kualifikuar dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara të vendit të punës.

-Përgatitjen e programeve të trajnimeve ku të përfshihet të gjithë punonjësit me qëllim rritjen e

kapaciteteve profesionale.

-Plotësimin e vlerësimeve të punës sipas gjithë elementëve të vet formal brenda afateve të përcaktuara.

Qëndrimi i subjektit: Rekomandimi pranohet pjesërisht.

Komenti i subjektit: MFE ka marrë masa për plotësimin e pozicioneve vakante me staf të kualifikuar sipas kriterëve të shpallura ligjore. Gjithashtu, programet e trajnimeve me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale janë pjesë integrale e vlerësimit periodik të stafit të MFE.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Problematikat me vendet vakante evidentohen edhe gjatë vitit 2020 por merret në konsideratë edhe periudha e vështirë e pandemisë.

Rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

5.1- Rekomandimi: Strukturat drejtuese në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik t'i kushtojë një vëmendje të vecantë monitorimit të sistemeve të Kontrollit, me qëllim mbikëqyrjen gjatë realizimit të funksioneve të Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj, duke patur në konsideratë dhe realizimin e kontrolleve nga Auditimi i Brendshëm i Institucionit.

Qëndrimi i subjektit: Rekomandimi pranohet pjesërisht.

Komenti i subjektit: Janë plotësuar vendet vakante të nivelit të mesëm drejtues brenda Drejtorisë së Përgjithshme, gjë që kontribuon në minimizimin e risqeve të sistemit të kontrollit, dhe janë duke u plotësuar gjithashtu vendet vakante të nivelit të ulët drejtues. Plotësimi i mëtejshëm i gjithë vendeve vakante me staf të kualifikuar do të përmirësojë më tej sistemin e kontrollit të drejtorisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi auditimit gjykon se është e nevojshme realizimi i auditimeve të brendshme në këtë drejtori me qëllim garantimin dhe vlerësimin e funksionimit dhe mbarëvajtjes së punës. Kjo Drejtori nuk ka qënë objekt auditimi as për vitin 2020.

Rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

C.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1- Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa të menjëhershme për rikuperimin e të drejtave për të arkëtuar nëpërmjet ushtrimit të instrumentave ligjore që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuasë apo rikompozimin e këtyre marrëveshjeve për tju përshtatur kushteve aktuale të secilit projekt.

Qëndrimi i subjektit: Rekomandimi pranohet pjesërisht.

Komenti i subjektit: Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në bashkëpunim me drejtorinë juridike ka iniciuar procesin e ndryshimit të ligjit të borxhit. Ndryshimet ligjore në draft-ligjin e hartuar, ndër të tjera përfshijnë dhe klauzolën sipas të cilës "Në rast se huamarrësit nuk kthejnë fondet e marra hua, Ministri përgjegjës për financat me urdhër kërkon shlyerjen e tyre. Urdhëri i ministrit përbën titull ekzekutiv", mekanizëm ky i cili do të mundësojë rikuperimin e të drejtave të MFE që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuave.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi u konstatua se me Urdhërin Nr.279 prot datë 19.11.2020 "Për hartimin e akteve ligjore në Ligjin nr.9665 datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë", është ngritur dhe ka funksionuar grupi i punës për ndryshimet ligjore. Dhe me memon e datës 03.12.2020 është pregatitur memo mbi këto ndryshime/propozime ligjore.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i zbatuar pjesërisht duke qënë se kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë vitit 2020.

2.1- Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të rishikojë kuadrin ligjor për shtimin e instrumentave me qëllim administrimin efikas të riskut të garancive. Në vijim të ushtrrojë të gjitha mjetet ligjore për arkëtimin e të drejtave për pagesa të kryera për garancitë e arkëtuara dhe në të njëjtën kohë të ushtrrojë kontroll mbi planet ekonomike dhe financiare për shlyerjen e këtyre shumave.

Qëndrimi i subjektit: Rekomandimi pranohet pjesërisht.

Komenti i subjektit: Drejtoria e Borxhit ka iniciuar dhe propozuar ndryshimet përkatëse në kuadrin ligjor që do të mundësojë ushtrimin e mjeteve ligjore për arkëtimin e të drejtave për pagesa të kryera për garancitë e arkëtuara.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi u konstatua se me Urdhërin Nr.279 prot datë 19.11.2020 “Për hartimin e akteve ligjore në Ligjin nr.9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, është ngritur dhe ka funksionuar grupi i punës për ndryshimet ligjore. Dhe me memon e datës 03.12.2020 është përgatitur memo mbi këto ndryshime/propozime ligjore.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i zbatuar pjesërisht duke qënë se kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë vitit 2020.

Titulli i gjetjes:	Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm
Situata:	Nga auditimi i ushtruar në <i>Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj</i> , në vijim të shkresës nr 344/8 datë 29.10.2020, janë lënë nga KLSH për zbatim 10 rekomandime, ku janë pranuar nga titullari 9 rekomandime, ose 90% e tyre. Nga rekomandimet e pranuar: A- Për propozim për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi është rekomanduar 1 masë e cila është në proces zbatimi. B- Për përmirësimin e gjëndjes janë rekomanduar 7 masa organizative, ku 6 janë pranuar nga të cilat 1 rekomandim është zbatuar plotësisht, 3 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, 2 rekomandime janë në proces zbatimi C- Për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, janë rekomanduar 2 masa të cilat janë të zbatuara pjesërisht.
Kriteri:	Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatim i rekomandimeve të lëna nga auditimi i grupit të KLSH
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Ministria e Financave të rishqyrtojë dhe të analizojë situatën lidhur me rekomandimet e pa realizuara, duke marrë masa të menjëhershme për nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësiive konkrete ligjore për moszbatimin e tyre, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 344/8, datë 29.10.2020.

III. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinioni i Auditimit të Përputhshmërisë (I Kualifikuar)

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, bazuar në

ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinionin, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime materiale por jo të përhapura, jo në përputhje me kriteret e auditimit

Baza për opinionin e auditimit

Problematikat e konstatuara përfshijnë:

- Arkëtimi i të drejtave të Buxhetit të Shtetit nga marrëdhëniet e nënhuasë jo vetëm që nuk realizohet në mënyrë që të mblidhen detyrimet që subjektet kanë krijuar ndër vite, por gjatë periudhës objekt auditimi janë krijuar detyrime të reja në shumën 7,750 milion lekë.
- Garancitë e jashtme paraqesin një risk të shtuar për aktivitetin e subjektit të audituar duke angazhuar pagesa të konsiderueshme nga Buxheti i Shtetit si pasojë e paaftësisë së përfituesve të garancisë për të realizuar shlyerjen e tyre dhe nga ana tjetër këto pagesa të kryera nuk kthehen në Buxhetin e Shtetit, ku vetëm për periudhën objekt auditimi rritja e detyrimeve të garancive vlerësohet në rreth 2,687 milion lekë.
- Gjatë periudhës auditimi nuk është emetuar bono thesari 6-mujore për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë në shumën 6,243 milion lekë.
- Miratimi me VKM Nr.277 datë 06.04.2020 dhe VKM Nr.387 datë 13.05.2020 i garancive shtetërore jo në përputhje me Ligjin Nr.9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar duke sjellë ekspozim të lartë të shtetit kundrejt detyrimeve të mundshme të huamarrësve të cilat rezultojnë të pavlerësuar dhe të pamonitoruara nga MFE në lidhje me plotësimin ose jo të kriterëve për përfitimin e garancisë sovrane.
- Marrëveshjet e garancisë nuk parashikojnë marrjen e masave nga kreditori për arkëtimin e detyrimeve nga huamarrësi i drejtpërdrejtë. Përkundrazi, ato parashikojnë që Garantuesi (Qeveria e RSH) do të paguajë kreditorin menjëherë dhe pa kushte, në rastet kur huamarrësi nuk përmbush detyrimet e tij.

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Drejtimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për planifikimin, realizimin dhe raportimin e aktivitetit të huamarrjes vjetore dhe treguesve të borxhit publik.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e MFE është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit..

Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne: Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm.

Krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke patur si qëllim kryesor dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutine të raportimit të treguesve fiskalë janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë ne lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion u konsiderua i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të

grumbulluara, akt-konstatimeve të mbajtura si dhe observacioneve të paraqitura për këto akte u përgatit Raporti i Auditimit.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se përgjatë muajve prill – maj 2020, u miratua emetimi i dy garancive shtetërore në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, përkatësisht:

-Me VKM Nr.277 datë 06.04.2020 u miratua garancia shtetërore të huasë me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e Këshillit të Ministrave, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar.

Garancia e parë shtetërore u emetua në vlerën 11,000,000 mijë lekë, në favor të 12 bankave të nivelit të dytë.

-Me VKM Nr.387 datë 13.05.2020 u miratua garancia shtetërore e huasë, me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së tregtarëve ose shoqërive tregtare për të mundësuar financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar.

Garancia e dytë shtetërore u emetua në vlerën 15,000,000 mijë lekë, në favor të 12 bankave të nivelit të dytë. Në të dyja VKM-t u përcaktuan gjithashtu kushtet e kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e tyre me Ligjin Nr. 9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, u konstatuan problematika dhe mospërputhje që kanë rritur riskun e ekspozimit të shtetit shqiptar kundrejt detyrimeve të reja. **Marrëveshjet me Bankat për të dy garancitë sovrane të miratuara me VKM janë jo në përputhje si me Ligjin e Huamarrjes ashtu edhe me përcaktimet në nenet në brendësi të vetë marrëveshjes.** Konkretisht në vijim:

8. Pika 2, Neni 2, i aneksit të marrëveshjes miratuar me VKM Nr.370 datë 06.05.2020 citon se: “Ministria e Financave dhe Ekonomisë krahas garantimit të principalit, merr përsipër të rimburojë/paguajë interesat e Huave që do të trajtohen në këtë Marrëveshje Garancie”. Ky përcaktim nuk gjen parashikim në Ligjin Nr. 9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Neni 3 “Kuptimi i garancisë shtetërore të huasë” i cili citon se “Garancia shtetërore e huasë është marrëveshja e lidhur me shkrim, e cila përmban rregulla për të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet dhe mënyrat, sipas të cilave shteti është përgjegjës për detyrimet financiare të një huamarrësi, kur ai nuk arrin t’i paguajë ato në kohën dhe masën e duhur” dhe neni 34 “Natyra e garancisë shtetërore” i cili citon se “Garancia shtetërore e huasë nuk përbën detyrim të drejtëpërdrejtë për shtetin, por përfshijë një detyrim të mundshëm. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtëpërdrejtë kur përfituesi i drejtëpërdrejtë nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë”.

Për sa më sipër rimbursimi i Interesave të Huasë nga buxheti shtetit, përcaktuar me VKM nuk gjen mbështetje dhe parashikim në Ligjin e Huamarrjes shtetërore, pa plotësuar kushtin që përfituesi i drejtëpërdrejtë “të mos arrijë të paguajë”. Interesat e paguara nga Buxheti i Shtetit jo në përputhje me Ligjin Nr. 9665 datë 18.12.2006 i ndryshuar, deri në datën 31.12.2020 rezultojnë në vlerën prej 47,948 mijë lekë.

9. Neni 2 “Garancia” e Marrëveshjes së Garancisë Sovrane 1, pika 3 dhe Neni 2 “Garancia

“Marrëveshja e garancisë Sovrane 2”, pika 4 citon “Në asnjë rast, MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve”. Këto përcaktime, në të dyja Garancitë Sovrane, janë jo në përputhje me Ligjin e Huamarrjes, Neni 34 “Natyra e garancisë shtetërore” i cili citon se “Garancia shtetërore e huasë nuk përbën detyrim të drejtëpërdrejtë për shtetin, por përfaqëson një detyrim të mundshëm. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtëpërdrejtë kur përfituesi i drejtëpërdrejtë nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë”. **Sipas këtij përcaktimi Ligji i Huamarrjes parashikon mospagimin e interesave ose penaliteteve të cilat në fakt janë pjesë të detyrimit**, në rast se përfituesi i drejtëpërdrejtë nuk arrin të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë.

Neni 2 “Garancia” Marrëveshja e Garancisë së parë, pika 3 e cila citon se “MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve” është jo në përputhje me Nenin 6 “Procedurat për kryerjen e pagesave të garancisë” së po kësaj marrëveshje pika 1 e cila citon “Kur huamarrësi nuk ka mundur të kryej pagesën e detyrimeve në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë....huadhënësi rezervon të drejtën për t’i dërguar MFE-s kërkesën me shkrim për pagesën e detyrimeve dhe pikën 2 e cila citon se “...Kërkesa për pagesë që Huadhënësi do t’i drejtojë MFE-s duhet të përmbajë: Një përshkrim të detajuar të shumës që kërkohet, duke përcaktuar në mënyrë analitike, principalin, interesat e akumuluar, penalitetet, si dhe cdo shpenzim tjetër të kryer në zbatim të marrëveshjes së huasë që është në ngarkim të Huamarrësit, pavarësisht faktit që garancia mbulon vetëm detyrimin e principalit të Huasë.

Për sa më sipër Neni 2 dhe Neni 6 i marrëveshjes së Garancisë Sovrane 1 janë jo në përputhje me njëra tjetrën.

10. Pika 2 e Nenit 2 të VKM Nr.370 datë 06.05.2020, për disa ndryshime në VKM Nr.277 datë 06.04.2020 e cila citon se “MFE krahas garantimit të principalit merr përsipër të rimbursojë Interesat e Huave që do të trajtohen nën këtë marrëveshje Garancie...është jo në përputhje me pikën 3 të Nenit 2 e cila citon se “MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë...”.

Neni 2 “Garancia” Marrëveshja e Garancisë Sovrane 2, pika 4 e cila citon se “MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve” është jo në përputhje me Nenin 6 “Procedurat për kryerjen e pagesave të garancisë” së po kësaj marrëveshje pika 1 e cila citon “Kur huamarrësi nuk ka mundur të kryej pagesën e detyrimeve në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë....huadhënësi rezervon të drejtën për t’i dërguar MFE-s kërkesën me shkrim për pagesën e detyrimeve” dhe pikën 2 e cila citon se “...Kërkesa për pagesë që Huadhënësi do t’i drejtojë MFE-s duhet të përmbajë: Një përshkrim të detajuar të shumës që kërkohet, duke përcaktuar në mënyrë analitike, principalin, interesat e akumuluar, penalitetet, si dhe cdo shpenzim tjetër të kryer në zbatim të marrëveshjes së huasë që është në ngarkim të Huamarrësit, pavarësisht faktit që MFE garanton vetëm principalin në masën 60%.

Për sa më sipër Neni 2 dhe Neni 6 i marrëveshjes së Garancisë Sovrane 2 janë jo në përputhje me njëra tjetrën.

11. Nenet 36, 37, 38, 40 të Ligjit Nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar përcaktojnë kompetenca të plota të MFE për shqyrtimin, vlerësimin dhe dhënien e garancisë shtetërore të huasë si në vijim:

Neni 36 “Shqyrtimi dhe analiza e garancisë”: “...kur dokumentacioni mbështetës i kërkesës për

garanci është i plotë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, është i detyruar që Brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, të shpallë vendimin për dhënien e garancisë”; **Neni 37** “Vlerësimi i riskut”: “...analiza ekonomike-financare sipas nenit 36, përfshin një përcaktim të riskut që merr përsipër shteti, në rast se jepet garancia. Ministri i Financave mund të kërkojë asistencën e Bankës së Shqipërisë për të përcaktuar dhe vlerësuar riskun”; **Neni 38** “Dhënia e garancisë shtetërore të huasë”: “...Ministri i Financave dhe Ekonomisë miraton dhënien e garancisë shtetërore të huasë pasi shqyrton dokumentet e mëposhtme: a) Projekt-marrëveshjen e huasë ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit; b) Projektmarrëveshjen e garancisë ndërmjet institucionit huadhënës dhe shtetit; c) Marrëveshjen e mirëkuptimit, të nënshkruar nga huamarrësi. **Neni 40** “Mbikëqyrja nga Ministria e Financave”...Ministria e Financave kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marr garanci shtetërore të Huasë...”. Ndërkohë Neni 3 i marrëveshjeve të garancive Sovrane 1 dhe 2 “Kriteret e kualifikimit të Huamarrësve”, pika 1 e cila citon se “Huadhënësi do të jap hua të garantuar vetëm huamarrësve që plotësojnë kriteret si në vijim...” **ka një përcaktim të ndryshëm nga** Nenet 36-37 të Ligjit Nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar në lidhje me përgjegjësitë lidhur me vendimmarrjen mbi garancitë shtetërore të huasë, pasi ky nen ia kalon kompetencën Bankave të nivelit të dytë, duke rritur riskun e mosvlerësimit të drejtë ana e bankave të nivelit të dytë të aktivitetit dhe aftësisë paguese të subjekteve që kanë aplikuar për kredi, në kushtet e ofrimit të një garancie nga Shteti.

12. Në lidhje me kthimin e garancisë shtetërore të huasë marrëveshja e garancive sovrane, nenit “Rikuperimi post-pagesës së garancisë” i cili citon se “...nëse pas 2 vitesh nga data e kryerjes së Pagesës së Garancisë, Huadhënësi nuk ka mundur të rikuperojë detyrimet e Huamarrësit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron të drejtën që të ndjekë vet procedurat ligjore”, është jo në përputhje me Nenin 42 të Ligjit të Huamarrjes i cili citon se “Me kryerjen e pagesës në llogarinë e garancisë shtetërore të huasë institucionit huadhënës, Ministri i Financave merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë...”, pasi ky i fundit nuk parashikon afat kohor, por i jep të drejtën Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për të vepruar vet dhe direkt me qëllim rikuperimin e detyrimeve.

Për sa më sipër shprehemi se garancitë shtetërore të miratuara me VKM, konstatohen jo në përputhje me Ligjin Nr.9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. **Si rezultat jo vetëm janë paguar nga buxheti i shtetit interesa të kredive në bankat e nivelit të dytë jo në përputhje me Ligjin Nr.9665 datë 18.12.2006 i ndryshuar në vlerën prej 47,948 mijë lekë për vitin 2020, por edhe është rritur risku i ekspozimit të shtetit kundrejt detyrimeve të tjera të mundshme. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 nga faqe 40-80 të Raportit të Auditimit)**

1.1- Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marr masa të menjëhershme për rishikimin e kuadrit ligjor në vijim të vlerësimit të problematikave të konstatuara nga ky auditim me qëllim shmangien e riskut për detyrimet e tjera të mundshme në të ardhmen.

Brenda vitit 2021

B. MASA ORGANIZATIVE

1.-Gjetje nga auditimi: Në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, nga qeveria u akorduan gjithsej 26 miliard Lekë në formën e garancive, të cilat deri në fund të vitit 2020 mundësuan kreditimin e shoqërive tregtare me 14.9 miliard Lekë.

Garancia e parë shtetërore e miratuar me VKM Nr.277 datë 06.04.2020 u emetua në vlerën

11,000,000 mijë lekë, në favor të 12 bankave të nivelit të dytë. Kredia e miratuar nga bankat e nivelit të dytë kundrejt huamarrësve rezultojnë në vlerën 5,901,304 mijë, nga të cilat deri në 31.12.2020 u disbursuan 5,332,741 mijë lekë. Stoku i detyrimit në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 4,522,952 mijë lekë.

Garancia e dytë shtetërore e miratuar me VKM Nr.387 datë 13.05.2020 u emetua në vlerën 15,000,000 mijë lekë, në favor të 12 bankave të nivelit të dytë. Kredia e miratuar nga bankat e nivelit të dytë kundrejt huamarrësve rezultojnë në vlerën 8,950,621 mijë, nga të cilat deri në 31.12.2020 u disbursuan 8,240,103 mijë lekë. Stoku i detyrimit në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 7,629,463 mijë lekë.

Deri në fund të vitit 2020 Garancia Sovrane 1 është përdorur në masën prej rreth 54% (vlera e miratimeve kundrejt totalit) ndërsa Garancia Sovrane 2 është përdorur në masën prej 36%, ku kjo e fundit ka vazhduar të përdoret deri në afatin e shtyrë për aplikime 30.06.2021.

Me qëllim monitorimin, shqyrtimin dhe raportimin periodikisht pranë Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë në lidhje me ecurinë e garancive shtetërore me Urdhërin Nr.56 datë 23.04.2020 të Kryeministrit u ngrit Komiteti i Monitorimit. Me Urdhërin Nr.108 prot., me nr 7868 datë 06.05.2020 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë u miratua Sekretariati Teknik dhe rregullorja e funksionimit të Komitetit të monitorimit të ecurisë së garancisë shtetërore të Huasë”.

Nga auditimi u konstatua se:

- Në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj nuk disponohen kopje të dosjeve, ekstrakteve, dokumentave, të dhënave të regjistruara dhe të shkresave të të gjitha huave që i nënshtrohen këtyre marrëveshjeve të garancive, kjo jo në përputhje me:
 - Nenin 4 pika 9 e marrëveshjes së parë dhe Nenin 4, pika 10 e marrëveshjes së dytë cituar: *“Huadhënësi do të vendos në dispozicion të MFE, me kërkesë të kësaj të fundit, kopje të dosjeve, dokumentave, rekordeve dhe shkresave të të gjitha huave që i nënshtrohen këtyre garancive”.*
 - Nenin 8 pika 1 marrëveshjes së garancive sovrane 1 dhe 2 *“Huadhënësi do të raportojë do të raportojë në formë elektronike pranë MFE...duke përcjellë dhe kopje të dokumentave shoqëruese që vërtetojnë kriteret e kualifikimit të Huamarrësve.* -Nenin 35 të Ligjit të Huamarrjes *“...cdo huamarrës në bazë të këtij ligji paraqet një kërkesë me shkrim, e cila shoqërohet me dokumentacionin ekonomik dhe financiar për t’i mundësuar Ministrinë të Financave të vlerësojë kushtet financiare dhe aftësinë e pagimit nga huamarrësi”.*
- **Pikën 6.1 e Rregullores së Funksionimit të Komitetit të Monitorimit, Kreun 7** *“Monitorimi dhe Auditimi i garancive shtetërore”, miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, e cila citon se “Garantuesi nëpërmjet Komitetit/ nuk është i detyruar të monitorojë ose verifikojë, dhe nuk do të jetë përgjegjës për monitorimin ose verifikimin e kriterëve dhe përdorimin e shumave nga Huadhënësi për klientët...”* është jo në përputhje me:
 - *Pikën 1 të Urdhrit të Kryeministrit Nr.56 datë 23.04.2020 “Për ngritjen e Komitetit të Monitorimit”...* *“urdhëroj ngritjen e Komitetit të Monitorimit, i cili do të monitorojë, shqyrtojë dhe do të raportojë periodikisht pranë Ministrisë të Financave...si dhe për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”.*
 - *Pikën 8 të marrëveshjeve të garancive sovrane, miratuar me VKM: “Struktura e posacme ndërinstitucionale...do të miratojë, shqyrtojë dhe raportojë ...”*
 - *Nenet 36, 37, 38 të Ligjit Nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar, të cilat përcaktojnë kompetenca të plota të MFE për shqyrtimin, vlerësimin dhe dhënien e garancisë shtetërore të huasë.*
- Në lidhje me pikën 1 *“miratimi i linjës së garancisë shtetërore 1, në favor të bankave të nivelit të dytë, pjesë e skemës së garancisë që do të mundësojë huadhënien për të përballuar pagat*

e tregtarëve ose të shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është mbyllur ose është ndikuar me ulje të xhiros...dhe Nenin 3, garancisë shtetërore 2 “Kriteret e kualifikimit të huamarrësve dhe kriteret për përfitimin e huasë” pika b) huamarrësi mund të jetë subjekt që ushtron veprimtarinë tregtare në të gjithë sektorët e ekonomisë, me kusht që veprimtaria e tij tregtare të jetë prekur direkt ose indirekt nga aktet ligjore dhe nënligjore të qeverisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, nëpërmjet mbylljes së përkohshme të akvitetit tregtar ose nëpërmjet ndikimit me ulje të akvitetit tregtar, mungon gjurma e auditimit për të verifikuar plotësimin e tyre si kriter, duke qënë se vendimmarrja dhe kompetenca i është lënë bankave të nivelit të dytë.

➤ Janë konstatuar subjekte që kanë përfituar nga kredia në më shumë se 1 bankë, si rrjedhojë edhe nga Garancia Sovrane 1 jo në përputhje me pikën 7 të nenit 4 “Detyrimet e Huadhënësit” të VKM Nr.277 datë 06.04.2020, e cila përcakton se: “Në rast se huamarrësi ka marr një hua për këtë program nga banka të tjera, cdo hua tjetër për paga nuk do të jetë subjekt i kësaj marrëveshje”.

Në 31.12.2020 shteti shqiptar rezulton garantor i të njëjtit subjekt huamarrës në 2 ose 3 banka të ndryshme në vlerën e stokut prej 733,760 mijë lekë.

Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është argumentuar se financimi, si rrjedhojë edhe garancia rezulton në disa banka pasi dhe vet punonjësit e subjekteve janë pagamarrës në banka të ndryshme. Pavarësisht këtij argumenti, kjo mbetet jo në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes së garancisë sovrane 1, miratuar me VKM.

Në datën 31.12.2020, shteti shqiptar rezulton garantues i vlerës totale prej 9,100,629 mijë lekë. Për sa më sipër shprehemi se mungesa e vlerësimit dhe monitorimit të garancive nga MFE në lidhje me plotësimin ose jo të kriterëve për përfitimin e garancisë sovrane kanë rritur riskun e ekspozimit të shtetit kundrejt detyrimeve të tjera të mundshme në të ardhmen dhe riskun e rritjes së borxhit publik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 nga faqe 40-80 të Raportit të Auditimit)

1.1- Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marr masa të menjëhershme për ngritjen e një grup pune me qëllim verifikimin e plotësimit të kriterëve për përfitimin e garancive sovrane dhe në konkluzion të tij, të marri masa për rishikimin ose ndërprerjen e garancive sovrane nëse konstatohen garanci të përfituara jo në përputhje të plotë me dispozitat ligjore.

1.3- Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të vlerësojë strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj dhe rishikimin e strukturës dhe kompetencave të kësaj Drejtorie me qëllim monitorimin e risqeve të borxhit publik dhe menaxhimin sa më efektiv të garancive sovrane.

2.-Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2020 nuk është emetuar bono thesari 6-mujore për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit në shumën 6,242,963,462 lekë me efekt në nënvlerësimin e stokut të borxhit në fund të vitit 2020. Banka e Shqipërisë me shkresë nr. 742/1 datë 27.04.2020 ka vendosur në dijeni MFE se në përfundim të procesit të auditimit të pasqyrave financiare të BSH llogaria “Rezerva e Rivlerësimit të Valutave” në mbyllje të vitit financiar 2019 ka rezultuar me gjendje negative 6,242,963,462 lekë, për të cilën në zbatim të nenit 64 (b) të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e shqipërisë” të ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 6 të marrëveshjes “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë” ka kërkuar mbulimin e saj me emetim të bonove të thesarit 6-mujore. Nga ana e MFE me shkresë nr. 7241/1 datë 18.06.2020 drejtuar Bankës së Shqipërisë është njoftuar emetimi i letres me vlere në shumën 6,242,963 mije lekë me afat maturimi 6 muaj dhe normë interesi të barabartë me yield mesatar të ponderuar të ankandit të fundit të bonove të thesarit me afat maturimi 6-mujor.

Në vijim, në afatin e maturimit, nga ana e BSH me shkresë nr. 2020/2 datë 18.12.2020 drejtuar MFE, protokolluar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me prot 23754 prot, datë 21.12.2020 është kërkuar rriemetimi i titullit 6-mujor që maturohet në datë 21.12.2020, nëpërmjet rinovimit me çmim blerje të instrumentit me vlerë 6,242,963,462.33 lekë. Kjo shkresë është përcjellë në Drejtorinë e Huamarrjes në datën 28.12.2020.

Nga auditimi konstatohet se në vijim të shkresës nr 2020/2 prot, datë 18.12.2020, referuar marrëveshjes së datës 20.01.2015 nr 716/6 prot, “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë”, Neni 6 *Mbulimi i humbjeve neto nga rivlerësimi*”, Ministria e Financave ka rinovuar emetimin me vlerë në shumën 6,242,963,462 lekë e njëjtë me nivelin e yield-it mesatar të ankandit më të fundit të Bonove të Thesarit me afat maturimi 6 mujor, në momentin e emetimit të letrës me vlerë në datën 11.01.2021, përtej datës së maturimit 21.12.2020. Si konkluzion kjo letër me vlerë nuk është paraqitur në regjistrin e borxhit për vitin 2020, treguesit e borxhit dhe rrjedhimisht stokun e borxhit publik të fundvitit 2020. Në konkluzion, nga auditimi konstatohet se nuk është përmbushur detyrimi për rifinancimin e këtij instrumenti brenda afateve të përcaktuara dhe rrjedhimisht raportimi në regjistrin e borxhit në fundvitin e vitit 2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 nga faqe 40-80 të Raportit të Auditimit)

2.1- Rekomandimi: Nga ana e MFE të kryhen veprimet e rregulluese duke e raportuar stokun e borxhit publik me përfshirjen e bonos përkatëse 6-mujore në regjistrin e borxhit dhe treguesit e borxhit publik. Të rishikohet marrëveshja me Bankën e Shqipërisë në mënyrë që të parashikohet detyrimi për paraqitjen e kërkesës për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit përpara hartimit të ligjit të buxhetit vjetor.

Brenda vitit 2021

3.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se pagesat e principalit dhe interesave për garancitë jo performuese nuk kryhen nga MFE pasi të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme nga ana e institucionit huadhënës për rikuperimin e detyrimit, por vetëm bazuar në vetdeklarimin e përfituesit të garancisë mbi paaftësinë paguese të tij. Nga auditimi është konstatuar se pagesat e kryera nga Buxheti i Shtetit për garancitë e huaja jo-performuese kryhen jo në përputhje me kërkesat e nenit e nenit 42 të ligjit nr. 9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në të cilën citohet se “Kur huamarrësi s'ka mundur të bëjë pagesën/pagesat, në përputhje me kushtet dhe afatet e marrëveshjes së huasë, të përcaktuara për këtë qëllim dhe institucioni huadhënës vërteton se ka marrë të gjitha masat e nevojshme, siç përcaktohet në këtë ligj dhe në marrëveshjen e garancisë, për të marrë në dorëzim pagesën/pagesat e premtuara, institucioni huadhënës i paraqet Ministrit të Financave një kërkesë për pagesë, në përmbushje të së drejtës së tij, sipas garancisë shtetërore të huasë. Ministri i Financave, pasi vëren se kërkesa për pagesë është në përputhje me kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për institucionin huadhënës brenda pesëmbëdhjetë ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës”. Aktualisht konstatohet se procesi konsiston në komunikim paraprak nga MFE me përfituesin e garancisë i cili konfirmon nëse është apo jo në gjendje që të shlyejë këstin e radhës dhe në rast të gjendjes së paaftësisë paguese nga ana e tij procedohet me pagesën nga Buxheti i Shtetit. Një procedurë e tillë, sipas komenteve të përfaqësuesve të Drejtorisë së Borxhit është kryer me qëllim shmangien e kamatëvonesave apo penaliteteve në rast vonese të pagesës si pasojë e procedurës për ndjekjen e paaftësisë paguese deri

në kërkesën e huadhënësit drejt MFE.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 nga faqe 40-80 Raportit të Auditimit)

3.1- Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e Autoritetit Publik dhe të Kompetencës nëpërmjet nga strukturat e borxhit, të ndjek të gjitha rrugët ligjore që të merren masa për hartimin dhe implementimin e procedurave të qarta ligjore me qëllim përcaktimin e një procedurë që parashikon monitorimin proaktiv dhe dinamik dhe konfirmimit të gjendjes financiare dhe aftësisë paguese të subjekteve kredimarrëse (*përmes aksesit të autorizuar në informacion mbi gjendjen e llogarive bankare të subjekteve përfituese të garancisë*), përpara realizimit të pagesës në mbështetje të vështirësisë financiare të deklaruar nga subjektet përfituese.

Brenda vitit 2021

4.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar, u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, me shkresën nr.344/8, datë 29.10.2020, ku nga 10 rekomandime, janë pranuar nga titullari 9 rekomandime, ose 90% e tyre. Nga rekomandimet e pranuar:

D- Për propozim për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi është rekomanduar 1 masë e cila është në proces zbatimi.

E- Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 7 masa organizative, ku 6 janë pranuar nga të cilat 1 rekomandim është zbatuar plotësisht, 3 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, 2 rekomandime janë në proces zbatimi

F- Për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, janë rekomanduar 2 masa të cilat janë të zbatuara pjesërisht.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 nga faqe 80-90 të Raportit të Auditimit)

4.1- Rekomandimi: Ministria e Financave të rishqyrtojë dhe të analizojë situatën lidhur me rekomandimet e pa realizuara, duke marrë masa të menjëhershme për nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësi konkrete ligjore për moszbatimin e tyre, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 344/8, datë 29.10.2020.

Brenda vitit 2021

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.-Gjetje nga auditimi: KLSH ka konstatuar krijim të detyrimeve të reja në shumën 7,750 milionë lekë (rreth 62.6 milion euro) të subjekteve nënuamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënuasë përgjatë vitit 2020, si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve përkatëse. Nga auditimi në lidhje me marrëveshjet e nënuasë konstatohet se stoku i kredive në lidhje me këtë komponent të borxhit shtetëror është përkeqësuar përgjatë vitit 2020.

Sektorët me përkeqësim të situatës financiare paraqiten sektori i energjistikës kryesisht me nënuatë e KESH, OSHEE dhe OST me rreth 5,791 milion lekë (46.8 milion euro) të rritjes totale të detyrimeve nga 7,750 milion lekë në total, pushteti vendor me rreth 1,173 milion lekë (9.5 milion

euro) dhe sektori i ujësjellësve me rreth 768 milion lekë (6.2 milion euro). Në nenin 30 “Huadhënia e të ardhurave të borxhit shtetëror, mbi të cilat zbatohen kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është përcaktuar që “...është përgjegjësi ligjore e huamarrësve, të cilët kanë marrë fonde, sipas paragrafit të parë të këtij neni, që ti kthejnë fondet e marra hua në përputhje me marrëveshjet e nënhuave dhe të paraqesin raporte për gjendjen e huasë dhe përdorimin e saj, sipas kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Financave”.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet e bëra në këtë nen, duke paraqitur një situatë ku detyrimet ndaj shtetit si pasojë e mos pagesave janë rritur nga viti në vit, duke filluar nga 15,814 milion lekë në fund të vitit 2017, në 21,279 milion lekë në fund të vitit 2018, në 27,344 milion lekë në fund të vitit 2019, dhe në 35,094 milion lekë në fund të vitit 2020. Detyrimet ndaj shtetit si pasojë e mos pagesave përgjatë vitit 2020 janë rritur me 7,750 milion lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 nga faqe 40-80 të Raportit të Auditimit)

1.1- Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa të menjëhershme për rikuperimin e të drejtave për të arkëtuar nëpërmjet ushtrimit të instrumentave ligjore që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuasë.

Brenda vitit 2021

2.-Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2020 janë krijuar detyrime të reja në shumën 3,051 milion lekë (3 miliard lekë) në kuadër të dështimit të pagesave për kreditë e garantuara nga përfituesi i garancisë. Garancitë shtetërore përgjatë vitit 2020 paraqesin një risk të shtuar në drejtim të administrimit të tyre dhe situatës së rënduar financiare të cilën kalon kryesisht sektori energjitik. Për vitin 2020 gjendja e detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është rritur nga 13,198 milion lekë në 15,885 milion lekë, me një rritje vjetore prej 2,687 milion lekë, pa përfshirë efektin e garancive të dhëna në kuadër të projektit me numër identifikimi në regjistrin e kredive “88” në vlerën 364 milion lekë. Me këtë efekt rritja vjetore vlerësohet në shumën 3,051 milion lekë, ose 3 miliard lekë.

Detyrimet si pasojë e pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit për vitin 2020 janë akumuluar në masën më të madhe nga kompanitë private me kapital shtetëror përfituese në sektorin energjitik në shumën 2,098 milion lekë (16.96 milion euro). Gjatë vitit 2020 konstatohet se Buxheti i Shtetit ka kryer pagesa si pasojë e paaftësisë paguese edhe të R.T.SH, duke rritur stokun e detyrimeve me 354 milion lekë (2.86 milion euro). Gjithashtu edhe në sektorin e ujësjellësve për projektet në U.K.T situata paraqitet problematike duke vendosur Buxhetin e Shtetit në risk për kryerjen e pagesave që kanë dështuar të kryhen nga ky përfitues i garancisë dhe rritjen e detyrimeve në shumën 146 milion lekë (1.18 milion euro).

Në nenin 43 “Kthimi i garancisë shtetërore të huasë” të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është përcaktuar që “Me kryerjen e pagesës në llogarinë e garancisë shtetërore të institucionit huadhënës, Ministri i Financave merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, në masën e çdo pagese të bërë në kuadër të garancisë së dhënë. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë Ministrisë së Financave së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ai i ka në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit. Huamarrësi, në zbatim të këtij ligji dhe të marrëveshjes së mirëkuptimit, është i detyruar ti kthejë Ministrisë së Financave shumën që kjo e

fundit i ka paguar huadhënësit, në kuadër të garancisë shtetërore të huasë. Ministri i Financave ndërmerr të gjitha masat e paracaktuara në këtë ligj, në ligje të tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përftuar nga huamarrësi çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të.”

Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet e bëra në këtë nen, për aq kohë sa stoku i detyrimeve jo vetëm që nuk është ulur përgjatë vitit 2020, por edhe është rritur me 3 miliard lekë. Konstatohet se masat e marra janë të pa mjaftueshme për zgjidhjen e situatës së krijuar ku risku i kreditit të këtyre institucioneve është mjaft i lartë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 nga faqe 40-80 të Raportit të Auditimit)

2.1- Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të rishikojë kuadrin ligjor për shtimin e instrumentave me qëllim administrimin efikas të riskut të garancive. Në vijim të ushtrijë të gjitha mjetet ligjore për arkëtimin e të drejtave për pagesa të kryera për garancitë e arkëtuara dhe në të njëjtën kohë të ushtrijë kontroll mbi planet ekonomike dhe financiare për shlyerjen e këtyre shumave.

Brenda vitit 2021

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

